100 VJET PAVARESI

Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (80). DHJETOR 2012. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

Redaksia e gazetës ju uron gjithë bashkëpunëtorëve dhe lexuesve të saj, Gëzuar Vitin e Ri 2013!

Qoftë një vit i mbarë dhe i gëzueshëm për të gjithë!

INTERVISTË

Velo Cfarku: Koha merr emër përmes punës

Nga **QAZIM SHEHU** - FAQE 5

BIOGRAFI

"Gjenerali me shajak"

Një libër që tregon se si duhet shkruar për figurat e shquara

Nga **IBRAHIM MILUSHI** - FAQE 17

BOTIME

Fabula me tema të mprehta shoqërore

Nga **BARDHYL XHAMA** - FAQE 16

KUJTESË

Faik Ballanca, njeri e shkrimtar

Kënga e fundit e Marko Boçarit

FAQE 20

"Historia e Dibrës" nuk është një histori pushke, por histori e mendjes

Kristo Frashëri: Kam shkruar jo Dibrën që kam njohur unë, por Dibrën që më përcjellin dokumentet e historisë.

Unë e mendoj historinë e Dibrës jo si një histori pushke, luftëtarësh, siç e kanë qejf shumë malësorët e Dibrës kur flasin e tregojnë trimëritë. Unë dua bashkë me trimëritë, bashkë me gishtin - si i thonë pushkës, - kam dashur të shoqëroj dhe mendjen. Se Dibra ka pas edhe njerëz të mendimit. Ka dhe një prodhim që është prodhimi intelektual popullor, edhe prodhim intelektual që quhet refleksiv shkencor. Por Dibra në tërësinë e saj ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore. Këtë kam dashur të përshkruaj në këtë libër, nuk e di sa ia kam arritur.

Vështirësia për shkrimin e këtij libri kanë qenë kolosale, sepse Dibra përveç këtyre meritave të mira, ka dhe një dobësi: dibranët nuk e kanë pasqyruar në shkrime historinë e tyre nëpërmjet dokumenteve. Për dibranët dokument ka qenë fjala e dhënë. Nuk janë si ato popujt evropianë, që nga frika se mos shkelet fjala, bëjnë kontrata e shkruajnë marrëveshje. Dibranët lidhen me besë, jepte fjalën s'kishte nevojë ti firmosnin. Bënin traktate me njëri-tjetrin nuk kishin nevojë t'i shkruanin, sepse ishin të dy palët dibranë të bindur dhe të vendosur ta respektonin. Por kjo për historianin është një fatkeqësi. Sa krenari është për dibranin, aq fatkeqësi është për historianët.

LEXONI NË FAQEN 3

Në foto: Akademik prof. dr. Kristo Frashëri gjatë intervistës pas botimit të librit.

STUDIM

Paria e Dibrës, formimi e cilësia e saj

Nga **XHAFER MARTINI**

Studimi, prejardhja, formimi dhe cilësia e parisë së Dibrës ndikojnë në studimin e historisë së kësaj treve në tërësi, mbasi paria ishte ajo që kishte përgjegjësinë historike për udhëheqjen e popullit. Popujt kanë nevojë për drejtim dhe udhëheqje që t'u dalin zot interesave të veta. Në pari përfshihen edhe njerëzit e shkolluar, intelektualët atdhedashës, me rolin e tyre ndriçues. Por paria mund të jetë atdhedashëse e kombëtare, por mund të jetën edhe e shitur ose e mefshtë e jovizionare. Natyrisht, jo e gjitha dhe jo për të gjitha kohërat. Historia na tregon shumë raste kur popujt, edhe pse janë therorizuar, nuk kanë arritur rezultate pozitive, sepse janë tradhtuar nga udhëheqësit, ose vrulli dhe energjitë e tyre janë ndalur në mes të rrugës, pikërisht në kohën kur janë përmbushur interesat e atyre që i ngritën në luftë. Prandaj me të drejtë është thënë se "paria... është duar-duar: një pjesë karakterizohej vetëm nga interesat personale, kurse një pjesë edhe nga interesat kombëtare. Prej një qëndrimi të tillë kjo pari "ka anën e vet të errët dhe të ndritur: në një brez ka arritur të bëjë shumë për vendin e në një brez tjetër ka dështuar ose i ka bërë të zezën atdheut". (Sh. Sinani: "Një Shqipëri etnografike-politike në kujtimet e Ismail Strazimirit", Pasthënia" (Në librin "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", Tiranë 2011) Kemi tri lloj parish:

LEXONI NË FAQET 8-9

Ismail Keta, kampioni që nderoi Shqipërinë

Reportazh - Ditët me kampionin në atdhe

Nga **DEFRIM METHASANI**

Lajmi që Ismail Keta u shpall për herë te dytë kampion bote, në Kik dhe Taiboks, ka gëzuar të gjithë shqiptarët, menjëherë pas 100-vjetorit të pavarësisë, pasi kampioni pas ndeshjes deklaroi për mediat gjermane, se një triumf të tillë ua dedikonte bashkëkombësve të tij në gjithë botën, si shpërblim për ditëlindjen e 100-të të kombit. Natyrisht, që jehona e një suksesi të tillë ishte e përmasave të mëdha, ndaj vendosëm që ta presim në atdhe këtë djalosh, që në çdo hap të jetës së tij si sportist, nuk harroi asnjëherë të kujtojë Shqipërinë dhe shqiptarët. Madje historia e kombit të tij, ka qenë frymëzimi për të kapur dy herë majën e botës. Ismail Keta, është i vetmi shqiptar që ka arritur një sukses të tillë në këtë sport.

LEXONI NË FAQET 12-13

cyan magenta yellow black 1

Posta e Rruga Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 12 (80). 1 - 31 Dhjetor 2012

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë Fejzulla Gjabri, Jahe Delia Selmani, Qazim Prejsi, Mentor Hoxha, Mustafa Tola, Zejnullah Gruda, Ymer Keta, Haki Kola, Ilmi Dervishi, Sami Milloshi, Bedri Tahiri, Ermira Babamusta se shkrimet e tyre jane në redaksi dhe do shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**
JU LUTEMI, QË SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAILIT, TË KENË PATJETËR ZANOREN "Ë".
Gazeta publikohet falas në internet me datë 7 të muajit pasardhës.

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!



DREJTOR:
Rakip Suli

KËSHILLI BOTUES:
Musa Riçku
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:
Xhafer MARTINI
Rexhep TORTE
Selman MËZIU
Abdurahin ASHIKU
Naim PLAKU
Mahmud HYSA
Ibrahim MILUSHI
Bardhyl XHAMA
Defrim METHASANI
Mimoza SHQEFNI
Qazim SHEHU
Mentor HOXHA
Mevlud BUCI
Pandeli KOÇI
Sakip CAMI
Ramazan S. ILNICA
Ymer STOJKU
Halil RAMA
Zabit LLESHI
Zamira GJELESHI
Mentas NASUFI
Saimir SHATKU
Afrim KAROSHI

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

Dimri në Rabdisht të **Peshkopisë**

Bora e parë ka rënë edhe për këtë vit në Shqipëri. Majat e maleve janë mbuluar, çatitë e shtëpive kanë vënë një shtresë të lehtë bardhësie. Të mësuar me problemet që sjell kjo stinë, vendasit nxitojnë për të mbledhur gjërat e fundit të domosdoshme për t'i bërë ballë një dimri të ftohtë e të ashpër.

Njerëzit e vendeve të ulta, ku bora bie një herë në disa vite, shpesh nuk e kuptojnë rrezikun që ajo mund të sjellë. Por banorët e fshatit Rabdisht të Peshkopisë prej kohësh kanë filluar përgatitjet për stinën e dimrit. Ditët e këqia që kanë kaluar një vit më parë kanë lënë gjurmë të thella në kujtesën e tyre.

"Kemi qenë 2 muaj të izoluar, kemi hequr keq vjet. Nuk dilte as kafsha nga i ftohti. Kam pasur djalin me 40 temperaturë dhe për pak më vdiq në dorë", shprehet një banor i zonës.

Malvina është nusja e shtëpisë. Ajo është angazhuar që problemet e vitit të kaluar të mos përsëriten më: "Vjet kam qenë shtatzënë dhe kam pasur shumë vështirësi, por vështirësitë e vitit të kaluar na kanë nxitur dhe më shumë për t'u përgatitur për dimrin e radhës." Baza ushqimore është thelbësore gjatë kohës kur fshati izolohet, kështu që e gjithë familja është angazhuar për krijimin e rezervave dimërore.

"Kemi groshë, domate, speca, gjizë... Gjithashtu kemi blerë 20 thasë miell dhe oriz." Kështu tregon Medati, kryefamiljari i derës së Ismailajve. E megjithatë ata prapë nuk janë të sigurt nëse do ia dalin mbanë, janë 8 veta për të ushqyer.

Kimetja thotë se duhet të përgatiten edhe për bagëtinë. Në rast se ngelin keq, gjëja e gjallë është e vetmja rrugë për mbijetesë. Këtë sektor e mbulon Reshati, djali i shtëpisë.

"Për bagëtinë kemi marrë shumë masa sepse bie shumë borë dhe nuk vjen askush për të zhbllokuar rrugët. Kemi marrë jonxhë, bar dhe misër që të ushqehen gjatë dimrit", thotë Reshati.

Megjithatë, iu ka rastisur të mbeten edhe në vështirësi: "Kur ngelim keq, shkëmbejmë me njerëzit në fshat. Ndihmojmë njëritjetrin."

Janë ditët e para të dhjetorit dhe ngricat kanë filluar, por njerëzit e Rabdishtit ende vazhdojnë të shpresojnë: "Po i lutemi Zotit që të mbajë moti të paktën deri në datën 25, të punojmë edhe ca ditë para Vitit të Ri."

Janë përgatitur për gjithçka kanë mundur dhe besojnë se ky vit nuk do t'u rezervojë ndonjë surprizë të pakëndshme.

(Marrë nga top-channel.tv)

Festimet për 28 nëntorin

Natë gala në Dibër të Madhe për festën e pavarësisë kombëtare

Me rastin e 100 Vjetorit te festes se Pavaresise Kombetare, si ne çdo qytet te Shqipërise, veçanerisht ne Tirane dhe ne Vlore, kjo feste u festua me kompozitet dhe organizimin me serioz te autoriteteve vendore. Por dhe ne qytetin e Dibres se Madhe ishin marre masa serioze dhe adeguate per mirorganzimin e nates se 28 nendorit, per nder te 100 Vjetorit te Pavaresise. Me ftese te pales organizatore biznesmenet "Vellezerit Hatibi" si dhe mbeshtetjen artistike te kantautorit nga Dibra e Madhe me nje pervoje te gjere dhe te gjate ne fushen e muzikes ne SHBA, Z. Saimir Shehu, u realizua nje aktivitet artistik dhe koncertor ne Restorant "Uraniku" me pjesemarrjen e rreth 450 te ftuarve shqiptar nga Dibra e Madhe, Shkupi, Tetova, Tirana, Amerika, Italia, Skandinavia etj. Ne kete mbremje mernin pjese me ftese te organizatoreve dhe nje perfaqesi me artist, njerez te medias dhe komunikimit me prejardhje nga Dibra e Madhe, si dhe nje disa familje te hershme dibrane te cilet pas vjeshtes se vitit 1913 u vendosen perfundimisht ne Tirane. Ne delegacion nga Tirana mernin pjese: Mjeshtri i madh i muzikes Shqiptare, kompozitori Z. Agim Krajka ku pjesemarrja e tij u prit me entuziasem dhe duartrokitje te zjarrta dhe emocionuese nga publiku pjesemarres ne kete mbremje. Artisti i mirenjohur i skenes Shqiptare, Prof. Bujar Kapexhiu dhe anetar i Kryesise se Shoqates "Bashkesia Dibrane", studuesi Prof. Dr. Arian Kadiu anetar i Kryesise se Shoqates "Bashkesia Dibrane", Projektuesi dhe Inxhinjeri i Rruges se Arberit Dr. Faruk Kaba, Kryetaria e Komitetit per Rrugen e Arberit, Yllka Causholli, N/Kryetari i Komtetit per Rrugen e Arberit, Z. Tofik Jegeni, N/Kryetari i Komitetin per Rrugen e Arberit (perfaqsues i diaspores Shqiptare) biznesmeni Z. Ibrahim Kolari, si dhe Trajneri i mirenjohur i basketbollit shqiptar Z. Astrit Greva, sipermarresi Igli Pustina, Prof. Luan Pirdeni, perfaqsues nga famija Spahiu etj. Ky aktivitet u realizua nen regjine dhe skenografine e rregjizorit te mirenjohur Z. Hervin Culi.

Pas hapjes se aktivitetit nga kantautori Z. Saimir Shehu, i cili promovoj dhe kengen e tij me te re me rastin e 100Vjetorit te pavaresise, u kendua "Hymni Kombetar" nga nxenesit e shkolles se muzikes si dhe pjese me poezi patriotike nga krijmtaria e poeteve kombetar si: Cajupi, Azdreni, Fishta, Mjeda, Migjeni etj. Me pas pershendeten aktivitetin Z. Argetim Fida, Kryetar i Komunes Diber e Madhe, pas tij Z. Rruzhdi Lata, Myfti i Dibres se Madhe, si dhe poeti Z. Agim Doçi, ku teksti i kenges se ideuar prej tij "Hymni i 100 Vjetorit" i kenduar dhe prezantuar per publikun Shqiptar nga pese kengetar qe perfaqsojne 5 trevat shqiptare, u prit me emocione dhe lot ne sy nga pjesemarresit dhe

u transmetua disa here. Ndersa ne fjalet e tij kompozitori i mirenjohur dibran, Agim Krajka me fjale emocionuese nga pritja e vecante qe autoritetet vendore dhe organizatoret i rezervuan Z. Krajka tha se: Nuk vlen te themi me fjalet se Dibra e Madhe si "Britania e Madhe", por vlen te themi me praktike dhe me shpirt se Dibra e Madhe dhe Shqiperia e Madhe, jane nje komb". Pas ketyre fjaleve nga salla pati duartokitje te vazhdueshme dhe emocionese.

Me pas nga pala e organizatoreve te mbremjes Gala dhe Koncertore pati falenderime ne adrese te perfaqesuesve te komunitetit Dibrane ne Tirane te cilet oragizatoret do te thonin se panvarsisht faktit te largesise dhe ecjes se viteve ato ruajne ndjenjen e te qenurit dibrane, por dhe zakonet, traditat dhe vlerat historike nga Dibra e madhe, qytet i bekuar, me histori dhe me mesazh per çdo brez.

Gjithashtu perfaqsuesit e disa familjeve te vjetra dibrane u priten nga Myftiu i Dibres Z. Rruzhdi Lata, te cilet me emocion shkembyen komunikim vllazerore dhe rikthyen ne memorien e tyre, vitet e dhuneshme te eksodit te vitit 1913 te largimit te dibraneve nen peshen e dhunes me statusin e emigrandeve(muhaxhireve), me qellimin se nje dite do te rikthehen perseri ne vendin e tyre. Me pas ne takim u fol dhe per rolin e disa figurat kombetare dhe fetare ne shpalljen e pavaresise se Shqiperise.

Diten e enjte dt. 29 nentor, anetaret e komitetit per Rrugen e Arberit si dhe perfaqsuesit e komunitetit dibrane ne Tirane u priten nga Kryetari i Komunes se Dibres se Madhe, Z. Argetim Fida, i vili i njohu te pranishmit me aktivitetet e realizuara nga Komuna per nder te 100 Vjetorit te pavaresise si dhe investimet qe jane bere nder vite ne sektor te ndryshem te ekonomise dibrane. Z. Fida falenderoj pjesemarrjen e tyre ne mbremjen Gala te 28 nendorit dhe mesazhin qe jep sot komuniteti dibrane ne Tirane. Ne kete takim u shkembyen kujtesa dhe vleresime per kontribuesit e aktit te pavaresise si dhe u fol mbi ecurine dhe domosdoshmerine e ndertimit me procedura te pershpejtuara te Rruges se Arberit, si e vetmja shprese dhe prespektive qe ndihmon rimekembjen ekonomike dhe transportuale si dhe nje rruge e cila afron akoma me shume Dibranet e Tiranen dhe komunitetet e tyre respektive.

Pas perfundimit te takimit me kryetarin e Komunes Z. Fida, delegacioni nga Tirana qe mori pjese ne kete aktivitet u nis per tu rikthyer ne Tirane.

Pergatiti: Saimir Shatku LLM

intervistë

Në foto: Akademik prof. dr. Kristo Frashëri gjatë intervistës pas botimit të librit.

KRISTO FRASHËRI:

Kam shkruar jo Dibrën që kam njohur unë, por Dibrën që më përcjellin dokumentet e historisë

Vështirësia për shkrimin e këtij libri kanë qenë kolosale, sepse Dibra përveç këtyre meritave të mira, ka dhe një dobësi: dibranët nuk e kanë pasqyruar në shkrime historinë e tyre nëpërmjet dokumenteve. Për dibranët dokument ka qenë fjala e dhënë. Nuk janë si ato popujt evropianë, që nga frika se mos shkelet fjala, bëjnë kontrata e shkruajnë marrëveshje. Dibranët lidhen me besë, jepte fjalën s'kishte nevojë ti firmosnin. Bënin traktate me njëri-tjetrin nuk kishin nevojë t'i shkruanin, sepse ishin të dy palët dibranë të bindur dhe të vendosur ta respektonin. Por kjo për historianin është një fatkeqësi. Sa krenari është për dibranin, aq fatkeqësi është për historianët.

Unë e mendoj historinë e Dibrës jo si një histori pushke, luftëtarësh, siç e kanë qejf shumë malësorët e Dibrës kur flasin e tregojnë trimëritë. Unë dua bashkë me trimëritë, bashkë me gishtin - si i thonë pushkës -, kam dashur të shoqëroj dhe mendjen. Se Dibra ka pas edhe njerëz të mendimit. Ka dhe një prodhim që është prodhimi intelektual popullor, edhe prodhim intelektual që quhet refleksiv shkencor. Por Dibra në tërësinë e saj ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore. Këtë kam dashur të përshkruaj në këtë libër, nuk e di sa a kam arritur.

Pyetje: Në fillim, ju falënderojmë në emër të gjithë dibranëve, për dhuratën e çmuar që u bëtë atyre në kuadrin e 100-vjetorit të shpalljes së pavarësisë, duke botuar librin "Historia e Dibrës". Cili është mesazhi juaj për ta, pas botimit të librit?

Kristo Frashëri: Unë, para së gjithash ju falënderoj juve dibranëve edhe për përmes jush gjithë dibranëve që nuk janë këtu, për ngrohtësinë që po tregoni ndaj meje.

Unë e kam shkruar Historinë e Dibrës vetëm për hir të respektit që kam patur për dibranët, të cilën unë e kam fituar, jo tani, por mund të them 70 vjet më parë. Kam patur shumë shokë dibranë kur isha i ri. Në lagjen e dibranëve të Tiranës ka akoma njerëz ndoshta që janë moshatarë me mua dhe mbajnë mend se si flitsha me ta.

Unë jam nga Frashëri, ndonëse nuk kam banuar në Frashër. Babai im më ka përcjellë dashurinë që kishte ai me Çokajt dibranë edhe gjithmonë me ta, kam kujtuar Abdyl Frashërin. Unë këtë dashuri të Abdyl Frashërit e kam trashëguar nga im atë, edhe nëpërmjet Abdylit, nga pjesët më të bukura të historisë së Abdyl Frashërit, kanë qenë vizitat e tij në Dibër. Kur kam qenë në Dibër në vitin 1943, habiteshin disa dibranë qytetarë atje, përse unë vija nga Tirana dhe pyesja ku është shtëpia e Iljaz Pashë Dibrës, sepse dua të vete atje të bëj një vizitë. "Ç'punë ke ti me Iljaz Pashë Dibrën, - më thoshin mua, - ti je nga Tirana". Unë u thosha kam sepse Iljaz Pashë Dibra ka qenë bashkëpunëtori më i ngushtë i Abdyl Frashërit ose Abdyl Frashëri bashkëpunëtori më i ngushtë i Iljaz Pashë Dibrës. Këtu dua të them se nuk është një gjë e re kjo. Historia e Dibrës është fruti i këtij respekti dhe i kësaj dashurie që kam pas për dibranët dhe pastaj dhe për Dibrën kur e vizitova. Kam kaluar fshat më fshat që nga Klenja edhe deri në Kalanë e Dodës. Kështu që, kjo më ka detyruar asnjë gjë tjetër. Dhe, po më vjen mirë tani që po më marrin në telefon shumë dibranë e po më përgëzojnë edhe më pyesin ku mund ta gjej këtë libër ta blejmë.

Kur fillova të shkruaj "Historinë e Dibrës" unë i vura vetes time këtë detyrë: Jo Dibrën që kam njohur unë, por Dibrën që më përcjellin dokumentet e historisë. Kështu fillova dalëngadalë të merrem me Dibrën që nga kohët më të lashta dhe e kam përcjellë historinë e Dibrës me sa kam pasur mundësi në këtë vepër që është vëllimi i parë. Kam patur dëshirë të bëj një vëllim të dytë, ku është pjesa e fundit e Historisë së Dibrës që nga Lufta e Dytë Botërore e këtej. Kështu që, ky libër këtë vijë ka, që nga fillimet parahistorike edhe deri në ditët e fundit para Luftës së Dytë Botërore.

E dyta, unë kam një koncept tjetër për historinë, dhe këtu unë ndahem njëçikë nga dibranët. Edhe jam përpjekur t'ua përcjell edhe historianëve dibranë. Unë e mendoj historinë e Dibrës jo si një histori pushke, luftëtarësh, siç e kanë qejf shumë malësorët e Dibrës kur flasin e tregojnë trimëritë. Unë dua bashkë me trimëritë, bashkë me gishtin - si i thonë pushkës-, kam dashur të shoqëroj dhe mendjen. Se Dibra ka pas edhe njerëz të mendimit. Ka dhe një prodhim që është prodhimi intelektual popullor, edhe prodhim intelektual që quhet refleksiv shkencor. Por, Dibra në tërësinë e saj ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore. Këtë kam dashur të përshkruaj në këtë libër, nuk e di sa ja kam arritur. Luftërat nuk i kam lënë mënjanë, por zënë një vend shumë të vogël në këtë vepër, se sa zë jeta dhe rezistenca që ka zhvilluar Dibra në fushën e së drejtës kanunore dhe në fushën e jetës popullore dhe shoqërore.

Kjo është një histori, një sintezë e përgjithshme e Dibrës nuk është vetëm një histori politike ose një histori ushtarake, është histori e përgjithshme e Dibrës. Nuk e di sa ja kam arritur.

Një tjetër veçori që më bërë përshtypje nga Historia e Dibrës, dhe këtë e kam theksuar në hyrjen e librit. Hyrja është një sintezë e Dibrës. Ç'është Dibra? Dibra është një krahinë që rrethohet nga malet. Dhe ka bërë një jetë edhe të veçuar edhe të lidhur me botën e jashtme. Janë gjitha ato gryka që e lidh me botën e jashtme, pra nuk është një vend i mbyllur. Gjithë kufijtë e Dibrës janë 2100 metra, 2200 metra, 2500 metra, 2600 metra siç është Korabi, por nuk ka qenë e izoluar, ka patur shtatë gryka që nga gryka e Kalasë së Dodës, deri te gryka e lumit Drin nga Struga, gryka e Bulqizës e me radhë. Nga pikëpamja shkencore kjo është shumë interesante. Kjo ma shtoi dëshirën që të thellohem tek historia e Dibrës. Pak krahina të tjera e kanë këtë veçori.

E dyta, Dibra është një krahinë që ka pas në kufi një zonë shumë të ndryshëm nga dibranët. Ka qenë zona sllavo-maqedone dhe ka mundur të merret vesh me ta pa u dikuar nga ata. Unë e kam bredhur Maqedoninë maqedone dhe kam vënë re që atje maqedonët shumë elementë i kishin marrë nga zakonet dhe nga e drejta e Dibrës, gjë që nuk e kanë sllavët e mëtejshëm që janë në kufi me Bullgarinë. Është shumë interesante, por këto nuk kam mundur t'i pasqyroj në punim, sepse duan një kohë shumë të gjatë.

Kjo është për mua ajo që më shtyu të shkruaj për Dibrën, edhe interesi shpirtëror, komunikimi me dibranët, edhe interesi shkencor.

Pyetje: A patët vështirësi në shkrimin e këtij libri?

Kristo Frashëri: Këtë mirë bëtë që më pyetët. Vështirësia ka qenë kolosale, sepse Dibra përveç këtyre meritave të mira, ka dhe një dobësi: dibranët nuk e kanë pasqyruar në shkrime historinë e tyre nëpërmjet dokumenteve. Për dibranët dokument ka qenë fjala e dhënë. Nuk janë si ato popujt evropianë, që nga frika se mos shkelet fjala, bëjnë kontrata e shkruajnë marrëveshje. Dibranët lidhen me besë, jepte fjalën s'kishte nevojë t'i firmosnin. Bënin traktate me njëri-tjetrin nuk kishin nevojë t'i shkruanin, sepse ishin të dy palët dibranë të bindur dhe të vendosur ta respektonin. Por kjo për historianin është një fatkeqësi. Sa krenari është për dibranin aq fatkeqësi është për historianët.

Jam përpjekur të gjej qoftë edhe një tekst për kanunet e Dibrës, siç ka për kanunet e Mirditës, Dukagjinit e të Malësisë së Shkodrës. Nuk ka për Dibrën. Prandaj jam mundur të mbështetem tek ata që e kanë njohur e kanë grumbulluar me atë që kanë mbetur nga kanunet e Dibrës. Dibra ka pasur kanune që në shekujt mesjetarë që s'kanë lëvizur, janë ndryshuar, por dokumenta nuk ka, as për marrëveshje as për gjë tjetër. Jam munduar nga kjo të mund të peshkoj ku të mundem në një shkëndijë të vogël e ta marr, kjo është vështirësia e madhe që kam gjetur.

Ndryshe është për këto vitet e fundit, shekullin e fundit. Aty dalin dokumente se si u krijua administrata, si u hapën shkolla. Ka njerëz intelektualë të cilët janë munduar t'i pasqyrojnë zhvillimet historike. Dhe e kam mbyllur Historinë e Dibrës me një vështrim mbi intelektualët dibranë, ata që kanë arritur të japin diçka që i ka shërbyer edhe kulturës shqiptare.

Pyetje: Tashmë librin e keni në dorë. A jeni i kënaqur nga cilësia e botimit, i është përgjigjur nivelit tuaj?

Kristo Frashëri: Jam shumë i kënaqur jo vetëm nga botimi i librit, por edhe nga bashkëpunimi që patëm gjatë procesit të botimit.

Me këtë rast, duhet të falënderoj kryetarin e Bashkisë së Peshkopisë z. Ilir Krosi, që bëri të mundur sponsorizimin e të drejtës së autorit. Gjithashtu, jam shumë i kënaqur nga cilësia e botimit dhe do të isha akoma më tepër i kënaqur nëqoftë se kjo shtëpi botuese pranon të botojë dhe shkrime të tjera të miat. Jam shumë i kënaqur, edhe nga ana teknike dhe nga ana artistike dhe nga ana e saktësisë, i ka respektuar të gjitha. Shpresoj se në të ardhmen do gjejmë mundësi bashkëpunimi të tjera.

- Atëherë s'më mbetet gjë tjetër vetëm të të jap dhe një tjetër falënderim në emër të atyre që s'kanë patur mundësi të të urojnë përmes telefonit apo mesazheve. Dhe të uroj jetë të gjatë sepse jeta juaj sjell gjithmonë prodhimtari, jo vetëm për veten, por dhe për gjithë Shqipërinë. Urime!

Kristo Frashëri: - Faleminderit shumë.

Rremzi Skepi, një hero në një situatë gati të pamundur

Një shembull pozitiv i shqiptarëve në Britaninë e Madhe, pasqyruar nga gazeta lokale "Oxford Mail"

Një hero në një situatë gati të pamundur, i cili u kacafyt me një hajdut në një rrugë të mbushur me dyqane, tregon se si e ndaloi të dyshuarin dhe e mbajti përtokë.

Ish-oficeri i policisë Rremzi Skepi mori në dorë një shkop prej hekuri dhe ia drejtoi njërit prej të dyshuarve ndërsa u godit përdhe nga tjetri që ecte mbi një motor.

Por ia doli të ngrihej, e sulmoi përsëri vjedhësin, dhe e mbajti përdhe për disa minuta derisa erdhi policia në vendngjarje.

Zoti Skepi, një shqiptar, ishte nga të parët që u ndodh në vendngjarje afër argjendarisë "Majkëll Xhones" in Banburi, që u grabit të martën, në 11 Shtator.

55 vjeçari gjendej në Bankën Llojds kur dëgjoi zhurmën jashtë dhe pa njerëz që po vraponin të frikësuar.

Në fillim, punonjësi i një kompanie prodhimi bukësh, që flet pak anglisht, nuk dalloi që një argjendari në rrugën "Haj Banburi" po grabitej.

Por pastaj u hodh në aksion kur dëgjoi gra dhe fëmijë që po qanin, dhe pa të dyshuarit mbi motor.

Duke na folur përmes përkthyesit Xhetan Bushi, në Barin Roma in Oksford, Zoti Skepi tha: "Ata po i shtinin frikën grave dhe kalamajve duke i dhënë xhiro të forta motorit".

"Kur dola për të parë se çfarë po ndodhte, një nga motorçiklistët mu hakërrye mua dhe më tha: "Do të të vras."

Zoti Skepi tha që ai mori pastaj një shkop metali nga një dyqan afër dhe ju drejtua njërit prej grabitësve, duke e goditur në helmetë dhe duke shkaktuar përplasjen e motorit të tij në tokë.

Pastaj, motorçiklisti i dytë e goditi Zotin Skepi duke e rrëzuar përtokë. Atëherë, Zoti Skepi e dalloi që argjendaria po grabitej.

Por motorçiklisti që goditi z. Skepi, u rrëzua ndërsa po përpiqej të arratisej.

Ish oficeri i policisë shqiptare, z. Skepi, që ka shërbyer me policinë për 12 vite, mezi u ngrit në këmbë dhe ju hodh përsipër grabitësit, duke e mbajtur të rrëzuar përtokë.

Z. Skepi, që jeton në Banburi prej tetë vitesh, shtoi: "Kisha frikë për jetën timë sepse isha i vetmi që po e mbaja përtokë."

Të dyshuarit e tjerë u larguan nga vendngjarja.

Një çantë me disa prej gjërave të grabitura u gjet në vendngjarje. Një banor e dërgoi z. Skepi në spital, ku doktorët zbuluan se z. Skepi kishte një frakturë në këmbën e majtë pasi ishte goditur me motor.

Ai është kthyer në shtëpi tani por përdor patericat për të lëvizur.

Xhimi Stringer nga Islington, u paraqit në gjykatën e Oksfordit javës së kaluar dhe pranoi akuzën për grabitje.

23 vjeçari u mbajt në paraburgim dhe do të presë një dënim të gjatë ndoshta, që do të vendoset përfundimisht me datën 9 Nëntor.

Tre persona të tjerë u arrestuan pas grabitjes dhe do t'ju përgjigjen pyetjeve të policisë në datën 21 Tetor.

Përshtati në shqip: **Afrim Karoshi**

Botuar në "Oxford Mail", 12 Shtator 2012

Çezmat e Dibrës së Madhe ku ndizej dashuria

Nga **Rexhep TORTE**

Qyteti i bukur i Dibrës së Madhe është i dëgjuar edhe për nga burimet, puset e çezmat e shumta, ku uji shekuj të tërë s'ka të ndalur. Kazmat dhe ekskavatorët e sotëm që punojnë për të rregulluar gjësendi maleve ose në qytet,zbulojnë tubo qeramike dhe ujësjellës të vjetër për nga lashtësia, të gdhendur në gur e të mbuluar me rasa guri, që e sjellin ujin e pastër e të ftohët, nga malet apo kodrat e qytetit,duke e sistemuar këtë ujë me çezma nëpër tërë lagjet dibrane. Në Dibër të Madhe ka edhe shumë puse shtëpiake dhe çezma që ndodhen në periferi të qytetit,por ne sot do të flasim vetëm për çezmat e lagjeve të qytetit.

Këto burime uji të vendosur në çezma i kanë dhënë dhe i japin jetë qytetit,sepse një vend pa ujë nuk ka as jetë. Edhe sot vazhdimisht dëgjohet jehona e gurgullimës së ujit të këtyre çezmave.

Në Dibër të Madhe janë ndërtuar një numër i madh çezmash të ndryshme e të larmishme për nga bukuria dhe koha e ndërtimit.

Këto çezma sot e kësaj dite i kanë ruajtur emrat sipas ndërtuesve,ngjarjeve dhe vendit të tyre. Nga më të dëgjuarat janë Çezma e Demçes,Çezma e Shahvecit, Çezma e Namazgjarit, Çezma e Budulecit, Çezma e Teqes, Çezma e Madhe, Çezma e Popit etj.

Këto vende burimi uji të ftohtë, ku trimat dibranë të cilët arrinin nga anë të ndryshme dhe freskonin fytyrën e shpirtin nga rruga e largët, kanë të mbështjellura rreth vetës historitë e tyre .

Më të moshuarit mbajnë mënd se, ditën dhe orëve të mbrëmjes rruga për në këto çezma nuk kishte të ndalur,sepse këtë e kërkonte maxhja dibrane për të gatuar dhe dëshira e sedra dibrane për ta mbajtur pastër shtëpinë,për vetë familjarët dhe për mysafirët që do të vinin.

Me këto çezma janë të lidhura edhe historitë tronditëse të fushatave luftarake të ashpra të armiqve, që janë bërë gjatë shekujve për ta okupuar Dibrën. Me ujin e këtyre çezmave luftëtarët trima dibranë,burra e gra, shuanin etjen dhe shpërlanin plagët dhe fashot me të cilat i lidhnin këto plagë. Me ujin e këtyre çezmave dibranët mbanin edhe pastërtinë personale, ndërsa gratë e vyera dibrane lanin shtëpitë dhe oborret,lanin, shpërlanin dhe zbardhonin shtrojet, veshjet dhe qilimat e shtëpive të tyre.

Me ujin e këtyre çezmave gurbetçinjtë, udhëtarët dhe shtegtarët e rastit freskoheshin,pastroheshin,por edhe këndelleshin nëse duhej për të vazhduar më larg udhëtimin e tyre.

Me ujin e këtyre çezmeve fëmijët pas lojërave të tyre laheshin,pastroheshin dhe futeshin në shtëpi,duke u kujdesur për të mos i ndotur ato.

Ujin e këtyre çezmeve e përdornin dhe e përdorin edhe sot bagëtitë e qytetit me të kthyer nga kullotat e fushës.

Në Dibër të Madhe ditën e natën shtegtari i huaj nuk e ka patur dhe nuk e ka vështirë të gjen ujë dhe të furnizohet me ujin e këtyre çezmave.

Shumë herë mbushja e ujit në këto çezma ishte edhe rast i mirë që vajzat dibrane të dalin nga shtëpia.

Çezmat dibrane shërbenin edhe si kuvende, ku tuboheshin vajzat dhe djelmoshat,por edhe të moshave më të rritura,dhe aty ndërsa pritnin radhën për të mbushur gjygimat e bucelat me ujë,kuvendonin e bisedonin për ndodhitë,ngjarjet, brengat dhe dëshirat e tyre.

Rrugës për në çezma, apo mu aty te çezma,të rejat dhe të rinjtë dibranë, shikonin njëri tjetrin,takoheshin e njoftoheshin dhe aty lindte dashuria dibrane,e pastër dhe e sinqertë si uji i kulluar i këtyre çezmave.

Kështu, në këto çezma, përveç shuarjes së etjes lindte dhe ndizej edhe dashuria mes djelmoshave e vajzave dibrane.

Ishte bërë zakon, që kohë pas kohe, vajzat e një lagjeje shkonin e mbushnin ujë në çezmat e lagjes tjetër,për ta provuar edhe guston e ujit të çezmës tjetër,por edhe për të mësuar dhe për tu informuar se ç'po ndodhte në lagjet e tjera të qytetit.

Rrjedhja e ujit në këto çezma ka bërë që të thurren shumë histori dhe të lindin shumë dashuri sokaqeve të shtruar me kalldrëme. Po të dinin të flasin këto gurë të kalldrëmes dibrane, do të na jepnin kryevepra të poezisë së dashurisë duke i përshkruar ato dridhje të shpirtrave rinore dhe flakët e këtyre dashurive të shumta dibrane që lidhen me çezmat dhe me ujin e tyre.

Shumë gra dhe vajza dibrane,në Ditën e verës dhe në Ditën e Shëngjergjit, edhe sot e kësaj dite, orëve të hershme të mëngjesit, shkojnë në këto çezma për të larë fytyrën me lule pranvere,sepse sipas ritit që besojnë,kjo larje u sjell fat, shëndet e lumturi në jetë.

Ndërtimi i ujësjellësit dhe futja e ujit në ambientet shtëpiake, nuk i ka cënuar fare çezmat në Dibër të Madhe. Ato ruhen e mirëmbahen me shumë kujdes dhe sa herë që ndodh të ketë difekt në rrjetin e ujësjellësit, dibranët nuk shqetësohen shumë,por me gjygima dhe enë në dorë drejtohen drejt këtyre çezmave,sikur dëshirojnë të thonë se çezmat nuk janë të harruara,ato janë dhe do të mbeten pjesë e pandarë e Dibrës dhe e dibranëve.

intervistë

**Intervistë me Velo Cfarkun, publicist dhe shkrimtar:
Historia e publicistikës s'mund të kuptohet,
nëse ai nuk shtron udhë dhe hap horizonte për të tjerët...**

Velo Cfarku:Koha merr emër përmes punës

Nga QAZIM SHEHU

- Ju keni shkruar disa libra për Dibrën, për njerëzit e thjeshtë , punën , traditat, etnopsikologjinë etj. Ç`përbën kjo për ju?

- Që t`u rikthehesh viteve të shkuara në moshën 78 vjeçare është diçka e vështirë, sepse një barrë e tërë vitesh, eksperiencash ndaj me njerëzit e atyre viteve të trevës së Dibrës e më gjerë. Në jetën time gjithnjë jam ndjerë i befasuar nga mikpritja e njerëzve të thjeshtë, traditat, zakonet, vlera e fjalës së mençur të cilën e kam qëmtuar me kujdes,duke e shkruar në libra. Kjo më ka dhënë një kënaqësi të veçantë ,sepse jam munduar të lartësoj këto vlera që mos mbeten të harruara dhe të përcillen ndër breza. Për Dibrën janë shkruar shumë libra,dhe librat e mi japin kontributin e tyre. Periudha e demokracisë shërbeu si shtysë për shkrimin e tyre, si çlirim energjish për të thënë të vërtetat e ndrydhura e për të nxjerrë në dukje pikërisht ngjarje, njerëz, halle e probleme nga më të ndryshmet,gjurmime historike, etnopsikologjike, etj. Po, natyrisht kjo solli edhe devijimet e saj. Të them të drejtën, prej vitesh më kanë cimbuar, të pavërtetat që vinin nga mosnjohjet, qëllimet e padrejta, ndaj, në librat e mi"Golloborda në optikën e kohës", "Një jetë mes dibranëve", "Të parën kemi Dibrën" bëra një retrospektivë të punës sime në arsim e gazetari , punë që përvijohet për 15 vjet si drejtues shkollash në Gollobordë, më pas, 4 vjet si instruktor për arsim kulturën dhe dhe 17 vjet si kryeredaktor i gazetës "Ushtima e maleve". Kujtimet dhe mbresat e mia për popullin e asaj treve janë lënda e librave të mi. Bëmat, trimëritë , historia në prerjet dhe ndërthurjet e saj mitike, pa iu larguar thelbit të saj realist , janë fryma e këtyre librave që ngjizet brenda një poetike të veçantë. Pyetjes suaj se çfarë përbën kjo për mua, mund të them se ajo shtjellohet brenda një obligimi moral që kam pasur dhe kam për ata njerëz që njoha. Gjithashtu në këto libra shpreh sensin e një reflektimi për kohërat, situatat, reflektimet dhe debatet e ndryshme. Aty jepet kalvari i vuajtjes së njerëzve të thjeshtë, të cilët jetuan me tehun e luftës së klasave që u rrinte si shpata e Damolkleut mbi kokë, marri të tjera si tufëzimi, bunkerizimi, etj. Dhe të gjithë librat e mi mbushen me mikrofabula nga ngjarjet e përjetuara ose të vëzhguara, një dramë më vete e njerëzve të thjeshtë brenda tjetërsimit dhe denatyrimit që imponomte sistemi ideologjik, pa harruar edhe fjalën e hollë dhe ironinë dhe mprehtësinë e fjalës së mençur, prapa së cilës fshihej një mospëlqim kolektiv për çka bëhej në atë kohë. E në hullinë e kësaj varfërie dhe rraskapitje sizifiane që afronte sistemi , shkëlqente fisnikëria dhe krenaria e atyre malësorëve trima e të besës, mikpritja dhe dashuria për mikun, shpresa për më mirë.

- Ju keni punuar si kryeredaktor i gazetës "Ushtima e maleve". Një organ i vendosur nën tutelën e partisë dhe pushtetit, ku mund të flitet për një shtyp tërësisht të orientuar dhe të drejtuar në zbatimin e porosive dhe direktivave. Sipas jush deri ku arrinte kjo trysni?

- Kjo gazetë si dhe simotrat e saj në disa rrethe të Shqipërisë, nisi të shtegtojë më 1968. Shumë shpejt u bë një zë i fuqishëm në Dibër e më gjerë. Kryeredaktori i parë ka qenë Esat Bashari. Duke u bërë pasqyrë e zhvillimeve të kohës ajo goditi me kurajë shumë dukuri negative të kohës, si fanatizmin, bajraktarizmin, arbitraritetin, punën për bujë e për nam, ashtu siç theksoi edhe dukuri pozitive. Por dihet, tarafi neopotik, mungesa e kulturës për të pranuar realisht të metat, solli në këtë kohë një pështjellim. Në vjeshtë të vitit 1972, Esat Bashari u hoq dhe për 7-8 muaj gazeta u drejtua nga nga Skënder Sala, Kamber Faruku, Hysni Bruçi, Violeta Kamberi. Në korrik, 1973 u emërova unë. Shtypin e asaj kohe e pengonin një varg vështirësish. Së pari nxjerrja e gazetës në kushte primitive. Së dyti mungesa e traditës , kulturës, për tu ballafaquar me zhvillimet komplekse të jetës politike , shoqërore në një mjedis impulsiv e tepër kontradiktor. Pasi operimi në një realitet

ku mungonte liria,kërkonte një drejtpeshim dhe argumentim të kujdesshëm të të dhënave dhe fakteve të cilat duheshin selitur e përzgjedhur në atë mënyrë që mos konfrontoheshin hapur me direktivat nga lart. Edhe pse në fillim e mora këtë punë me një farë stepje ,puna, vullneti këmbëngulja, solidariteti redaksional, bënë që të rrija një kohë të gjatë në krye të kësaj gazete dhe të kapërceja vështirësitë që dilnin herë pas here.

- Sot shtypi është i lirë, po në emër të kësaj lirie, një e vërtetë shihet në kënde të ndryshme duke humbur besueshmërinë. Natyrisht në emër të kësaj lirie paraqiten të paqena si të vërteta dhe anasjelltas. Ne s`kemi ndërmend të heqim një paralele me shtypin totalitarist, por gjithsesi ne mund të sjellim si argument se si heqja e lirisë ashtu edhe dhënia me tepri e saj, shtypin e dëmton. Ju si mendoni për këtë?

- Shtypi i djeshëm ishte njëpartiak. Ai ishte i lirë në pasqyrimin e luftës së klasave në kahun që i jepte ideologjia, mund të godisje vetëm funksionarë të rangjeve të ulta, njerëz të thjeshtë, kryetarë kooperativash, dhe nëse guxoje të drejtoje tehun e satirës pak më lart, atëherë bëheshin mbledhje të gjata, me séance, ku detyroheshe të bëje autokritikë. Sot shtypi është i lirë, po nuk është e lirë mundësia e kritikës, sepse sot dënimi vjen nga persekucioni ekonomik. Kjo është e vetëkuptueshme, si klanizmi, financimi, reklama, njohjet, ndërthurjet e interesave etj., e dëmtojnë shtypin dhe i japin atij herë herë një natyrë distancuese nga lexuesi serioz. Unë mendoj se shtypi i sotëm duhet të mësoj nga ai i djeshmi natyrën investigative, edhe pse masa e kërkimit të faktit kishte një limit të lejuar. Pasaktësia e fakteve apo deformimi i tyre me të dhëna kontradiktore e vret shtypin dhe i ul kredibilitetin. Mendoj se shtypi i sotëm duhet pasuruar me gjinitë publicistike,si udhëpërshkrimet që janë të rralla, reportazhet, shkrimet kulturore, fejtonet skicat, intervistat, jo vetëm me femra të botës së modës, po me akademikë,ekonomistë intelektualë, për probleme të ndryshme që shqetësojnë ecjen zhvilluese në të gjitha rrafshet. Pastaj, jo kushdo mund të shkruajë në gazetë dhe pak i kushtohen rëndësi strukturave të ndërtimit të shkrimeve dhe ruajtjes së gjuhës nga bombardimi i fjalëve të huaja. Sot informacioni është i gjerë, në një vërshim të shpejtë dhe dendurak, prandaj edhe selektimi dhe dhënia e tij duhet bërë me kujdes. Unë mendoj se sot shtypi i është afruar më shumë njeriut në një konceptim lirik filozofik, duke paraqitur njeriun e sotëm si konsumator të shpejtë i rendur pas shpejtësive të një jete dinamike dhe moderne.

- Pra, ju si gazetar i vjetër ngulmuat se ka për të mësuar nga ajo kohë,në rrafsh profesional të shkrimit, seriozitetit identifikues të faktit, njohjes së gjuhës dhe pastërtisë së saj. Duke e vazhduar këtë ide mund të na e sillini këtu më konkretisht si një përvojë tuajën , jo të pakët...

- Puna në gazetari nuk është kaq e lehtë. Ajo duhet t`i përmbahet linjës së përcaktuar , sidomos kur flasim për një gazetë lokale, me rreze të kufizuar. Formatimi i çdo numri duhet të plotësojë interesat e lexuesve të ndryshëm. Gjithnjë duhet ruajtur sensi i masës, sensi kritik në mozaikun e tërësisë së materialeve. Rrjeti i korrespondentëve duhet të jetë i gjerë dhe korrekt. Materialet shkrimore nuk duhet t`i botojë gazetë tjetër.

Nga kjo pikëpamje, shtypi i sotëm ka për të mësuar nga ai i dikurshëm , kur serioziteti i faktit informues ishte i padiskutueshëm. Sot gazetarinë shqiptare e dëmton interneti, aq sa e ndihmon. Herë-herë shoh në to material që i kam lexuar më parë, ose shkrime të përsëritura që qarkullojnë nga njëra gazetë tek tjetra. Në shkrime të shkruara me një stil përshkrues zë më shumë vend përshkrimi komentues se sa informimi argumentues, nëse ne atëherë e lexonim çdo shkrim me lente sot, rrezik shkrimet botohen herë-herë pa u lexuar nga redaktorët dhe kjo është për të ardhur keq. Është për të ardhur keq për këtë, ashtu si dhe për rrudhjen e tejskajshme të gjinive publicistike që e cekëm më lart.

- Cili është momenti më i vështirë si drejtues, gazetar në atë kohë?

- Të ishe kryeredaktor i një organi të tillë,mes dy vëzhguesve të rreptë KQ, nga lart e KP nga poshtë ishte si të kaloje midis Skillës dhe Karibdës. I ndodhur në këtë trysni, njëkohësisht i vetëdijshëm për misionin e gazetarit kjo ishte një punë e lodhshme me sakrifica dhe devijime të shumta nga rruga, po nëse ishe i zgjuar duhej të merrje shpejt kthesat. Kur e "tejkalonim" masën e kritikës ndaj burokratizmit apo abuzimeve, siç e thashë edhe më lart , fillonin kërcënimet të tipit :Do të përgjigjesh, ose më rëndë, të sekretarit të parë:-Do tu pres duart. Më kujtohet ky moment kur gazetari Kamber Farukut iu drejtua sekretarit të parë:Nëse unë s`them të vërtetën(bëhej fjalë për një shkrim që kishte sjellë shqetësime) atëherë më prisni jo duart po kokën. Më kujtohet sesi fjalën e Farukut e rimora edhe unë sepse s`mund ta lija në baltë. Isha kryeredaktor. Ka pasur shumë momente dramatike siç është gjyqi i padrejtë ndaj Esat Basharit, ku asistonte edhe Mehmet Shehu,apo procesi gjyqësor ndaj Selim Alliut, shef i seksionit të arsimit në atë kohë,1966. Por kishte edhe skena nga më absurdet të cilat të vinin në një vështirësi ndonëse përmbanin humor të hidhur. Në një mbledhje, anëtari i Byrosë Politike, Besnik Bekteshi tha"Të ngrihet kryeredaktori e të na thotë pse nuk ka përfunduar mbjellja e grurit në Maqellarë". Ishte data 10 tetor. Ne operonim për të nxjerrë gazetën në 200 fshatrat e qytetit të Bulqizës duke rrugëtuar ditë e natë.

- Në kontakt me njerëzit e thjeshtë,a shihnit probleme që mund ti shkruanit dhe nuk mundeshit, kjo çfarë u shkaktonte?

- Puna jone u ashpërsua shumë më 1976 kur zhvillimi i luftës së klasave arriti në kulme dramatike. Survejimi dhe cekja e biografisë së tjetrit shkonte deri në tre breza. Po nuk mund të gjeje njeri pa një "cen" në biografi. Kjo gjëmë shtrihej sidomos në politikën e kuadrit dhe në selektimin monstruoz që i bëhej brezit të ri për të ndjekur shkollën. Kam parë shumë njerëz që rrinin të nemitur , që kërkonin një të drejtë legjitime , e që ndjenin dhimbje të madhe kur shikonin fëmijët e tyre me nota të shkëlqyera po nuk mundeshin të shkonin në shkollë , sepse dilte dikush dhe u përmendte një dajë apo gjysh që ndoshta komunizmin s`e kishte njohur. Këto nuk mund t`i pasqyronim , ashtu si nuk mund të pasqyronim marri të tjera të projekteve të dështuara ekonomike që sollën varfëri të madhe në popull. Unë, megjithatë, kam gjetur raste dhe mundësi, pa shkelur ligjet, për të ndihmuar njerëz. Në librat e mi "Një jetë mes Dibranëve" dhe "Të parën kemi Dibrën" mund të gjeni plot episode dhe shembuj të pakontestueshme të këtyre ngjarjeve dhe fakteve me njerëz të njohur e të panjohur.

- Ju si studiues jeni marrë me hulumtimin e vlerave kulturore të Gollobordës. Çfarë sjell kjo trevë në pasurimin e vlerave kombëtare?

- Vite punë u kam kushtuar hulumtimeve dhe gjurmimeve për folklorin e Gollobordës. Botimi i katër vëllimeve të këngëve folklorike "Gollobordski Follklor"dhe dy vëllimeve"Narodni pesmi", janë punime në dy gjuhë, shqip dhe maqedonisht. Këto punime studimore kanë parë dritën e botimit ,përgatitur nga një grup intelektualësh, Cvetan Mazniku, kryeredaktor, As. prof. Vita Koja, Mitro Shuku, Velo Cfarku, Trifon Cfarku, Fidan Marku,me botues Prof. i asociuar Kimet Fetahu. Botimet paraqesin thesarin e pasurisë etnokulturore të krahinës së Gollobordës si pjesë integrale e Dibrës. Deri tani janë mbledhur 3500 fjalë të urta dhe s`ka dyshim që do dyfishohen. Gjithashtu janë mbledhur 500 këngë. Këto këngë janë një mozaik me shumë ngjyra , ato janë poezi tingëlluese që shprehin shpirtin e popullit në rrethana e kontekste të caktuara kohore përmes trimërisë , atdhedashurisë dhe punës. Si lule të shumë ngjyrta ato u ngjajnë buqetave që nuk vyshken kurrë duke krijuar një ansambël folklorik unikal në vetvete,nga ku mund të mësohen shumë gjëra në një reliev vitesh të stuhishme ku plazmohet një histori bashkëjetese dhe harmonie për t`u pasur zili.

- Në gazetën "Ushtima e maleve", është instruktuar dhe kanë gjetur përkrahje një numër talentesh të reja që kanë bërë emër më vonë. Nga një lartësi dhe largësi vitesh si e çmoni këtë ndihmesë dhe sa i gëzuar jeni për këtë?

- Kjo gazetë llogarit në totalin e saj nëntë milionë kopje me 25000 autorë shkrimesh, bashkëpunëtorë. Ndër bashkëpunëtorët do të veçoja: Bajram Totrakun, Mevlud Bucin, Halil Ramën, Jorgo Kolën, Kujtim Boriçin, etj. Ajo ka qenë e hapur për të gjithë intelektualët e asaj kohe. Në një intervistë botuar tek "Rruga e Arbrit" prof. Shaban Sinani thotë: "Dibra ka qenë stacioni i parë i jetës sime krijuese... kam kryer shkollën Pedagogjike në Peshkopi por kjo nuk do thotë se kam kryer shkollën e Dibrës...Kam filluar të shkruaj si nxënës që 14 vjeç tek Ushtima e maleve..." Sipas tij "Parimi i sotëm i dijes është të shohësh veten në pasqyrën e tjetrit. "Ka pasur emra të nderuar që nga Melita Shehu, ... Maliq Bitri, Naim Plaku etj etj, që shkruan e punuan me përkushtim. Historia e njeriut të kulturës dhe publicistikës nuk mund të kuptohet nëse ai nuk shtron udhe e hap horizonte për të tjerët. Koha gjithnjë u vë emër gjërave dhe modifikon shtrembërimet ,sepse patjetër një ditë çdo gjë shkon në vendin që meriton....

Rruga e Arbërit nr. 80

reportazh

Meditim në dymijë e dyzetemetra lartësi

Panorama e bukurive magjepse

Nga **SELMAN MËZIU**

(Vijon nga numri i kaluar)

BARIU DHE GJEOGRAFIA

Sakaq, dhe i afrohemi një grumbulli ahu, ku poshtë tijë një grope me ujë. Këto janë lera, iu shpejgova shoqëruesve. Ndërtohen me shtresën e plasmasit, me pas hidhet dhe pa asnjë gurëz me trashësi njëzetë centimetra. Vjen rradha e një kalldrami me gurë mesatar, vendosur përmerak e shoqëruar me një unazë gurësh vendosur ndryshe nga pjesa tjetër.I ngjante një oazi me bukuri te rrallë

Njohja e shoqeria me inxhinierin Luan Leka, më ndihmoi me një informacione të çmueshëm:''*Në kullotat verore të ekonomisë kullosore mbas Deje-Bulaç, gjate viteve 1980-1985 dhe më tej deri më 1993, janë ndërtuar mbi 23 lera uji, me kapacitet 240-250 metro kub.*" Sa mirë, kur punimet në këto vepra arti bëhen sipas një teknike bashkëkohore! Projektet janë zbatuar me saktësi dhe siç shihet punimet janë kryer me cilësi. Mësojmë se emri popullor i këtijë vendi është Hurdha e Shqaut, për vetë formën natyrale që kishte dikur. Nuk mundëm të zbulonim prejardhjen e këtijë emri. Ndoshta me një udhëtim të përsëritur, kushedi se kur do ta realizojme edhe këtë. E do të pasurojme listën toponomistike me emrat e këtyre vendeve reliev shumtë të faqes lindore të vargmalit të Runjës.

Në afërsi të kurrizit më të lartë, takojmë një gropë të madhe, me një thellësi 26 metra, diametri në fund afersisht katër metra, dhe në sipërfaqe, sëpaku gjashtëdhjetë e dy metra. Me një formë gjemoetrike të përsosur rrethi. E mveshur me barin e gjelbërt, që jeshilonte. Janë keto rezultat i formimit nga vullkanet te miliona viteve kur u formua koria e tokes. Të tilla në këto hapsira janë të shumta, duke i emërtuar këto vende edhe " *Gropat e Plleut.*"

Ndërkohe drejtohemi përgjatë kurrizit i cili është mjaft i mprehtë si i një kali gjigandë kuna rajvizohet maja e Runjës. Takojme bariun Veli Deva. Një djal imcak me fytyrë paksa të rreshkur nga dielli ku lëviznin dy sy te vegjël por të ndritshëm. Në dorë mbante një shkop në formë T-ëje. Mbante varur në qafë torbën me bukë e shishen me ujë. Fytyrai qeshi menjëherë sa na pa. Na zgjati dorën duke na pyetur, se a na lodhi ngjitja nëpër bjeshkë. E ndërkaq nuk ngopemi duke kullotur sytë në peisazhet e paanë, na habitin e njëkohesisht na ngjallin kënaqësi të pa provuar ndonjëherë.

Dëshira ime ishte të mblidhja disa të dhëna toponomistike, prandaj dhe fillova t'a pyes mbi disa vende, ai me një zë të hollë, por ndjente siguri kur fliste, duke më rradhitur: Përgjatëkurrizit në drejtim verior:*Runja e Vogël, Maja e Madhe, Maja e Shirkut*, *Livadhet e Kurte*, shpati drejt poshtP*llaut të Lukanjakëve,* quhet *Gripat*, ku duket në mes, një mozaik dhjetra gropash shumë përmasashe ku dukesh edhe një ah i vetmuar me nje kurorë ombrellore të stërmadhe. Një mrekulli emocionuese dhe e habitshme.

Ndërsa si një sy i vogël ngjyrë kaltër qe reflektonte rreze drite në këtë perëndim dielli të purpurt, është një lerë uji ku dhentë shuanin etjen edhe në këto ditë shumë të nxehta Gushti. Me të drejtë tha Veliu: Ja ajo eshte jeta e blektorisë, megjithëse siç e shihni tani këto tufa jane shumë, shumë më pak se para njëzetë vjetësh. Megjithate une shpreh mirënjohjen për projektuesin inxhinierin e pyjeve Luanin, për zbatuesin e këtyre projekteve, Zooteknikun Fehmi Lleshi e punëtorët që derdhën djersën e punuan me ndershmëri si Enver e Agron Lleshi, Urim Kovaçi, Xhavit Miha, Rakip e Shefki Losha, Nazmi e Nazif Bushi për këto monumente sykaltëra.

Në qiellin e kthjellët, dy shqiponja fluturonin në qiellin e lirë, duke i rënë rreth e rreth majës së Runjes, ato sikur "notonin" në hapsirën e pafund blu të thellëdhe shikonin poshtë neve, delet, e bariun qe iu rrinte atyre gjithmonë pranë me gjithë të vëllain. Kënaqësia na pushtoi çdo qelizë të trupit tonë e cila grafulloi nga shpirti ynë i lumturuar. Ku shprehej në syte tanë, në fytyrat e në gjestet qëbënim duke përpimun me vështrimin tonë natyrën bukuri rrallë dhe këto dy shpendë krahë hapur, sikur hidhnin valle në hapsirën e pafundme të qiellit blu. Ato ishin vërtet sundimtar të tijë, qeverisësit e hapsirës toksore e ajrore. Fatkeqësisht shoqëria njerëzore dhe parasëgjithash shqipëtarët nuk janë të tillë, sëpaku këtë fillim shekulli.

MEDITIM NË DYMIJË E DYZETEMETRA LARTËSI

Jovetëm mushkëritë mu mbushën me ajrin e pastër të majë maleve, por frymëzimi mi hapi fletët, menia më fluturoi tek vargjet e paarritëshme Naimiane:

Kini shkëmbinj, gërxhe, lisa, lumenjdhe dëborë ndë gji,

Përsiprë lulez'e gjethe dhe brënda ergjend flori;

E ju fusha bukuroshe, edhe të majm e pjellore

Ju sheshet e lulëzuar ju bregore gjelbërore,

Ndërkaq rrokullis vështrimin përgjatë peisazhevetëpamatshmeetëmrekullueshme Dibrane. E shikoi si në pëllëmbë të dorës, gjithë gropën e saj pse jo shumë më shumë. Mos vallë poeti i frashërajve u frymëzua nga ky vend?Kaloj lehtësisht e plotë emocione, e kënaqësi në thellësitë e luginave të Përroit të Pllaut, të Murrës, Setës e Drinit kaltërsi ndjellës. Ky i ngjanë një gjetani kaltërosh përmes fushës së Dibrës, lakore bardhoshe të shoqëruara me të gjelbërten e shelgjeve, dhe hyjë vetëvetiu natyrshëm në honet e kohërave, për të nxjerrë që andej dituritë e shkruara, veçse fatkeqësisht disa në latine e disa në hojet mjaltëmbajtëse të kujtesës, në forma përshtypje ose ngjarjeve, e rapsodive të trasmetuara nga brezi në brez tek banorët erranxë runjasve.

Padoviani Tito Livio do të shkruante mbi legjionete Perseut maqedonas të cilët pushtuan njëri pas tjetrit qytete peneste dhe pas disa vitesh, gjneralin romak Paolo Emilio me një egërsi të tmerrshme, pa meshire dhe me shpirtin mekuar me sadizëm do të shkatërronte plote 14 qytete e fortesa në gjithë Penestine, do të merrte shumë skllever e çonte ne kryeqytetin e perandorisë së tijë. Ky emertim do të humbte ëe mugëtirën e shekujve duke u zëvendesuar me emrin e fisit të Deberëve.

I madhërishmi Beçikemi (Barleti) do të shkruante: *"E Poshtmja(Dibra) është gadi e gjitha e rrafshët dhe e rrethuar me fusha pjellore, që prodhojnë çdo gjë. Arber dhe Epiriote banojnë në atë vend, popuj shume trima në luftë, me armet e të cilëve në rradhë të parë e shpetoi dhe e rriti Kastrioti mbretërinë…"*

Dhe matnjani në fillimet e shekullit të njëzetë do tëpyeste një dibranë të këtyre anëve diku në këtë vargmal: *Vërtet Dibra ka Univesitet?*

Vështroi poshte Selishten, Lunaren, Qafë Murrën, Lukanin, grykën e Kacnisë dhe "shigjeta"emendimitshënojnë*MevludBucin*, i cili ka shkruar mbi 15 libra, monografi mbi doket, zakonet , traditat, portrete luftëtarësh e patriotësh, studime në rrafshe të ndryshme historike dhe qindra artikuj në dhjetra revista e gazeta. Janë nga një penë e ngjyer frymezueshëm në trashgiminë etnografike e historike të Katër Grykëve, e të Dibrës në përgjithësi, një gjerdan dritash llamburitse në kohërat që do të vijnë.

Te *Hysen Lala* historian kërkues, këmbëngulës sa s'ka, kështu i mirënjohur e mjaft pjellor.*Hysni Bruçi* ku me poezitë e shkrimet e tij ka kërkuar çarjene e errësirës së paditurisë të këtyre trojevekreshpore por bujare e zemer bardhë, per të rrezatuar vërtetësi nepërmjet molekulave të diturisë, por plotë nektar jete.

Rrëshqas luginës sëngushtë të Murrës e përfundoi te banorët buzëdrinas, ku tashmë shkrimtari dhe poeti *Naim Berisha* pasardhësii gjeneralëve të Gjergj Kastriotit,

Syri i kalter-Lera

reportazh

Gjuri i Vashes

Dhimitër e Nikollë Berishës, e përdor penën e tijë çudiberëse si dikur këto trima dhe heronj kordhëtar, shpatën. Ai vazhdon të shkruaj librin e njëzetë, një rendimentë i pazakont. Gjithëçka e ndërthurur me shpirtin poetik me frymezimin në ngjarjet e plleshme të përthithura nga universiteti popullor dibranë.Ai iu vënë vulën e gjuhës, stilin, dialogun, përshkrimin e ngjarjeve, emërtimet e vend ngjarjeve e heronjëve, kryekëput Dibrançe.

Ndërsa *Fadil I. Hoxha* derdh frymëzimin e tijë në vargjet kushtuar Drinit e heronjëve të kohërave të ndryshme, "*Adem Jasharit tëKosovës*" dhe më tej "*për fatkeqen tonë Çamëri*" duke çimentuar me fjalën e ëmbël por rrëmbyese e thellësisht emocionuese shpirtin heroik e luftarak të shqiptarit, si dhe duke iu dhënë shpirt e zemër heronjësh homerian bijëve të këtijë populli ne shekuj të ndëshkuar nga fqinjët gjakatar e mizor.

Ndërsa nga Mresti thur me delikatesë poezinë *Agim Deva*, me arome lule zonjë e shpate, shkruan thjeshtë, me një këndveshtrim te veçante por rrëmbyes, admirues dhe investon që dituria të "gëlltitet" menjëherë nga mbare opinioni shqiptar e veçanerishtdibran në çdo pllam të rruzullit toksor, duke futur ne internet gazetën prestigjoze "Rruga e Arbërit"

E shumë të tjerë rrëzë vargmaleve kreshpor e hijerëndë të Runjës pa hyrë më tej në hapsirën që nuk rrekem t'i perpijë, t'i fus në gji, pse jo në zemrën time, për të shuar shkulmat e mallit që më djegin e përvëlojnë njëkohesisht gëzimin e ylbereve të diturisë qe bashkojne vargamlet e kohërave me gjithëçka perrreth. Por natyra me bukuritë e saja, njerëzit ne breznitë e pafunme ne qindravjeçarët, jane kaq shumë saqë nuk mundem.

Kjo pamundësi është përthithur nga realitetihistorik shqiptar, nga politikat ekonomike, demografike, nga meskiniteti, mefshtësia dhe pangopësia për vete e politikanëve te këtijë fillim shekulli. Unë bashk me Naimin, Fadilin, Agimin, dhe qindrate tjere kemi marrë udhët e muhaxhirëve, të braktisurve nga mëmëdheu. Por nga andej në pika të ndryshme të globit kërkojmë të hedhim rreze drite mbi magjinë e tokes e njerëzve dibranë të fshehura mjerisht në gërmadhat e kohërave, por gjithmonë me buzë duke puthur tokën në zabele, shkrepa, lugina, maja e shpate bjeshkësh, burimesh ujëftohta. Ndërsa mendimin e materializojmë për vendin kun na ka rënë koka. Ashtu siç do të bëjnë të sapodiplomuarit e universitetit të parë të Dibrës. Amen! Ashtu qoftë e u baftë!

LEGJENDA E VASHËS DHE E FLAKËVE

Lemë majën më kulmore të Runjës dhe ndjekim kurrizin e vargamlit në drejtim prendimor. Tanimë qëllimi im realizohej kur të shikoja sa më qartë Gurin e Vashes, Vanasin dhe vargmalin eDejes e të Balgjait ku janë plazmuar ngjarje historike e kujtimet e mia të shumta të rinisë.

Nën këmbët tona bari i ngjane tufave të sixhadeve që thurnin në razbuje, Lukanjaket, Selishtaset, Qafë Murraset, mjeshtre leshë punuese, ku thurnin sixhadet, mutafët, rrugicat etj. Zbukuruara me mjeshtri e shpirtë artistik, me pëllumbin, shqiponjën, lule të ndryshme e po kështu me zogj e dele, sorkadhe e gjithë natyra e shkrire në jetën intime të tyre etj. Pranë Fushës së Vanasit ngrihet Guri i Vashës, me shkëmbinj gëlqeror majëmprehtë, ngjyrë hiri e njolla te gjelbërta bari aty këtu. Ne Verën e vitit njëmijë e nandëqind e shtatëdhjetë e nantë, kam fjetur në çadren e ruajtur nga Islam Gjoka nga Strikçani, dhe i kam ramun kryq e tërthor ahishteve e pishnajave të gjithë pellgut të Përroit të Pllaut me ixhinierin e mbarështrimit Skënder Kastratin. Me harta e instrumenta duke matur drurët, ndarë e matur sipërfaqet pyjore, djerrinat e livadhet. Aty mora elementët e para të teknikës pyjoredhe alfën e kulturës profesionale të inxhinirit të pyjeve.

Sakaq u zgjova nga ky pushtim i këndshëm kujtimesh, e dëgjoi aromën e pishave të djegura ndërkaq shikojmë një re tymi që po na afrohet. Pishnajat e vargmalit të Dejës villnin tym të zi, duke filluar nga Shkalla e Deshëve e gjer mbi qytetin antik të Stelushit. Ndërsa shpatet me dushkaja në Perëndim te Lukanit iu shikohej tymi shtellunga - shtëllunga. Zjarri vazhdonte të shkrumbonte gjithëçka në këtë situatë alarmuese, ne nuk dëgjuam as sirena, as zhurmë avionesh, as britma njerëzish në shenjë kushtrimi, për ta përzan hirëzimin e pyjeve shtatëlnatë të pishnajava apo të dushkajave.

Lugina e Vanasve, ka legjendat e saja, tregohen histori të shumta dhe toponomistikën çudisjellëse e kureshtare. Rruga e Qytetit antik të Lisit, vinte e ndalesh tek ai i Stelushit ose Kalaja e Skënderbeut, një degëzim ndahesh për Katunin e Vjetër, një tjetër vinte te Guri i Vashës ku një udhë të çonte në fshatin Lukan, e tjetra në Qafe Benë e cila lidhesh me Bulaçin e Sinën ndërsa një degëzim dytësor të çonte në Hurdhë Muhurr, me tej kemi toponimin *Fusha e Gjonit (Jovanit)* dhe më tej një kodër që quhet*Kalaja e Skenderbeut*, ku pas sajë ndahet nje rrugë që hypën tek Gropat e Pllaut e të çon te *Shkalla e Mëzeze* duke zbritur në Sinë apo nëpermjet Majës së Shkurt zbret në Çidhnën e Epër, e tjetra vazhdon, pra qëndrorja, Zhuret ku takojmë fshatin*Xhileta* në të cilin banonin, familjet e *Ali Kallabës, SulMuratit (Heta), Brahim e Gafurr Dedës,* që në ate kohë kur unë udhëtoja me opinga nëpër keto brinja e kodërza, Gafurri ishte familia e fundit që e braktisi këtë fshat. Ato u stabilizuan nërrethinat e Lezhes. Rreth tijë kemi emërtimet: *Ara e Gjatë, Çelikija e vjetër* dhe *Farka*. E më pas një degëzim shkon nëper Prroin e Setës e zbret në Gjure Lurë, Xhaxhaj etj e një tjetër, kalonpërgjatë Livadhit të Qeshkës, Liqenit të Luleve, varet poshtë Liqeneve të tjerë e perfundon në Borie Lurë.

Rruge me jetegjatesi qindra shekujsh ku me sa dihet ka kaluar ushtria turke me vetë Sulltan Mehmeti i II, kur sulmoi Kalanë e Çidhnës nëGushtin e vitit 1466, ushtria e Gjon e Gjergj Kastriotit etj.

Ndërsa rapsodi muhurrak i thur vargjet njërës nga heroizmave të pashoqe, për të mbrojtur trojet e tyre në Pllajë, kundër beut të Burgajetit të Matit, duke i kënduar me çiftelinë me dy tela e gdhendur plotë art prej druri mani, të cilin populli me të drejtë e quan *drurin e qejfit*:

Nezir Lleshi me Ali Lalën, dimdhetë mijë dhen i kanë vu përpara,

Kush po hik nga gjuri iVashës, po hikin asqerët e Xhemal Pashës,

Pushka e Muhurrit dhe e Nezir Lleshit po ban kredinë në asqerët e mretit.

Ndërsa tani mezi dalloi ndonjë skodë ngarkuar me dru e ndonjëzhurmë motosharre. Në ato vite kur unë punoja, Vanasi gumëzhinte nga sektori i shfrytezimit pyjor, i cili varesh ngandërmarrja e shfrytezimit Burrel, me inxhinier Aqif Dezhgiun.

Legjenda tregon, se kur djemtë e rinj shkonin nizamë (ushtarë në ushtrinë turke. S.M.), te Guri i Vashës ishte nje strehe kepi, kalonin djemte e rinj të cilët futeshin nën atë dhe kujt i arrinte koka, shkonin e rradhiteshin ne ushtrinë turke. Vashat grupe prupe përcillnin vëllezërit ose të dashurit, qanin me kuje, mu këtu, derisa të largoheshin. Ato nuk dihesh nëse ktheheshin përsëri në gjirin e famljeve të tyre.

Ndërsa thuhet se njëherë, nga rrufeja mori flake një Arnen, aty pranëzanat e malit e panë dhe u afruan ta fiknin që të mos përhapesh. Në përpjekje e sipër njëra nga ata merr flakë, se i ranë disa pika katram i djegur. U përpoqën të tjerat ta shpëtonin, por më kotë. Ajo u flijua për të mbrojtur drurin gjigandë të Arnenit, per here të gjelbërt me kurorë madhështore dhe trup si fyell të gjatë. Në vend të tijë mbinë lule shumëngjurshe e petale shumta.

Nga lart me dukej vetja si një Zeus në olimpin tim, deshirojaedhe unë t'iu bëja mire njerëzisë përshembull për të vizituar natyrën që të argëtoheshin, që të merrnin frymë lirisht duke përcjellur kështu në thellësi të shpirtit mrekullinë e natyrës, rrespektin dhe ndjenjën e ruajtjes së sajë gjithashtu edhe konservuar e vënë në sherbim të njeriut me kulturë, edukatë e dije.

* * *

Tanimë dielli po humbet në vargmalin në mes Dejës së Madhe dhe asaj të Vogël që vazhdon të tymos bollshëm e zitueshëm. Tymishkulme shkulme e gjuhët e flakëve kanëpushtuar pishnajat, e ndërsa dielli i kuqëluar, kërkon t'i largohet kesaj mynxyre natyrore e njerëzore njëkohesisht. Ne të pafuqishëm i kthejmë shpinën, dhe sakaq arrijmë në Majën e Runjës, ku lexojmë shifrën 72 veta, qershor 2012. Shpresojmë që këto njerëz të kene gjetur borën e shijuar bukurinë joshëse të sajë, pse jo të kenë marrë me vehte tufa me lule Zonjë, ashtu te bardhame bukuri pushtuese dhe thithur me plotë ëndje aromën e tyre mjaft të këndshme.

Ndërsa ne të lodhur fillojm të zbresim shpatin e pjerrët, të bindur se edhe me ndihmën e Hamit Ballës, Ismail Manit, Selim Dacit, Nazif e Xhelil Mëziut kemi shkruar ato pjesë të veprimtarisë se banorëve buzërunjas, që pelhura e frikshme e ngjyrë zezë e shekujve na e kishte mbuluar, fshehur. Tani njerëzit do të dijnë me shumë, do të flasin e diskutojne plote siguri e me shkathtësi të diturish, sigurisht do të kërkojnë që monumentet e historsë e tënatyrës ti konservojne ashtu si të mençurit e punëtorët konsrevojnë kohën.

17 Nëntor 2012

Peisazh i mrekullueshem



Paria e Dibrës,
formimi e cilësia e saj

Nga **XHAFER MARTINI**

Studimi, prejardhja, formimi dhe cilësia e parisë së Dibrës ndikojnë në studimin e historisë së kësaj treve në tërësi, mbasi paria ishte ajo që kishte përgjegjësinë historike për udhëheqjen e popullit. Popujt kanë nevojë për drejtim dhe udhëheqje që t'u dalin zot interesave të veta. Në pari përfshihen edhe njerëzit e shkolluar, intelektualët atdhedashës, me rolin e tyre ndriçues. Por paria mund të jetë atdhedashëse e kombëtare, por mund të jetën edhe e shitur ose e mefshtë e jovizionare. Natyrisht, jo e gjitha dhe jo për të gjitha kohërat. Historia na tregon shumë raste kur popujt, edhe pse janë therorizuar, nuk kanë arritur rezultate pozitive, sepse janë tradhtuar nga udhëheqësit, ose vrulli dhe energjitë e tyre janë ndalur në mes të rrugës, pikërisht në kohën kur janë përmbushur interesat e atyre që i ngritën në luftë. Prandaj me të drejtë është thënë se "paria... është duar-duar: një pjesë karakterizohej vetëm nga interesat personale, kurse një pjesë edhe nga interesat kombëtare. Prej një qëndrimi të tillë kjo pari "ka anën e vet të errët dhe të ndritur: në një brez ka arritur të bëjë shumë për vendin e në një brez tjetër ka dështuar ose i ka bërë të zezën atdheut".(Sh. Sinani: "Një Shqipëri etnografike-politike në kujtimet e Ismail Strazimirit", Pasthënia" (Në librin "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", Tiranë 2011) Kemi tri lloj parish:

1) Pari rrënjëse, e lashtë, me gjak aristokratik;

2) Pari me prejardhje nga shtresat e thjeshta të popullit, e formuar nën kujdesin dhe për interesin e Perandorisë Osmane;

3) Pari me prejardhje nga populli, por prej atyre shtëpive dhe fiseve që u dalluan për kontribut në Lëvizjen tonë Kombëtare, jo vetëm pa lidhje me Perandorinë Osmane, por edhe luftëtare kundër saj.

Paria e lashtë, rrënjëse, me gjak aristokratik, është e periudhës paraosmane, duke përfshirë këtu edhe periudhën skënderbegiane. Sundimi i kësaj parie ishte në principatat që përbëheshin kryesisht prej zotërimeve të tyre. Formimi, psikologjia, roli i kësaj parie ishte përgjithësisht si ai i parisë së vendeve europerëndimore, pavarësisht se rruga e zhvillimit dhe niveli i zhvillimit në të dyja brigjet e Adriatikut nuk ishte i njëllojtë. Ishte kohë luftërash të përgjakshme, "...kur romakët, venedikasit, normanët, anzhutë kërkojnë "kapërcimin e detit" me synimin Konstadinopojën. Bizantët, bullgarët, serbët e së fundi, osmanët, lakmojnë daljen në Adriatik. Në një truall të tillë formohen dhe konsolidohen familjet e bujarëve arbër: Engjëllorët, Topijat, Dukagjinët, Arianitët, Blinishtajt, Zenevisët, Gropajt, Balshajt, Spatajt, Muzakajt, Komnenët."(A.Plasari: " Vija e Teodosit shfaqet. Nga t'ia mbajnë shqiptarët", Tiranë 1995,f.2) Kjo ishte paria e Arbërit.

Aso kohe edhe ne kishim kontë e baronë si gjithë Europa. "Deri në fund të periudhës humaniste dhe në prekjen më të hershme të ish-perandorisë osmane, dheu i Arbërit ishte i organizuar me zotërime të ngjashme me ato të Europës. Ky ishte një vend që kishte dukë(si Dukagjini), kontë (si kont Urani), kapitenë, si "capitaneus montanae Hottorum", që përmendet nga M. pl. Sufflay në veprën e tij "Serbët e shqiptarët." (Sh. Sinani: "Epos në etnos",Tiranë 2011, f. 165)

Në atë kohë kishte një hierarki vlerash që përcaktohej nga gjaku rrjedhës. Nuk mund të ngjitej në asnjë post dhe në asnjë përgjegjësi një person që nuk i përkiste asaj tufe njerëzish që e kishte të trashëguar rolin parësor në histori. Populli i thjeshtë vetëm ndaj pinjollëve me këtë prejardhje tregonte respekt dhe bindje. Respekti dhe bindja ndaj sojit u kthye në një traditë dhe u bë pjesë e saj duke depërtuar edhe në Kanun, ku, veç të tjerave, u jepej kryet e vendit pikërisht atyre që kishin pastërtinë e gjakut dhe nderin e papërlyer në disa breza njerëzorë. Një pinjoll që i përket parisë rrënjëse shkruan: "Prijës në fisin dhe në shoqërinë shqiptare, sado demokratike të ishte organizimi i saj, nuk bëhej thjesht ai që ishte më i zoti, por ai që, krahas vetive personale të shkëlqyera, mund të paraqiste edhe epërsinë e sojit dhe të traditës. Tek asnjë popull tjetër i botës, hierarkia lindësore nuk është respektuar me një saktësi të tillë të heshtur, por të ndërgjegjshme si te shqiptarët. Në tubimet e gjithmbarshme popullore, në ato të fisit, të krerëve, etj., secili e dinte me saktësi vendin që duhej të zinte dhe radhën për të folur." (Eqrem bej Vlora, Kujtime 1885-1925, Tiranë 2003, f. 556)

Mbas vdekjes së Skënderbeut, për të mos jetuar në robëri, kjo pari ikën në Europën Perëndimore, kryesisht në Itali. Turku, me pushtimin e tij, e rrafshoi Shqipërinë. Nga paria e hershme mbetën fare pak trashëgimtarë, por edhe ata të rënë në varfëri.

Paria e formuar nga halia është produkt i huaj, i pushtuesve osmanë. Turqia ishte kundër parisë rrënjëse, të lashtë, edhe sikur ajo të kishte mbetur e paprekur. Turqia donte të formonte një pari të re, të përshtatshme e besnike që ta qeveriste popullin me anë të saj. Prandaj ajo i shtoi gradat dhe ofiqet për njerëz të aftë dhe të gatshëm për t`i shërbyer Turqisë. Ajo edhe shkolloi një pjesë të mirë të tyre. U shtuan bjelerët dhe agallarët, pashallarët etj. Dalëngadalë po formohej një shtresë e re e pasur dhe e pushtetshme, besnike ndaj Turqisë dhe në shërbim të saj. Turqia vetëm në këtë pari që e kishte formuar vetë mund të mbështetej. "Synimi i qeveritarëve qëndrorë osmanë të atëhershëm ishte të minonte ndikimin dhe pozitën e bejlerëve të mirëfilltë, kështu që ata i jepnin titullin bej çdo kusari që komandonte dhjetë ushtarë rrogtarë. Ata dëshironin të shkaktonin një inflacion të këtij titulli..." (Eqrem bej Vlora, aty) Turqia e nxiste dhe e përkrahte formimin e kësaj parie të re, por nuk ia jepte çdo kusari titullin e lartë dhe pasurinë. Ajo zgjidhte dhe përzgjidhte ata që kishin më shumë merita. Më mirë se kudo procesi i rënies së shqiptarëve në duart e Perandorisë Osmane dhe vënia e tyre në shërbim të saj del në librin e Sami Frashërit: "Personalitetet shqiptare në Kamus Al – al\ am" , ku thuhet: "... pasi shqiptarët hynë në administratën osmane, të gjithë bejlerët dhe njerëzit autoritativë menjëherë e pranuan fenë e drejtë islame. Pas pranimit të Fesë islame nga ana e tyre, gradualisht edhe të tjerët filluan ta pranojnë, kështu, për një kohë të shkurtër 2/3 e popullit shqiptar u bënë muslimanë, kurse 1/3 që mbetën u ndanë, gjysma në ortodoksë dhe gjysma në katolikë. (Shqiptarët) u bënë të përbashkët me osmanlinjtë, kaluan në ngritjen dhe famën e Shtetit Osman, u bënë shumë dashamirës dhe ndihmës në zgjerimin e pushtimeve osmane... Edhe shteti Osman, duke i çmuar lart shërbimet dhe miqësinë e tyre, u besonte pozitat më të larta shtetërore. Shqiptarët morën pozita të larta në shtetin osman; vetëm pashallarë, të cilët u bënë sadriazema(kryeministra) ishin 25, madje, në mesin e tyre kishte të tillë që në kohën e Sulltan Selimit të parë dhe Sulltan Sulejmanit, arritën të bëhen sadriazema nga pesë herë." (f. 40, Shkup 2002)

Kjo besnikëri e parisë shqiptare (dhe dibrane) ndaj Turqisë nuk zgjati përgjithmonë. Duhej të kalonte mjaft kohë që kjo pari të ndërgjegjësohej se i takonte një kombi të robëruar pikërisht nga perandoria të cilës ajo i shërbente. Pjesëtarët e kësaj parie përgjithësisht patën një personalitet të dyfishtë: atdhetarë të vendit të vetë, dhe uzurpatorë e shtypës të popujve ku qeverisnin. Ky ambiguitet i parisë përcaktohej nga faktorët politikë. Qeveria turke e krijoi parinë se i duhej për të qeverisur vendin. Ajo e njihte popullin kryengritës dhe kokëlart shqiptar. Ai nuk nënshtrohej veçse duke ia gjetur mënyrën për ta nënshtruar. Kjo ishte ruajtja ose krijimi i një tradicionalizmi të ri që populli të udhëhiqej nga krerët e tij tradicionalë, në bazë të kanunit, ligjit të tij të pashkruar, por që kishte dëshmuar efikasitetin e tij. Turqia diti dhe ia arriti ta ripërtërijë infrastrukturën vetëqeverisëse të shqiptarëve, të cilëve u njohu dhe ua përkrahu edhe kanunin. Përpos tij u krijuan edhe instucione të tjera. Institucioni më i rëndësishëm ishte ai i Oxhakut. Oxhaku i parë dhe më i fuqishmi në Dibër të Madhe, por edhe me ndikim në një pjesë të Dibrës së Vogël, ishte Hoxholli, me toka dhe pasuri. Në Dibër të Poshtme kemi tre Oxhaqe: Hysenagollin në Dohoshisht, Karahasanin në Brezhdan dhe në Luzni dhe Xhilaga në Deshat, me të drejtën e sundimit edhe në Dardhë.(H. Stërmilli: "Dibra në prag të historisë, dorëshkrim, f. 131)

Në Dibër me ndikim ishin edhe shtatë Teqet e Dibrës: e Haxhi Osmanit, e Borovjanit, e Limjanit, e Brezhdanit, e Tominit, dy teqet e Vleshës.(Xh. Ndreu: "S\ka qetësi në Lisivalle, f.49)Teqet kishin pushtetin shpirtëror, por përziheshin edhe në politikë. Siç shikohet, kemi disa shtresa pushtetesh, të lidhura dhe të kombinuara me njera-tjetrën. Turqia nuk mund të qeveriste në Dibër përveçse me një formë të tillë organizimi dhe me kombinimin e kaq shumë pushteteve. Porta e Lartë kuptoi se më mirë sesa me shtresën administrative burokratike, qoftë kjo turke apo shqiptare, shqiptarët i mbaje nën fre me qeverisjen tradicionale, që bëhej nëpërmjet kanunit. Atë Gjergj Fishta tek "Lahuta e Malcis" ka edhe këto vargje:

"Edhe Mbreti ket hismet
Deri-diku na e ka pëlqye
S`na ka lanë krejt m`u thye
na ka lanë liri jetike,
na i ka lanun armët besnike
për me ruejt fe e zakona
për me mbajtë Kanun e t`parve
me ruejt erzin e shqyptarve" .(Gj. Fishta: "Lahuta e Malcis", f. 108)

Të gjitha këto Perandoria Osmane i bëri për të qeverisur më lehtë dhe më me efikasitet. Por ato risi ishin edhe shprehje e tolerancës së saj që jo një herë është vënë në dukje nga historianë të krishterë, që vetëm objektiviteti shkencor i ka çuar në një përfundim të tillë. Njëri prej tyre është historiani i njohur Armin Hetzer që ka shkruar: "...një nga vështirësitë më të mëdha dhe problemet kryesore të shkrimit objektiv të historisë së Shqipërisë është qëndrimi mohues i historiografisë zyrtare ndaj rolit pozitiv të Perandorisë Osmane për ruajtjen e ekzistencës dhe të zhvillimit të shqiptarëve". (H. Feraj: "Engjëll Sedaj apo Savë Batarja", në "Rimëkëmbja", 28 mars 2000)

Por qeverisja e shqiptarëve nga vetë shqiptarët në emër të interesave të Turqisë nuk zgjati pambarim. Porta e lartë u zhgënjye nga paria që e kishte krijuar vetë, e cila nuk i qëndroi besnike. Kundërshtimin e parë ata që bëheshin të fuqishëm e kishin në emër të mëvetësisë. Ndjenja të tilla dhe përpjekje për t\i sendërtuar nuk kanë manifestuar vetëm Bushatllijtë dhe Ali Pashë Tepelena, por edhe Dibranët. Hoxhollët, Karahasanët, Iljaz Pashë Dibra, por edhe elita intelektuale që më së miri përfaqësohet nga Said Najdeni e Hoxhë Muglica, nga Mehmet Pashë Deralla e Vehbi Dibra janë bashkuar me idealet e aspiratat e popullit për të fituar autonominë dhe lirinë. "... sulltanët osmanë shpresuan se do të krijonin në Shqipëri një bazë shoqërore e politike besnike ndaj sulltanit. Shumë shpejt doli që as feja e përbashkët, as interesi i përbashkët me feudalët shqiptarë, nuk mund të ishin baza të sigurta politike për një sundim të qetë të Perandorisë Osmane në Shqipëri." (K.Frashëri: "Identiteti Kombëtar Shqiptar dhe Çështje të Tjera", Tiranë 2006,f. 123) Me kalimin e kohës "sa më tepër forcohej klasa feudale shqiptare, madje sa më tepër ajo ngrihej në shkallën e aristokracisë feudale, aq më tepër zhvillohej prirja e saj për t`u lehtësuar nga varësia prej Portës së Lartë". (Frashëri, aty, f. 124)

Dikush me të drejtë mund të thotë se kur kjo pari ishte aq atdhetare, përse shqiptarët e fituan pavarësinë prej Turqisë të fundit në Ballkan, përse ata qëndruan aq gjatë nën sundimin e Turqisë? Problemi është tepër kompleks, shkaqet për këtë prapambetje janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme, por tri janë arsyet kryesore për këtë vonesë historike për pavarësi: së pari, na pëlqen apo nuk na pëlqen, duhet thënë se klasa intelektuale shqiptare, pra, paria shqiptare, pjesa e shkolluar, që kishte rëndësi të veçantë për zgjimin kombëtar, u shkëputë me vonesë nga ndikimi turk, siç u shkëputën me vonesë nga ndikimi grek dhe europerëndimorë intelektualët ortodoksë dhe katolikë ; së dyti, burrat e shteteve perëndimore, sidomos ata të Fuqive të Mëdha, kishin alergji ndaj fesë muslimane; së treti, mjaft shtete të fuqishme të asaj kohe kishin interes për ta mbajtur ende në këmbë Perandorinë Osmane në Gadishullin e Ballkanit.

Në Dibër kishte, si e cekëm më lart, edhe një **lloj tjetër parie**, që nuk kishte pasur asnjë lloj

(Vijon në faqen 9)

(Vijon nga faqja 8)

lidhjeje me Turqinë, madje kishte luftuar historikisht kundër saj. Këta ishin kapedanë popullorë, luftëtarë, që ishin dalluar në udhëheqje të kryengritjeve popullore kundër pushtuesve të ndryshëm. Nga brezi në brez këta erdhën duke u pasuruar dhe konsoliduar pozitat dhe duke fituar autoritet dhe ndikim të madh në popull, sadoqë ishin të paarsimuar, por gjithnjë afër popullit fizikisht e shpirtërisht. Populli nuk të vishej dhe nuk të afrohej po nuk pate treguesin kryesor: atdhedashurinë. Këta e kishin forcën dhe bazën në popull dhe jo tek inxheksionet e Turqisë. Në pasthënien për librin e Ismail Strazimirit "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", jepet figura e një patrioti të tillë: " Ismail Strazimiri gjen t`u vendosë përballë (parisë së degraduar-xh.) një atdhetar të formuar pa bajrak e pashallëk nën sundim, me një flamur të vetëm, flamurin e shpëtimit të Shqipërisë: Elez Isufin, që përbën figurën më të rëndësishme të gjithë librit të tij. Ai është modeli i njeriut shqiptar që ia kushton gjithçka të vetën vendit të tij dhe së fundmi i jep lamtumirën kësaj bote me një dëshpërim të thellë, që po t`i jepej mundësia t`ia niste nga e para, nuk do të bënte më aq për popullin dhe atdheun, sepse ishte e kotë. Megjithatë, Elez Isufi mbetet e vetmja dritë e panjollë në gjithë botën e ndërlikuar të karaktereve të shëmtuar të librit të Ismail Strazimirit."(Sh. Sinani: "Një Shqipëri etnografike-politike në kujtimet e Ismail Strazimirit" . Pasthënie) Në këtë lloj parie hyjnë edhe Kaloshët, se edhe ata kanë qenë kapedanë popullorë, udhëheqës të kryengritjeve popullore kundër pushtuesve të të gjitha kohërave, as ata nuk kishin çifliqe, pashallëke, asgjë. Pari e kësaj natyre janë në Dibër të gjithë krerët e maleve, pa përjashtim. Reçi, Dardha, Çidhna, Muhuri dhe Luznia bënin pjesë në Dibrën e Poshtme, kurse Gryka e Vogël, Gryka e Madhe, Bulqiza dhe Katër Grykët, në Dibrën e Madhe. Secili Mal kishte kryetarin e vetë, si: Troci e Doda në Reç, Ndreu në Dardhë; Noka, Kaloshi, Lusha e Alia në Çidhën; Hoxha në Muhur, Murrja në Luzni, Dema e Markja në Grykë të Vogël, Shehu në Grykë të Madhe, Karai në Bulqizë dhe Kaziu në Katër Grykë. (Stërmilli, aty)Krerët e Nëntë Maleve nuk ishin pjesë e parisë së krijuar nga Turqia. Ata ishin kryetarë të organizimit të hershëm, paraturk, dhe gjatë sundimit turk kanë udhëhequr popullin në kryengritje. Përgjithësisht, me ndonjë përjashtim të rrallë, këta kanë mbajtur anën e popullit.

Parisë së lashtë, rrënjëse, siç e thamë, i dha fund pushtimi osman. Dy llojët e tjera të parive morën fund me vendosjen e komunizmit në Shqipëri, i cili u përpoq dhe ia arriti t\u shkulë edhe rrënjët. Zogu nuk e cënoi parinë, madje ai ka sunduar bashkë me të, duke i lënë asaj një pushtet të kufizuar që nuk e dëmtonte pushtetin qëndror. Zogu ka meritën që nuk e prishi strukturën shoqërore të periudhës së feudalizmit, pa u krijuar, ndërkohë, një borgjezi e re, me rol drejtues në jetën e vendit. Megjithatë, paria e Shqipërisë, edhe e Dibrës, ka degjeneruar shumë kohë përpara se të zhdukej nga komunizmi. Kjo rënie e saj ka filluar që kur Shqipëria u shpall shtet i pavarur. Paria nuk e kishte më atë frymëzmin atdhetar dhe zjarrin e pashuar të frymës së Rilindjes Kombëtare. Krerët e parisë tani rendnin pas posteve dhe pasurisë, u bënë shumë intersaxhinj dhe secili donte të majmej në kurriz të shtetit dhe Shqipërisë së mjeruar. Po Shqipëria nuk ishte Perandoria Osmane pa anë e pa kufi. Shqipëria ishte e vogël dhe e varfër dhe ata duhej të hapnin rrugën me bërryla për në sofër, që nuk i merrte të gjithë. Është thënë në mënyrë të figurshme : " Shqipëria është një sofër e saposhtruar, e pasur vërtet, por edhe tepër e ngushtë, shumë kanë dëshirë të ulen e të denden pranë saj, por mjerisht ajo është shumë e vogël për t`i ngopur të gjithë të uriturit. Kështu që, për t`i bërë vend vetes, njerëzit duhet të vënë në përdorim bërrylet."

Për parinë e Dibrës, si për parinë në përgjithësi, mund të ketë mendime të ndryshme. Unë nuk jam për atë që kjo pari duhet hymnizuar dhe absolutizuar, por as të hidhet poshtë dhe të poshtërohet. Vështrimi bardhë e zi është kurdoherë i dëmshëm. Në gjykimet dhe vlerësimet tona duhet ta përjashtojmë këtë lloj gjykimi. Mua më duket i drejtë pohimi i Eqrem bej Vlorës. Ai përmend klasën e bejlerëve, të cilës i përkiste edhe vetë. Nëse me emrin bej kuptojmë parinë në përgjithësi, përfundimi ku arrin Eqrem bej Vlora na duket i drejtë: "Bejlerët në Shqipëri patën një mision, një pozitë dhe një detyrë, të cilën ata, mirë apo keq, e kryen për shekuj të tërë. Dhe kur e humbën ...populli, duke mos pasur organizim tjetër pos atij feudal, mbeti i hutuar dhe i çoroditur. Ai nuk ra në dorë të një borgjezie, qoftë edhe të papërgatitur, por përfundoi si top loje i politikanëve ekstremistë dhe ambiciozëve e shtypësve të paskrupullt".(Eqrem bej Vlora, vepër e cituar, f. 187)

Ku humbën urat e bukura të Dibrës së Madhe

Nga **Rexhep TORTE**

Sipas të dhënave historike në majën e zhvillimit dhe lulëzimit ekonomik, në bjeshkët e Krahinës së Dibrës kullotnin tre milionë kokë bagëti, që furnizonin me bylmet, kajmak, gjalp e mish edhe Selanikun e Stambollin. Asokohe për të vajtur në destinacion bylmeti ambalazhohej në tollume lëkure.

Kjo periudhë shënon edhe zhvillimin e hovshëm të zejtarisë, mes tyre ishin terzitë-rrobaqepësit, këpuctarët, opingarët, argjendarët, qëndistarët, teneqexhijtë, qeleshegjijtë, nallanaxhijtë, sheqerxhijtë, ashgjijtë, bozaxhinjtë, furtarët, tifekxhijtë, nallbanët, kasapët, gërçalët, sahatçitë, sobaxhitë, jorganxhitë, farmacistët, avokatët, arzullhallxhit, kafexhijtë etj.

Ky zhvillim bujqësor e zejtar u shoqërua edhe me zhvillimin kulturor, arkitektonik dhe rendin qytetar, që shquhej për shtëpitë, infrastrukturën dhe urat e çezmet e bukura e funksionale.

Konsujt e jashtëm që vizitonin këto vise lumturoheshin nga kultivimi i bujqësisë, blegtorisë, zejtarisë dhe urbanistikës dibrane.

Të gjitha këto bagëti dhe pasuri i plaçkitën dhe i dogjën ushtritë serbe e bullgare gjatë ofensivave të njëpasnjëshme shkatërrimtare, duke e bërë Dibrën tri herë shkrumb e hi.

Kësaj radhe do të flasim për urat dhe çezmet e bukura të këtij qyteti të lashtë e legjendar që pasqyrojnë një periudhë të bujshme historike. Pozita gjeostrategjike dhe populli heroik e liridashës dibran bënë që Dibra e Madhe të zë vend të merituar në historinë kombëtare dhe ndërkombëtare. Për këtë më së miri flet e kaluara historike me periudha të lulëzimit por edhe me periudha të lara me gjak, për këtë flasin edhe urat e bukura të Dibrës së Madhe brenda dhe përreth qytetit.

Ndër urat më në zë e më të mëdha janë Ura e Spilës e ngritur mbi vendin ku bashkoheshin lumenjtë Drini i Zi dhe Radika dhe Ura e Radikës e ngritur mbi lumin Radikë. Këto ura ishin edhe lidhja e Dibrës me botën. Pamja e bukur dhe impozante e këtyre urave, mënyra e përkryer e ndërtimit arkitektonik dhe roli komunikues lokal,krahinor e ndërkombëtar, ishin pasqyrimi më mirë i rolit të Dibrës së Madhe në rrjedhat historike, që shumë historianë me të drejtë e quanin edhe porta e Shqipërisë.

Për këto dy ura më të mëdha kanë shkruar edhe historianët Bue, Baldaçi dhe Jastrebov.

Konfiguracioni i thyer i terrenit ku është ngritur qyteti i Dibrës dhe përrenjtë e furishëm që sjellin ujin nga malet sipër qytetit, kishin kushtëzuar ndërtimin edhe të shumë urave në qytet, më të vogla për nga dimensionet ,por të bukura e funksionale, që lidhnin brenda për brenda qytetin dhe bënin më komod kalimin e njerëzve nga një lagje në lagjen tjetër.

Reliket e mbetura të këtyre urave në kujtesë,në fotografi apo edhe në vendin ku kanë qenë ndërtuar,tregojnë për rëndësinë dhe madhështinë e tyre shumëdimensionale, funksionale, kulturore e historike,të cilat edhe me fajin e dibranëve u lejuan që të shkatërrohen dhe humbin, siç thotë populli, pa nam e pa nishan.

Për të sistemuar ujin e përroit që vinte nga fshati Elevcë dhe Përroin e Vakofit, ishin ndërtuar Ura e Bejlerëve,Ura e Kuqe,Ura e Çezmës së Madhe, Ura e Selamit, Ura e Vakofit dhe Ura e Këllëçbabës.

Këto ura ishin të ndërtuara vetëm prej guri,por kishte edhe të atilla të ndërtuara prej guri,hekuri dhe druri.

Këto ura për fat të keq sot nuk ekzistojnë,përveç një pjese të Urës së Çezmës së Madhe dhe të Urës së Këllëçbabës. Kjo ka ndodhur sepse rrugët janë rrafshuar dhe mbuluar me pllaka betoni,ndërsa urat në brendi të qytetit janë prishur. Po qe se një ditë do të ndodh që papritur të aktivizohen përrenjtë,në mungesë të kanalizimeve,uji do të rrjedhë në sipërfaqe të rrugës dhe me siguri do të shkaktonte edhe dëme.

Urën e Spilës, të gjatë afër 50 metra me dy harqe-qemerë të mëdhenj në mes dhe me nga një hark-qemer shkarkues anash, që ndodhet në vendin ku bashkohen lumenjtë Drini i Zi dhe Radika, e kanë ndërtuar në shekullin e 17 mjeshtrit dibranë. Kjo urë është financuar nga dibrani Haxhi Ibrahim Hatibi. Ky dibran i pasur me që nuk ka patur fëmijë,për simbolikë të një djali financon ndërtimin e xhamisë në qendër të qytetit dhe për simbolikë të një vajze,ndërton Urën e Spilës.

Kjo urë është ndërtuar me gurë mermeri të lidhur me një masë gëlqereje shumë efektive dhe me shufra hekuri. Për këtë urë ekzistojnë shumë gojëdhëna. Thuhet se pas përfundimit të ndërtimit të kësaj ure, rastësisht ka kaluar një dhelpër skile, dhe që atëherë kjo urë është quajtur Ura e Skilës, që më pastaj shqiptohej Ura e Spilës. Për nga funksionaliteti, kjo urë ka qenë në kuadër të Via Egnatia dhe ka lidhur Dibrën e Madhe me Strugën, Ohrin, Manastirin etj.

Fotografia e kësaj ure që ka mbetur si kujtim është bërë nga Milton Manaki më 16 korrik 1909,i cili ka fotografuar konsullin austriak me makinë mbi urë, pas këthimit të tij nga Kongresi i Dibrës ku ka qenë pjesëmarrës edhe vetë.

Urën e Spilës, këtë urë me bukuri të rrallë, e shkatërroi ushtria serbe gjatë luftërave Ballkanike. Më vonë ajo u rinovua, por me pamje më të thjeshtë, derisa u hoq fare me ndërtimin e digës së Liqenit të HC Spila po në atë vend.

Ura e Radikës është ndërtuar mbi lumin Radikë aty ku përfundon te gryka e Radikës dhe ku fillonte Fusha e Udovës-hambari i Dibrës. Fillimisht është ndërtuar gjatë periudhës ilire dhe romake në shekullit e dytë të e.s., ndërsa me pamjen që shihet në fotografi, është ndërtuar në fund të shekullit 18 gjatë periudhës osmane.

Gjatësia e kësaj ure është 40 metra. Ura ka harkun-qemerin në mes të gjerë 21 metra dhe të lartë 12 metra, ndërsa dy harqet-qemeret anësorë kanë gjerësi afër 9 metra,që shërbenin gjithashtu për shkarkimin e ujërave të furrishëm së bashku me dy dritaret anësore. Ndërtimi i kësaj ure është gjithashtu është bërë prej mermeri dhe guri i lidhur me masën e gëlqeres dhe me shufra hekuri.

Kjo urë lidhte më shumë se 20 fshatra dhe Kështjellën e Skënderbeut, që ndryshe quhet kështjella e Koxhaxhikut ose Svetigradit, dhe ka shërbyer si degë e rrugës Via Egnatia.

Me rastin e akumulimit të ujit të liqenit të hidrocentralit në Dibër në vitin 1966,kjo urë u dislokua me ndihmën e arkeologëve,të cilët shënuan çdo gur me numër të caktuar sipas vendit ku ndodhej,që më pastaj siç ishin premtimet e Entit republikan për mbrojtjen e monumenteve kulturore e historike, kjo urë do të rindërtohej po mbi lumin, por e spostuar karshi fshatit Kosovrast.

Mirëpo siç ndodhi edhe me shumë monumente tjera kulturore e historike të Dibrës,edhe gurët e kësaj ure në vitin 1985 u humbën përgjithmonë nga pakujdesia e skajshme e pushtetit vendor por edhe e të gjithëve.

Nëpër Urën e Spilës dhe Urën e Radikës kanë kaluar karvanet me mallra në drejtime të ndryshme dhe shumë ushtri okupuese.

Mbi Përroin e fshatit Gajre, që është degë e lumit Radikës në rrugën për në fshatin Mogorçë ndodhet edhe Ura e Kaprollit. Lidhur me këtë urë ekziston gojëdhëna se një pasha turk gjatë gjuetisë ka plagosur një kaproll, i cili edhe pse i plagosur fluturimthi ka kapërcyer përroin dhe ka shpëtuar. I prekur nga kjo ngjarje pashai ka ndërtuar këtë urë e cila ekziston sot e kësaj dite.

Po të ekzistonin sot ato ura, me bukurinë dhe atraktivitetin që kishin, do t'ia kthenin, ruanin dhe shtonin imazhin e merituar Dibrës së Madhe.

Lufta në Qafën e Murrizit

Nga **ZABIT LLESHI**

1912-a ishte vit i realizimit të ëndrrave shekullore të shqiptarëve, i shpalljes së Pavarësisë. Ngjarje e madhe dhe e shumëpritur, gëzim i papërshkrueshëm. Festë në të gjitha vatrat shqiptare, por në Dibër nuk zgjati shumë; fatkeqësisht në të gjitha portat e saj u përplasën dallgë të reja, erdhën pushtues të rinj me synime të vjetra. Ditët e fundit të nëntorit 1912, herë pas here trupat serbe kalonin Drinin dhe organizonin plaçkitje, digjnin shtëpi, rrëmbenin blegtori dhe çdo pasuri tjetër.[1] Në gjysmën e parë të muajit dhjetor, ushtritë serbe kishin shkelur pjesën më të madhe të Shqipërisë duke arritur deri në Luginën e Shkumbinit.

Shkelësit Serb morën një varg masash dhe përdorën të gjitha mjetet në tokat e pushtuara me qëllim që tu tregonin shqiptarëve, siç vërente konsulli Italian në Durrës se "okupimi i tyre kishte karakter të përhershëm"[2]. Të shqetësuar nga pushtimet që kishte realizuar Serbia me aleatët në Shqipëri si dhe nga deklaratat që bënin sundimtarët Serb për copëtimin e saj, patriotët shqiptarë por dhe ato dibranë u dërguan qeverive të fuqive të mëdha në emër të popullit mjaft memorandume, thirrje, protesta etj në të cilat shprehej kundërshtimi ndaj agresionit Serb e klaneve antishqiptare të agresorëve të rinj. Përmes tyre kërkohej që popullit ti garantohej liria dhe tërësia territoriale. Krahas këtyre veprimtarive sensibilizuese filloi përgatitja për ta përballuar me armë agresionin. Këtij qëllimi i shërbyen kuvendet e organizuara në Zogje (Shtëpia e Pëllumb Lleshit) Vorret e Shupenzës dhe në Gjurrë të Mazhicës. Patriotët Iliaz Hoxha, Selim Dema, Zenel Hoxha (Gjuras), Isuf Leka, (në Zogje), parapërgatiten Kuvendet e Shupenzës dhe Mazhicës. U lidh besa për luftë me Grykën e Madhe, Bulqizën e Gollobordën. Në udhëheqjen e tyre qëndronin si ngahera Mersim Dema, Dan Cami, Tush Shehu, Jakup Cani, Hasan Moglica, Ramadan Kanxha, Hasan Koçi, Mehmet Duriqi etj. Përpilohet kështu plani për kryengritjen e Grykës së Vogël e cila shpërtheu më 26.12.1912.

Vija e mbrojtjes urë e Topojanit, Kodrat e Çerenecit, Ura e Spiles, Viçisht, Mali i Vrabiçit u shndërrua në një zjarr aq të fuqishëm e të shpejt sa ushtria Serbe la afro 2000 të vrarë e qindra të plagosur. Me heroizëm u mbrojt Ura e Topojanit, Ura e Spiles, por pati të vrarë e të plagosur edhe nga forcat kryengritëse. Ndër dëshmorët e parë të pavarësisë radhiten Iliaz Hoxha (Rekë), Selim Dumani (Stushaj), Avdulla Xhurxhi (Hotesh), Avdulla Ceku (Topojan), Nurçe Bodini (Okshatin), Hysen Dema, Rustem Lami (Homesh) u plagos Halit Lleshi e të tjerë. Për kryengritjen e Grykës së Vogël janë shkruar kronika e dhënë informacione, shtypi i kohës, një studim më të detajuar ka kryer Mois Murra[3].

E shohim me vend të rikujtojmë se më 6.01.1913 u hap shtegu i mbrojtjes në krahun e djathtë të Viçishtit, mbrojtur nga Dan Cami. Shtegu u hap me dredhi nga ana e forcave Serbe, sipas një marrëveshje me shtabin kryengritës, gjoja për të bërë të mundur tërheqjen e forcave armike dhe sidomos të plagosurve drejt Ohrit e më vonë drejt Manastirit. Si rezultat i kësaj pabesie trupat Serbe hyn në Thellësi të Grykës së Vogël e të Grykës së Madhe për të zënë pikat strategjike të Qafës së Buallit, Qafë Murriz, Prat, Qaf-Murr. Përballja me fshatrat Boçev, Homesh, Okshatinë, Kovashicë i gozhdoi forcat Serbe në vijën M. Homeshit, Maja e Kishës (Zogje), Qafë Stushaj. Përpara forcave kryengritëse dilnin 2 detyra:

1. Të ndalnin përparimin e forcave Serbe,

2. Të largonin fëmijët, pleqtë dhe blegtorinë në malet drejt Selishtës dhe Qaf-Murrës.

Luftëtarët e Bllacës ndonëse ishin angazhuar në ndihmë të fshatrave fqinjë me shqetësim shikonin lëvizjet e armikut për të dalë në Qafën e Murrizit nëpërmjet Malit të Homeshit dhe Lugut të Peladhisë. Ishte kjo arsyeja e mbledhjes së 50 burrave në Teqe më 4 janar në darkë, për të përcaktuar masat dhe ndërmarrë veprime konkrete për tu bërë ballë pushtuesve Serb. Një takim i tillë u organizua mbasdite vonë, më 6 janar tek qershiat e Tahir Alimanit (këtu mblidhej fshati për probleme emergjente). Thirrjeve të Hysen Tashës e Rexhep Krosit iu përgjigjën të gjithë njëzëri. Sul Balliu mori përsipër të vrojtonte lëvizjet e armikut në malin e Homeshit dhe të njoftonte fshatin. Sinjali për ardhjen e Serbëve, mëngjesi i 7 janarit i gjeti luftëtarët trima të Bllacës në pozicionet luftarake. Izet Leka do të mbërrinte i pari në llogoret e improvizuara si për të thyer edhe qetësinë e asaj dite në pyjet e dendura të mbuluara me borë, që e bënte më të vështirë ngjitjen e kodrës së Murrizit. Autokolona Serbe u shpërnda në vijë fronti në Lugun e Peladhisë drejt Qafës së Murrizit. Hysen Tasha, një luftëtarë me eksperiencë, si pjesëmarrës në disa luftra ishte në ballë të luftëtarëve pararojë së bashku me Rexhep Krosin, Rizvan Lleshi, Ismail Krosin, Izet Leka, Han Lekën, Sait Tashën, Selman Jellën etj. Në vijën e dytë të skalionit në mbështetje ishin Hasan Alla, Dule Koleci etj. Me sulmin e parë u zmbrapsën Serbët deri tek Livadhi i Brahim Mehmetit. Kjo u dha zemër malësorëve të Bllacës edhe për faktin se në ndihmë erdhën luftëtarë të rinj nga Zogjet, Selishta, Gjurasi, Stushaj e deri Hoteshi. Komandant Hyseni duke ditur se pas pushimit Serbët do të mësynin, kërkon prej shokëve të s'postohen nga e djathta duke ndalur armikun për të marrë krahët. Kjo lëvizje taktike u kuptua nga serbët të cilët menjëherë dërguan një skuadër për të penguar lëvizjen e kryengritësve nga e djathta. Ndërkohë Hyseni plagoset. Ndihma e shokëve ishte e pafuqishme për ti shpëtuar jetën dhe asnjë mundësi nuk u jepej për tu larguar nga fusha e luftimit. "Më lini mua të zbraz të gjithë fishekët sa të kem frymë dhe zbrisni me shpejtësi në Bllacë për të larguar njerëzit, për të siguruar jetën e tyre" porositi Hyseni Rexhep Krosin e Izet Lekën[4]. Pas vrasjes së Hysenit pushoi pushka e Ismailit dhe ajo e Rizvan Lleshit. Hasan Alla organizon tërheqjen e shokëve, ndërsa vet ngjitet në një ah për të goditur mbas shpine serbët. Pushka e Hasanit bëri kërdinë aq sa komandanti i operacionit, pas informacioneve që mori, me dylbi diktoi trimin e Dushajve i cili me një guxim të pashembullt shpëtoi jetën e shumë shokëve gjatë tërheqjes për në kodrën përballë malit të Homeshit. Ai dha jetën siç i ka hije një patrioti të vërtet duke shkruar një faqe të lavdishme të trimërisë shqiptare. Me gjithë humbjet e mëdha të armikut 12 trima ranë atë ditë në mbrojte të lirisë dhe pavarësisë së sapo shpallur në Vlorë 1 muaj më parë. Ata ishin Hysen Tasha, Izet Leka, Ismail Krosi, Rizvan Lleshi, Han Leka (Bllacë), Hasan Alla (Dushaj), Sali Bodini (Selisht), Hasan Kaci (Gjuras), Adem Kaja (Zogje), Dule Koleci (Stushaj). Gjaku i të rënëve do të bëhej flamur e frymëzim në betejat e ardhshme që zgjatën 9 vjet, ndërsa vetëm kryengritja e dhjetor-janari 1913 e Grykës së Vogël, 25 ditë. 7 janari ishte njëra prej ditëve më të përgjakshme. Ajo shënoi edhe një kthesë për daljen e Serbëve në vijën strategjike, pavarësisht bilanceve të humbjes në njerëz dhe në teknikë luftarake që pësoi armiku në këtë luftë të padrejtë. Dimri i ftohtë nuk e uli moralin e kryengritësve, siç kujton Aqif Lleshi, "ditë natë nuk mbeti njeri pa dalë në luftë, të gjithë në llogore"[5].

U mbushën 100 vjet nga kjo epopë plot heroizëm e Grykës së Vogël. Ashtu si gjithë Dibra edhe ajo ka lënë gjurmët e saj në historinë e Shqipërisë. Përpara nesh qëndrojnë martirët që i falën atdheut jetën për të gëzuar lirinë gjeneratat e ardhshme. Mesazhi tyre ruhet dhe transmetohen nga brezi në brez. Për ata do flasë e do shkruaj historia.

Lufta e Qafës së Murrizit dridhi fusha, kodra e male, siç thotë kënga:

Hajde, hajde o Dule Koleci
U dridh Runja e Komaveci.[6]

1 – Mois Murra, Dibra dhe Etnokulutura I, fq 259
2 – Telegram i Dolfin-it nga Durrësi 23.11.1912
3 - Mois Murra, Dibra dhe Etnokulutura I, fq 258
4 – Iliaz Xhurxhi, Kujtime për Luftën e Qafës së Murrizit
5 – Xhevdet Daci, Ushtima e Maleve 26.6.1981
6 – Hazis Alimani, Tregimtar Gojor (vjeç 80).
* Qafa e Murrizit ndan Grykën e Vogël me Grykën e Madhe dhe Bulqizën, Malin e Homezhit me atë të Bllacës e lartë 1570 m. Është një pikë dominuese dhe strategjike për Dibrën e Sipërme dhe pikë referimi për ushtritë serbe 1912-1921. Tiranë më, 20.12.2012

histori

Kontributi dhe atdhetarizmi i Ismail Stazimirit në mbështetje të shtetit shqiptar

Nga **MIMOZA SHQEFNI**, *doktorante*

Të flasësh për atdhetarë që me fuqinë e penës, të pushkës, të urtisë apo me fuqinë e fjalës, kanë bërë emër në mbrojtje të interesave të shtetit shqiptar, është gjithmonë detyrim dhe kënaqësi. Në rrjedhë të kohës, në këta 100 vjet të shtetit shqiptar, "parakalojnë" emra personalitetesh që në mënyra të ndryshme kanë kontribuar që ky shtet të arrijë të festojë 100- vjetorin e tij. Në vazhdën e kontribuesve nuk mbeten prapa as dibranët që me urtësinë e fjalës dhe oshëtimën e pushkës i dolën në mbrojtje këtij shteti.

Objekt të këtij shkrimi do të bëjmë Ismail Strazimirin, atdhetarin e madh, që ndoshta nuk bëri dhe aq emër sa disa të tjerë, por dha ndihmesën e tij në luftë për çlirimin e Shqipërisë. Strazimiri me një jetë relativisht të gjatë, e vuri atë në shërbim të çështjes kombëtare, duke u bërë një nga luftëtarët që nuk kurseu asgjë për mirëqënien e popullit shqiptar. Kjo jetë (75 vjet), i mundësoi që të ishte dëshmitar dhe pjesëmarrës në disa luftëra; në luftën kundër turqve, luftës ballkanike, kundër serbëve, gjermanëve dhe italianëve, ku në secilën prej tyre tregoi se ishte dibran për nga fuqia e krahut dhe e mendjes dhe shqiptar i denjë për nga atdhedashuria. Gjatë gjithë jetës së tij ai ishte dëshmitar okular i shumë ngjarjeve të rëndësishme që rënduan mbi kurrizin e popullit dibran, për të cilat ai nuk heshti, por duke e ditur rrezikun që i kanosej, bëri të vetmen gjë që dinte të bënte më së miri; të luftonte me forcën e fjalës dhe fuqinë e pushkës.

I edukuar në gjirin e një familjeje dibrane me ndjenja të pastra atdhedashurie, që në moshë të re ai doli në krah të mbrojtësve dhe luftëtarëve për përmbysjen e regjimit shtypës të Sulltan Hamitit, i cili kërkonte që me kushtetutën e re që shpalli, të mashtronte popujt e robëruar, veçanërisht shqiptarët. Ai shfaqi vlera dhe fuqi besnikërie në dobi të çështjes kombëtare edhe më vonë nën drejtimin e shoqërisë "Bashkimi", e cila kishte përfshirë në gjirin e saj atdhetarë të shumtë, të cilët të zhgënjyer nga premtimet e pambajtura të xhonturqve, iu kundërvunë këtyre të fundit, duke kërkuar me forcë të drejtat e tyre kombëtare. Shqetësim i madh për të ishte ruajtja e kufinjve etnikë. Duke parë allishverishet që kërkonin të bënin në kurriz të shqiptarëve, me një intuitë të pagabueshme, ai pikaste dhe demaskonte hapur tradhëtarët dhe bashkëpunëtorët, të cilët interesat e tyre personale i vendosnin mbi ato kombëtare dhe punonin haptazi apo fshehurazi kundër çështjes kombëtare. Ai i diskretiton duke ua vënë në dukje aktin e tyre të tradhëtisë.

Ndihmesa e tij ishte e madhe edhe sa i përket çështjes së ngritjes së flamurit kombëtar, qysh para shpalljes së Pavarësisë. Këtë e dëshmojnë jo vetëm dokumente të ndryshme, por edhe kujtimet e tij, të përmbledhura e të botuara, fillimisht në vitin 1931, nën titullin "Kujtime historike për lëvizjen kombëtare në qarkun e Dibrës", pastaj ribotuar në vitin 2010, nën titullin jo shumë të përshtatshëm "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë". Aty vihet re prania dhe arsyetimet e tij të urta, në thirrjet për luftë dhe për bashkimin e dibranëve. Kështu e gjejmë në fund të të marsit 1912, në lëvizjen kundër turqve dhe bashkë me atdhetarë të tjerë si: Sherif Langu, Elez Isufi, Eqerem Cami, Ismail Haki Korça etj, duke formuar çetat kryengritëse dhe duke u organizuar mes tyre, bënë të mundur që më 22 qershor, të dalin në Malësi për t'u bashkuar me kryengritësit. Vetë Ismail Strazimiri mbante në dorë flamurin e kryengritjes. Pas shumë vështirësish dhe veprimtari si të thuash "ilegale", duke sulmuar korrespondencën telegrafike, komunikacionin, djegien e postave të xhandarmërisë, për të hyrë në qendrën e Nënprefekturës së Peshkopisë. Të ndodhur para kësaj situate, prefekti i Dibrës vendosi të thërrasë një kuvend, ku u diskutuan disa lajme që botoheshin në gazetën "Jeni Asër" në Selanik, ndër të cilat: "Kabineti ra; Parlamenti u shpërnda për t'u bërë zgjedhje të reja; u pranuan kërkesat e shqiptarëve, për të cilat u dekretua amnistia" . Kaq u desh për të ndezur zjarr zemrën e Strazimirit, i cili u ngrit në këmbë dhe tha:"Ç'faj kemi ba qi të na akordohet amnistia; ne kemi kërkue të drejtat tona dhe insistojmë në këtë kërkesë; nuk kemi asnji besim në këso lepushkash; nuk kemi me u shtrue kurrë pa na u sigurue të drejtat tona kombëtare" . Edhe pse ky "revolusion" siç i thoshte ai, "mbeti pa i vu krye", oshëtima e tij u dëgjua në gjithë vendin, si për të treguar se shqiptari është gjallë dhe kërkon të drejtat e tij.

Ismail Strazimiri i përket nivelit të atyre atdhetarëve, të cilët iu përgjigjën thirrjes së atdheut në rrezik dhe nuk u stepën të vënë në shërbim të tij jetën për lirinë dhe pavarësinë, pa kërkuar asgjë në këmbim. Për një periudhë të shkurtër qe prefekt i Dibrës. Duke patur këtë pozicion strategjik, ai ishte në dijeni të veprimeve që kryheshin në kurriz të popullit. Dhe nuk heshti. Ai kundërshtonte hapur veprimtarinë antiatdhetare të Esat Toptanit, i cili kërkonte të zgjeronte dhe të forconte pushtetin e tij mbi një hapësirë më të gjerë gjeografike, apo mbi shumat që ai ofronte për të rekrutuar mercenarë në shërbim të serbëve. Mirëpo nuk gjeti mbështetjen e duhur, Kështu duke parë indiferencën e autoriteteve të kohës, në lidhje me këtë si dhe shumë çështje "të nxehta" për çështjen kombëtare, Ismail Strazimiri paraqet dorëheqjen nga detyra e nënprefektit.

Më shumë se një herë, duke parë aftësitë dhe inteligjencën e tij, autoritetet që sundonin u munduan ta bënin për vete dhe t'i ofronin ofiqe dhe paga të majme, por ai si atdhetar i madh që ishte, refuzonte gjithçka që cënonte ardhmërinë e vendit të tij. Sedra dhe shtefnia e tij ishin më të mëdha dhe nuk e lejonin të shitej për asnjë pozitë dhe asnjë lloj çmimi. "Propozimin që Esat Pasha ia bëri për t'i shërbyer atij kundrejt një shpërblimi të mirë, patrioti Strazimiri e hedh poshtë me përbuzje të thellë: - Je drejtuar gabim or pashë! Nuk jam i atij brumi që të shitem tek armiqtë e atdheut për një grusht parash të ndyra."

Që në krye të herës, ai u mundua dhe luftoi për një Shqipëri me kufinjtë e saj etnikë, për një Shqipëri të fortë, me një qeveri demokratike të drejtuar nga atdhetarë të pastër, të aftë, që ta duan me shpirt atdheun e tyre dhe t'i shërbejnë atij.

Përpjekja e tij nuk resht aspak dhe asnjëherë nuk duket se ka bërë shumë për çështjen kombëtare. Kështu ai kundërshton Arif Hiqmetin i cili përpiqej t'i mbushte mendjen popullit për të mos pranuar princ Vidin, por për të zgjedhur një osman ose një mysliman. Ai i kundërvihet Hiqmetit për prejardhjen e Vidit dhe insiston se "Shteti i ri i Shqipnis asht shqiptar e jo mysliman. Prandaj, s'asht mirë që të shkaktohen trazime e turbullime për të sjellë një princ mysliman. I takon popullit ta zgjedhë princin e vet".

Kudo ku ka ngjarje të fuqishme dhe kryengritje popullore, gjendet Ismail Strazimiri. Kështu e gjejmë në kryengritjen e vitit 1920, kundër ushtrive pushtuese serbe. Po ashtu e gjejmë në Revolucionin Demokratik të Qershorit 1924, për të vazhduar edhe në luftëra të tjera që për fat të keq nuk kanë munguar dhe e kanë tronditur Shqipërinë gjatë shekujve.

"Nëse provat e njeriut janë nyjat kritike të jetës së vendit të tij, Ismail Strazimiri pikërisht në nyjat kritike të historisë shqiptare mbajti qëndrimet më të denja. Shpallja e Pavarësisë; dy luftërat dhe dy paqet e paqëndrueshme ballkanike; njohja e premtuar e një shteti shqiptar me kufinj shumë në brendësi të hapësirës së vet historike; ardhja dhe nderi vetëikja e pagjurmë e princit trashëgimtar Ëid; shpërthimi i Luftës së Parë Botërore dhe kryqëzimi i ushtrive të të dy palëve kundërshtare në Shqipërinë pa zot; janë zhvillime që çoroditin shumë lehtë edhe sot jo vetëm soditësin e historisë, por edhe studiuesin e saj, megjithatë Ismail Strazimiri dëshmohet në gjithë këto rrjedha të turbullta atje ku i bëhej mirë atdheut të tij. Dhe kjo ndodhte vetëm në një grusht njerëzish idealistë, të cilët nuk ishin pjesë e ndonjë projekti të të huajve për të sunduar në Shqipëri përmes duarve të zgjatura të tyre; nuk kishin ndërtuar plane vetjake për të shtënë në dorë Shqipërinë apo pjesë të saj dhe për t'i kthyer në pashallëqe; e donin sinqerisht atdheun e tyre pa ndonjë interes vetjak. Ismail Strazimiri paraqitet në jetën e vendit me vetëdijen e një rilindësi."

Ismail Strazimiri

"Liria dhe drejtësia për Ismail Strazimirin ishin sinonim, kishin një kuptim dhe ishin si dy motra binjake që duhej të jetojshin, të veprojshin dhe të mbretërojshin sëbashku" - do të shkruante shkrimtari i njohur Haki Stërmilli në shtypin e kohës. Praktikisht ai kishte të drejtë, sepse ai kishte luftuar për lirinë dhe në momente kyçe të historisë kur ai kishte menduar se me të vërtetë liria do të triumfonte, do të ishte gabuar, sepse nga mungesa e drejtësisë edhe liria e humbte pushtetin e saj.

Në shërbim të Qeverisë Kombëtare të Ismail Qemalit; mbështetës i princit europian Ëidi që kundërshtarët e paraqitnin si një katundar austriak dhe të dërguar të krishterimit; njohës dhe kundërveprues i drejtpërdrejtë dhe i ballëpërballtë ndaj politikave të ringjalljes së pashallëqeve, në krahun e revolucionarëve fanolistë në vitin 1924 dhe paralajmërues i rreptë i dështimit të tij; larg qeverisjes republikane dhe mbretnore; Ismail Strazimirit, megjithatë, i kishte mbetur dhe një sfidë e fundme: pjesëmarrja në luftën antifashiste. Edhe pse tashmë në moshë të thyer, kjo gjë nuk e stepi, por etja për liri, të cilën e kishte kërkuar dhe kishte luftuar për të gjatë gjithë jetës së tij, e hodhi sërish në veprim, me të njejtin intensitet dhe trimëri që e kishte karakterizuar gjithmonë.

Ai njihet si dëshmori më i moshuar i kësaj lëvizjeje në shkallë botërore: ishte 75 vjeç kur u vra në Sllovë prej ushtrive të huaja dhe bashkëpunëtorëve të tyre.

Ai ndoqi rrugën e drejtë, rrugën e nderit, nuk u përkul asnjëherë, por njëkohësisht me karakterin dhe frymën e tij patriotike, bëri që të fitojë dashurinë, besimin dhe autoritetin në shtresat e gjera të popullit, bëri që të nderohej prej të ndershmëve dhe të urrehej prej tradhëtarëve. Gjatë gjithë jetës, ky dibran i urtë dhe i mençur, mbeti në Dibrën e tij një burrë i nderuar dhe i respektuar, gjithmonë syçelë dhe me pushkën të ngrehur apo me peshën fjalës së tij, kurdo që do ta thërriste Shqipëria. Influenca e tij në luftën për pavarësi thamë më lart, vazhdoi deri më 1943, kur dhe ai vdiq me armë në dorë, duke e mbyllur kështu në mënyrë të shkëlqyer dhe heroike.

Vijimësia për veprën patriotike të Strazimirit do të ishte e gjatë, por ne bëmë objekt të këtij shkrimi vetëm një pjesë shumë të vogël të veprimtarisë së tij patriotike në vitet e para të shtetit shqiptar, sa për të sjellë në kujtesën e brezave, një emër që meriton respekt dhe mirënjohje.

Bibliografia e shfrytëzuar:

1. Hilmi Sadikaj: "Dibra dhe etnokultura e saj", vëllimi II, Dibër 1995.
2. Haki Stërmilli. Gazeta "Bashkimi", 20 nëntor 1 945.
3. Ismail Strazimiri. "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë". Shtëpia botuese "Naimi",Tiranë 2010.
4. Mahmud Hysa: "Studime 4". Shtëpia botuese "Era", Prishtinë 2011.
5. Prof.dr. Shaban Sinani, në librin "Lufta kundër pavarësimit të Shqipërisë", të autorit Ismail Strazimiri
6. Vasfi Xheladini: Gazeta "Ushëtima e Maleve", e shtunë 22 nëntor 1980.

Ka ndodhur nje ngjarje? Keni ndonje shqetesim
per te ndare me komunitetin?
Keni ndonje propozim per zhvillimin e zones suaj?
Doni te informoni komunitetin rreth jush per dicka qe ju intereson atyre?

SHKRUANI NË GAZETË!
BASHKËPUNO EDHE TI!
< rrugaearberit@gmail.com >

Rruga e Arbërit nr. 80

reportazh

Ismail Keta, kampioni që nderoi Shqipërinë

Pamje nga finalja për titullin Kampion Bote

Ismaili dhe Gjetani

Reportazh - Ditët me kampionin në atdhe

Nga **DEFRIM METHASANI**

Lajmi që Ismail Keta u shpall për herë te dytë kampion bote, në Kik dhe Taiboks, ka gëzuar të gjithë shqiptarët, menjëherë pas 100-vjetorit të pavarësisë, pasi kampioni pas ndeshjes deklaroi për mediat gjermane, se një triumf të tillë ua dedikonte bashkëkombësve të tij në gjithë botën, si shpërblim për ditëlindjen e 100-të të kombit. Natyrisht, që jehona e një suksesi të tillë ishte e përmasave të mëdha, ndaj vendosëm që ta presim në atdhe këtë djalosh, që në çdo hap të jetës së tij si sportist, nuk harroi asnjëherë të kujtojë Shqipërinë dhe shqiptaret. Madje historia e kombit të tij, ka qenë frymëzimi për të kapur dy herë majën e botës. Ismail Keta, është i vetmi shqiptar që ka arritur një sukses të tillë në këtë sport. Edhe pse konkurron për Gjermaninë, pasi në Shqipëri nuk ka një federatë të kësaj gjinie sportive, ai mban flamurin tonë kombëtar në gjoks dhe në uniformën zyrtare sportive, duke qenë i vetmi sportist që e bën këtë gjest në një vend të huaj.

NDESHJA DHE SUKSESI I TIJ SI KAMPION BOTE

Ismail Keta, ose Xhoni Keta siç njihet në Gjermani, konkurronte mbrëmjen e 1 dhjetorit 2012, me të vetmin qëllim, të fitonte titullin kampion bote, për të nderuar shqiptarët në 100-vjetorin e lindjes së kombit të tyre. Rivali ishte ai që kish patur më 5 maj, holandezi Ramo Arns, ku aksidentalisht kish humbur titullin kampion. Tashmë Ismaili ishte mjaft i përgatitur dhe kishte një besim të patundur se ndeshja dhe fitorja do të ishte për atë dhe për gjithë shqiptarët. Dy raundet e para i ka mbyllur me epërsi në goditje dhe luftim, duke qenë në fitore 2-0. Por kënaqësia e tij, do të ishte që ndeshjen ta fitonte me nokaut. Dhe vërtet ashtu bëri. Në raundin e tretë, goditjet ishin aq të forta, saqë kundërshtari u detyrua të dorëzohej dhe Keta u shpall me meritë, për herë të dytë kampion bote. Titulli i parë, kish ardhur në një mbrëmje nëntori të vitit 2011 në Mynih, ndërkaq që tashme revanshi erdhi në fushën e kundërshtarit, në Dyseldorf. Gjerdani që vendosi në trup i shkonte shumë asaj mbrëmje, ndërsa flamurin nuk e hiqte nga gjoksi, për t'ju treguar të gjithëve që "jam shqiptar dhe ndjehem krenar për vendin tim".

DEKLARATA PAS NDESHJES, DHURATA MË E BUKUR PËR SHQIPTARËT

Menjëherë pas ndeshjes, e cila transmetohej direkt në kanalin me prestigjioz gjerman SAT 1, Keta u është lutur gazetarëve në gjuhën gjermane që të fliste shqip, sepse kishte një arsye dhe detyrim të madh. Ata kanë pranuar dhe ai është shprehur me këto fjale: "Këtë fitore ua dedikoi të gjithë shqiptarëve kudo që jetojnë në botë, me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë. Ju premtoj atyre që emrin e shqiptarit kurrë nuk do ta bëj pis, por do ti bej ata të ndjehen më krenar me fitoret e mia dhe sjelljen time dinjitoze si kampion bote. Ta gëzojnë shqiptarët këtë ditëlindje të kombit të tyre dhe të shpresojmë që shumë shpejt, të kemi një Shqipëri të bashkuar". Kjo deklarate "bombë" e Ketës, mori dhenë, sepse ishte direkt dhe na rrëqethi të gjithëve, duke fituar një admirim të jashtëzakonshëm ky sportist dhe njeri i madh...

PRITJA DHE EMOCIONET NË RINAS..!

Ka ndodhur ajo që pritej menjëherë sapo ka shkelur në tokën e tij. Flamuj, banderola, gazetarë e miq të shumtë, kishin dy ditë që prisnin në aeroport, sepse koha e keqe anulloi të gjitha fluturimet e avionëve dhe iu desh të qëndrojë në Vjenë. Por dita e nesërme, solli emocione të reja në pritjen e kampionit, që ka zbritur bashkë me vëllain e tij, Gjetan Keta, edhe ky një boksier i madh me 15 fitore në boksin profesionist. Një flamur mbi shpatullat e kampionit, hijeshonte trupin e tij vigan, që tërhoqi vëmendjen e të gjithë njerëzve që ishin në aeroport, të cilët vinin pranë tij, uronin dhe bënin foto, menjëherë sapo mësonin lajmin se ai ishte kampioni që nderoi shqiptarët në mes të Gjermanisë. Na është dashur kohë të shkëputeshim nga njerëzit dashamirës, që tashmë kishin bërë "rrethimin" e kampionit në atdheun e tij, por një "rrethim" mirënjohjeje...

Por, në mbrëmje është një surprizë tjetër e pret kampnionin në restorant "Nëna Mbretëreshë" në Tiranë. Dhjetëra miq e dashamirës të vëllezërve Keta janë mbledhur në restorantin me pronar biznesmenin e suksesshwm, djalin e Dibrës, z. Rakip Suli, dhe festojnë deri natën vonë. Të nesërmen surpriza të tjera na presin.

Në Rinas

MBRËMJA GALA: "FESTOJMË ME KAMPIONIN"...!

Kështu ishte titulluar ajo mbrëmje e madhe e 13 dhjetorit, në sallën më të rëndësishme në hotel "Tirana Internacional", në prani të qindra miqve dhe të ftuarve special. Hyrja në sallë e vëllezërve kampionë, Ismail dhe Gjetan Keta, është pritur me ovacione dhe duartrokitje të pafund... Me tej, dekorimi "Qytetar Nderi" nga Bashkia e Bulqizës, qyteti i kampionit të botes, që ndjehet me krenar se kurrë në historinë e tij. Kryetari i bashkisë Roland Keta deklaroi se kishte nderin dhe privilegjin, te lauronte me këtë titull, një njeri dhe sportist kampion, si Ismail Keta, qytetari që i bën nder Bulqizës dhe Shqipërisë me arritjet dhe sukseset e tij të jashtëzakonshme. Kjo ceremoni shënoi një tjetër kulm në karrierën e kampionit, pas shume trofeve dhe vlerësimeve që ka marrë këto vite. Më pas, personalitete të jetës në vend, si akademik Gudar Beqiraj, prefekti i qarkut Dibër, Genci Sharku, deputeti Jemin Gjana, drejtori i programeve në RTSH Bajram Hoxha, përfaqësuesi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Z. Uvil Zajmi dhe mjaft të tjerë kanë uruar dhe përshëndetur një kampioni të tille që nga dita në ditë, shton vlerat e kombit të tij në arenën ndërkombëtare. Një kryevepër, ishte dhurata që iu bë kampionit nga Kosova, duke sjellë prej andej simbolet e shtetit më të ri, ku flitet shqip dhe ku fitorja e Ismail Ketës, kishte bërë shumë jehonë. Ndërkaq, artistët e mirënjohur Qerim Sula, Francesk Radi, Dritan Jashari dhe Dilan Reka, ngritën peshë sallën me këngët e tyre, ndërsa ansambli "Shqiponja", bëri një tjetër dhuratë për kampionët, vallen "Festë të madhe ka sot Shqipëria", si mirnjohje për suksesin e njeriut fitues.

Në këtë shkrim, s'mund të lë pa përmendur edhe xhestin fisnik të pronarit të hotel "Tirana International" zotit Ramë Geci, që

sport

mundësoi dhënien e sallës dhe shtroi një darkë për kampionin Ismail Keta, duke vlerësuar rolin e një shqiptari që çuditi botën dhe nderoi kombin.

KAMPIONI NGROHU ZEMRAT DHE SFIDOI DIMRIN NË BULQIZË...

Vajtja në Bulqizë, ishte një detyrim moral, për një djalë që ishte lindur aty dhe kishte jetuar deri në moshën 16 vjeçare. Dikur ai bënte atë që bënim shumica e bulqizakëve, merrej me minierën, por që më shumë shfrytëzonte hekurat, duke përgatitur një trup të fortë, se sa punën me kromin për të fituar para. Pas kaq vitesh, tashmë kur është 36 vjeç, kthehet si kampion bote dhe kërkon të ndajë këtë sukses dhe gëzim me shtëpinë e tij të madhe në Bulqizë. Një emision maratonë në TV Bulqiza, ka bërë që askush të mos ishte në rrugë atë natë dimri, më shumë se nga të ftohtit e acartë, nga dëshira për të parë në ekran, djalin e tyre kampion. Unë në studio kam kaluar mbrëmjen më të gjatë dhe më të bukur televizive. Dhjetëra e qindra telefonata vinin pa pushim, nga fshatrat, qyteti dhe jashtë vendit. Mesazhe e urime të shumta, lot në sytë e tyre e dikujt i mekej edhe fjala prej gëzimit... Vërtet emocione të pafund. Në këtë program special, u fol edhe për Ferit Ketën, djalin e xhaxhait të Ismailit, që stërvitet prej tij dhe ka arritur disa fitore në Kik dhe Taiboks në Gjermani. Gjatë këtij emisioni, unë improvizova edhe një konkurs për komentin më të bukur në studio. Dhe fituesja ishte një vajzë 14-vjeçare nga Fushë- Bulqiza, që quhej Elsa e cila deklaroi: "Unë jam vajza më e lumtur në botë, që tashmë zgjohem çdo ditë, me krenarinë që jam nga fshati i kampionit të botës dhe kjo me bën të fluturoj prej gëzimit e me duket ndonjëherë që kam kapur qiellin me dorë...". Në mbyllje një gjest i kampionit, që sjell në studio direkt, gjithë stafin, që nga presidenti i këtij televizioni Edmond Isaku, që ka qenë gjithnjë dashamirës në promovimin e vlerave e deri te gazetarët, Hysen Likdisha, Defrim Karaj e inxhinieri Myrto, që bënë edhe foto e morën dhurata prej kampionit, me foton e tij të dedikuar dhe bluzat me emrat dhe fjalët e tyre. Kur dolëm jashtë atë mbrëmje të ftohte dimri, dhjetëra e qindra njerëz ishin mbledhur në qendër të qytetit, për të pritur e uruar kampionin, sepse shumë prej tyre skishin patur mundësi tia bënin direkt në studio... Lotët e Ismailit i kam edhe tani para syve, sepse përjetoi një mbrëmje të jashtëzakonshme dhe mori një mal me respekt prej bashkëqytetarëve të tij në Bulqizë. E tillë e bukur dhe emocionuese mbrëmja vazhdoi edhe në shtëpinë e tij në Koçaj, ku prindërit Asllan dhe Fiqirie, shpalosën vlerat e një mikpritje tipike, duke pritur miqtë nga Tirana, Bulqiza dhe qytete të tjera, që shoqëronin kampionin në vendlindje.

E njëjtë ishte edhe e nesërmja, ku për të dalë prej qytetit, na është dashur shumë kohe, nga dëshira e njerëzve për ta takuar e për ti thënë një fjalë zemre...

Duke marrë titullin "Qytetar Nderi" i Bulqizës nga kryetari Roland Keta

Me kryetarin e Bashkisë së Tiranës, z. Lulzim Basha dhe Prefektin e Dibrës, Genci Sharku

"ISMAIL, NA KE BËRË SHUMË KRENARE, SI DIBRANË DHE SI SHQIPTARË"!

Pritja dhe ngrohtësia në zyrën e kryetarit të bashkisë së kryeqytetit, Lulëzim Basha, ishte një tjetër vlerësim që ju bë vëllezërve kampionë. Biseda ishte tejet miqësore, madje nuk munguan edhe lotët, tek flitej për një djalë Dibre dhe djalë Shqipërie, që arrinte maja të tilla me forcën dhe aftësitë e tij. "Por mbi të gjitha të qenit dibran dhe shqiptar, tha Basha, na bën të ndjehemi më krenar me njerëz të suksesshëm dhe dinjitoz si vëllezërit Ismail dhe Gjetan Keta". Me pas, ai u interesua edhe për shkollën që kanë hapur vëllezërit Keta në Tiranë, duke përgatitur djem dhe vajza jo vetëm të aftë fizikisht, por edhe mendërisht, si një shërbim për komunitetin dhe cilësinë njerëzore të brezit te ri. Fotot e shumta me Bashën, të cilat u publikuan edhe në web dhe media, bënë shumë jehonë dhe i dhanë një tjetër impuls vëllezërve Keta, për të vazhduar një rrugë të tillë të guximshme.

LIDHJA E INTELEKTUALËVE DIBRANË, VLERËSIM DHE RESPEKT PËR KAMPIONIN

Një tjetër ditë historike dhe për të mbetur në kujtesë, ishte ajo që mundësoi takimin e kampionit të botës, me kryesinë e Lidhjes së Intelektualëve Dibranë në hotel "Tirana Internacional". Kryetari i saj, Prof. Dr. Nuri Abdiu, e konsideroi një nder të madh për intelektualët dibranë, që një bir Dibre shënon emrin në librin e artë si kampion bote për herë të dytë. Me aprovimin e gjithë anëtarëve të kryesisë ai e ka shpallur anëtar nderi të kësaj shoqatë, dhe i ka dhënë mirënjohjen në emër të LID, për promovimin e vlerave kombëtare që Ismail Keta ka bërë jashtë Shqipërisë, si kampion i merituar bote. Një tjetër dhurate ishte edhe libri "Historia e Dibrës" me autor historianin Kristo Frashëri, dhuratë që kampioni e priti me shumë emocion. Ai tha në këtë takim se "një respekt dhe vlerësim i tillë është një shtysë, një motiv i madh për të vazhduar sërish në këtë rrugë të vështirë por edhe të bukur, si kampion bote gjithnjë në emër të shqiptarëve dhe dibranëve. Fjalët e protagonistëve të tjerë në këtë takim, si Shpëtim Cami, Demir Osmani, Hasan Çipurri, Musa Rriçku, Hamdie Biqiri, Hajri Shehu, Zabit Lleshi, Islam Uka, Shaqir Skarra, Hysen Uka, Dritan Jashari, Bujar Karoshi, e bënë më interesante bisedën me kampionin, që nuk harroi të premtonte se do t'ju zbardhë faqen dhe asnjëherë emrin e dibranit dhe shqiptarit nuk do ta njollosë.

IMAZH DHE MEDIA: "KETA, NJERIU I VITIT NË SPORT"!

Në Teatrin e Operas dhe Baletit, është zhvilluar festivali i dhjetë i forumit "Imazh dhe media", ku janë dhënë çmimet e vitit në këtë edicion jubilar. Në sport, çmimi i vitit, shkoi për Ismail Ketën, kampionin e botës, që tregoi vlera të pashembullta në arenën ndërkombëtare, si një ambasador i vërtetë në Gjermani dhe në botë. Në skenën e kësaj salle prestigjioze, kampioni ka folur shkurt dhe thjeshtë, duke bërë premtimin që do ta vazhdonte rrugën e sportit, tashme jo thjesht si një dëshirë, apo pasion, por si një detyrim për të respektuar të gjithë shqiptarët për vlerësimin që i bënë. Duartrokitjet kanë qenë të shumta për djaloshin kampion, që mori një tjetër vlerësim të merituar post këtij suksesi në atdheun e tij.

DINASTIA KETA VAZHDON ME "TRE MUSKETIERËT" NË SPORT

Ishin dy, por tashme prej një viti janë bërë tre. Bashkë me Ismailin dhe Gjetanin, në Mynih ka vajtur prej më shumë se një viti edhe Ferit Keta, kushëriri i vëllezërve kampion, që ka bërë një prezantim të shkëlqyer. Ai ka fituar disa ndeshje dhe është bërë kandidat për tu shpallur kampion Gjermanie në Kik dhe Taiboks. Feriti është një sportist model, që ka marrë cilësitë më të mira prej vëllezërve Keta, Ismailit dhe Gjetanit dhe shihet si një shpresë në këtë sport. Pra, tashmë në vitin 2013, ne presim shumë dhurata dhe kënaqësi nga tre "musketierët" në sport, tre shqiptarët, që nuk kanë vetëm një mbiemër të njëjtë, por kanë zemrën dhe shpirtin e shqiptarit të vërtetë që e nxjerrin në ring, si fitues dinjitozë dhe si shqiptarë të suksesshëm...

"Mirënjohje" nga Lidhja e Intelektualëve Dibranë

Me disa nga anëtarët e kryesisë së shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë"

"Krahët e Shpendit" nga gjimnazistët e Maqellarës

Nga **ZAMIRA GJELESHI**, *Gjimnazi Maqellarë*

"28 Nëntor 1912- projekti i Shqipërisë moderne dhe shtetit shqiptar.

Katër burra vështirë të imagjinonin përmasat e projektit që po i jepnin jetë. Ata po shtynin tej një përpjekje të nisur vite më parë, në të cilën qenë angazhuar qindra e mijëra vetë; një përpjekje për të krijuar një shtet të shqiptarëve, që atë ditë nëntori ishte më afër se kurrë. As vetë Ismail Qemali nuk mund të parashikonte atë që do të ndodhte më pas."

Historia ka tekat dhe personazhet e saj, ngjarje apo vende bluhen shpesh pamëshirshëm në ingranazhet që ajo krijon.

Ideja për t'u bërë pjesë e këtij 100 Vjetori nëpërmjet një aktiviteti të madh m'u fiksua keq né mendje.

Misioni ynë ishte misioni, që i vumë vetes.

Kështu nisa udhëtimin tim né gjurmët e tim ati, që ëndrra e tij për Shqipëri etnike më 1944 u kthye né zhgjëndërr dhe s'i mbeti gjë tjetër vetëm të na mëkojë me dashurinë për trojet etnike iliro –shqiptare.

Me "Krahët e Shpendit" nisëm fluturimin në të gjitha trojet shqiptare për t'i bashkuar ato me trungun mëmë në këtë 100 Vjetor si dhe përcollëm mesashin e Nënës Iliri rrugëtuar prej shekujsh nga thellësia e viteve :

"Të më duash Ilirinë bir, të më duash gjuhën, zakonet, flamurin…!"

Udhëtuam në të gjitha trevat shqiptare dhe gjithkund morëm një trëndafil duke qëndruar mes këtyre trëndafilave si maratonomaku i Nolit mes najadash e triadash.

Erërat e mallit të mërgimtarëve dibranë sollën shiun e mëshirës për të na shuar etjen, por shiu kish marrë me vete gjakun e Shpendit (Skerdilajd Llagamit) , ndaj etja sa u shua aq dhe u shtua.

Misionarët e Gjimnazit të Maqellarës m'i ngjanin flamurit dhe shqiponja e flamurit ishte Shpendi, m'i ngjanin shqiponjës dhe sqepi i shqiponjës ishte Shpendi.

HISTORIA PËRSËRITET…

Gjurmët e Shpendit ishin shpërndarë në të gjitha trojet shqiptare, kështu që të gjitha trojet shqiptare ishin bërë gjurmë e tij.

Me fjalët e mia kurrë nuk pata mundësi të zbukuroj emrin e tij, por me emrin e tij zbukurova fjalët e mia.

Gjithashtu gjeta gjurmët e ish nxënësve të gjimnazit më 1999: Adil Maloku / Pejë dhe Ylber Berisha / Prizren , prindërit e të cilëve u flijuan për Liri. Ata përfaqësojnë denjësisht gjimnazin në institucionet ku punojnë.

Nuk gjej fjalët e duhura, por nëpërmjet blicit të aparatit dhe kameras munda të shfaq para nxënësve të mi ekspozitën dhe dokumentarin "Krahët e Shpendit."

Pikërisht ata nxënësit e vegjël, të një gjimnazi të vogël diskutuan me komandantë të UÇK-sé si me njerëzit e tyre, rrëmbejnë Çmimin e Pavarësisë në MASH dhe ishin atje me Sokolat e Dibrës e Ballistët e Tetovës, ku ëndrra shqiptare merr jetë.

Ruzhdi Saramati / Prizren:"…Skerdilajd Llagami nga Tirana ishte vetë Shpendi, vetë shqiponja, shqipe që lufton për trojet, folenë dhe të vegjlit.

Thirrja e tij: Pas meje djema!

Thënë troç: Hero i të 3 luftrave të UÇK, Shpend i pazëvendësueshëm, luftëtar i pazëvendësueshëm, trim i pazëvendësueshëm, kombëtarisht i pazëvendësueshëm, shqiptar i madh i kohërave. Komandant Shpendi është shumë i rrallë, nuk mund të barazohet me kombin, përndryshe është më i madh…"

Junuz Musliu / Bujanoc:"… Ndihem i privilegjuar me mbështetjen tuaj dhe në ditët e luftës ashtu dhe në këtë 100 Vjetor të mëvetësisë së Shqypnisë pa viset shqiptare. Mbetemi me shpresë se amaneti i dëshmorëve të kombit dhe Skerdilajd Llagamit do të bëhet realitet Shqypni etnike. Ju përqafoj nga Bujanoci…"

Safet Ramadani (Mësuesi) / Tetovë :"..Në këto troje të UÇK, Shpendi ka qenë prijësi, udhëheqësi, kalorësi, ideologu,strategu…Misioni i tij u nis në Kosovë vazhdoi në Bujanoc, Metvegj, e Preshevë dhe mbaroi në Tetovë. Jemi krenar qé e kemi atë "Dëshmor të Kombit". Të gjithë jemi të lidhur për të dhe kryeqytet është Tirana , ashtu siç thoshte dhe Shpendi. Ne jemi djemtë e profesor Bardhylit, pasi djalin e tij e kemi mes nesh. Njerëzit e mëdhenj bëjnë punë të mëdha!"

Jetmir Osmani / Tetovë :"…Ai ishte legjendë dhe do të mbetet i tillë në zemrën time. Me lot e shoqëroj dhimbjen për luftëtarin e 3 luftrave të UÇK, Skerdilajd Llagami. Ai ra dëshmor, por shpirti i tij fluturon në hapësirat shqiptare…"

Bardhyl Llagami / Tiranë :"… U jam mirënjohës për prushin që më përcollët dhe për përkushtimin prekës, për birin e thjeshtë të Shqipërisë, Komandant Shpendin… Përgëzime Gjimnazit Maqellarë për gravitacionin me emrin Zamira !"

Blerim Lazimi DAR/Dibër:" Është ndër aktivitetet më të mira, që kam parë deri tani. Uroj Gjimnazin e Maqellarës që çfarë bëjnë ta çojnë më tej duke dhënë shembullin e një zone që buron qytetërim."

Valentina Murrja World Vision : " Të gjitha këto kanë një emër Gjimnazi Maqellarë. Me to ia vlen të jesh në ekip..."

Klevis Topi FASH: "Unë e kisha me të dëgjuar, por tani jam mes dibranëve dhe shoh se këto vlera rriten dhe promovohen mes jush."

Skënder Zeneli Tiranë: "Shpresoj të jemi brezi që bashkon kombin...."

Vaid Dedja Dibër e Madhe:"Jam tejet i emocionuar sa lotët po më tradhtojnë, sepse ndodhem mes vëllezërve dhe motrave të mi në këtë 100 Vjetor. Ndihem krenarë për këta të rinj, që janë vazhdues të denjë të brezave, që unë njoh..."

Elez Cibaku Kastriot: "...Në këtë zonë u ndërtua fidanishtja e parë e frutikulturës në vend, sot pasardhësit e tyre po edukojnë një fidanishte brezash. Personalisht dëshiroj siç themi Medina e ndritur në Arabinë Saudite , të themi Maqellara e ndritur në Dibër..."

Bujar Spahiu: "Më vjen mirë, që veç punës gjen kohë për t'i dhënë emër Maqellarës."

Sul Xhepa Shupenzë: " Kjo është një ndër eksperiencat më të bukura që duhet ta përcjell në komunën e Shupenzës."

Nazmi Gjeleshi Shupenzë : " U lumtë për mesazhin patriotik që përcollët. Mendja e një kombi është arsim, zemra e tij morali i përgjithshëm."

Osman Xhili."Më vjen mirë, që libri Krahët e Shpendit u përcoll dhe kjo është një punë heroike dhe titanike".

Genc Miftari gjimnazist / Tiranë:" Në gjimnazin ku unë mësoj aktivitetet për 100 Vjetorin janë zhvilluar në ambiente të mbyllura me numër të kufizuar pjesëmarrësish. Ndihem i befasuar nga mirëorganizimi, gjithëpërfshirja e nxënësve, komunitetit si dhe kohështrirja e aktivitetit. Ia ka vlejt që lash Tiranën për një ditë të tillë dhe më bën të ndihem krenar."

Erona Spahiu World Vision :"Erdha nga universiteti me mendimin se do të largohem shumë shpejt nga Maqellara, por tani falë familjes dhe Gjimnazit Maqellarë jam më e sigurt se kurrë se vendi im është këtu. E dua vendlindjen time, Maqellarë!"

Ivzi Muça drejtor i Gjimnazit : "Të jesh njeri nuk do të thotë shumë, sepse je thjesht pronë e dikujt, por të kuptosh kuptimin e jetës dhe të mbrosh jetën me jetë është testi, që provon se je i vlefshëm dhe se mund t'ia dalësh!"

Esmeralda Beça UAMD :" Mos u ngjitni në malin e përgjakur të zemrës time,

nëse nuk e kuptoni pse zemra është më e fortë sesa dhimbja!

Mos më jepni ilaç për plagët e trupit!

Mua, mua më dhemb shpirti!

Për ndarjen nuk ka ilaç e ferman, veç bashkimit, bashkimit të trojeve etnike iliro-shqiptare!

Unë e di, se nuk mund të bashkohem me ty, por as s'mund të ndahem prej teje, o Nënë!

Lotët nuk sjellin dhimbje, por dhimbja sjell lot!

Mos thoni:

O Nënë, unë kam një dhimbje!

Por thoni:

O dhimbje, unë kam një Nënë;

O Nënë , unë kam një Flamur!!!!!!"

Gjithmonë më ka shoqëruar pyetja: Cili është roli im?

E përgjatë rrugëtimit përgjigja m'u kthye përsëri në pyetje. Me dorë në zemër kam pyetur veten:

Kam bërë si duhet detyrën ndaj atdheut?

U jam mirënjohëse: Albion Xh, Esmeralda B, Manuela I, Muntaz N, Jasmin M si ambasadorë të Gjimnazit , Lorenc L, Merjem M, Genci M,që më kanë ndjekur hap pas hapi duke më mbështetur në rrugëtimin tim, Foto- studio "Ardit" dhe Video- montazh "Arbi" për fotot dhe montazhin fantastik, Arsen T dhe Mentor D për udhëtimin në trojet shqiptare … , sepse falë tyre arrita t'ia dalë mbanë.

Koncerti i madh festiv nga "Sokolat e Dibrës" i 22 Nëntorit, aktiviteti i 26 Nëntorit te Gjimnazi, rrëmbimi i Çmimi i Pavarësisë nga misionari i gjimnazit Muntaz Nasufi me esenë "Krahët e Shpendit" në MASH si dhe koncerti festiv i natës së 28 Nëntorit para popullit të Maqellarës, duke i dhënë asaj atmosferën festive për të gjithë ata, që zgjodhën Maqellarën duke u ndjerë krenar, nën dritën e fishekzjarreve uruam : "Ma gëzofsh Pavarësinë, moj Shqipëria ime!"

Të gjitha këto u dhanë përgjigje pyetjeve të mia:

Sado që të bëj gjithmonë do të them , kam bërë pak për Komandant Shpendin dhe për Maqellarën!

Shpresoj të kem përhapur sadopak jehonën e tyre në këtë 100 Vjetor!

28 Nëntor 2012 - 100 Vjetori i Pavarësisë

Sot të gjithë përkujtojmë me krenari dhe respekt të thellë të rënët për trojet etnike iliro-shqiptare pavarësisht mërive, luftës , që bëmë ndaj njëri – tjetrit dhe iu drejtuam Evropës me një togfjalësh:

Shqipëri etnike né BE, ku do të takohemi si shqiptarë të ardhur nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Serbia, Greqia e Mali i Zi…

Sot ,po, po, sot flamuri shqiptar me "Krahët e Shpendit" fluturojnë né hapësirat shqiptare drejt Universit…

Krahët e Shpendit

Nga **MENTAS NASUFI**, ***Klasa 10a***, *Gjimnazi Maqellarë*

O Shpend!

Nuk kam krahë, por krahët e tua i dua.

Dua të nis udhëtimin e zemrës dhe emri yt të jetë udhërrëfyesi im né këtë 100 Vjetor.

Né sa copa duhet të ndahet trungu mëmë , për t'i thënë fjalët e pathëna?

Zemra më thotë se tani është coptuar né kushedi sa copa…

E për t'i thënë të pathënat duhet që të gjithë copat të ngjiten e të bëhen një…

Si mund t'i bashkoj copat e trungut mëmë të shkëputura gjatë shekujve?

Shqipëria nuk mundi të të mbaj ty, por ty u shndrrove né Shpend Shqipërie, që fluturon né të gjitha viset arbërore dhe nga gjaku i plagëve të tua u ushqyen lulëkuqet e Kosovës, Bujanocit,Preshevës, Metvegjës e Tetovës…

Thonë të jetosh për vete digjesh pa flakë, për familjen ndrin, ndërsa për kombin shkëlqen…

O kandil ndriçues!

Ndizu dhe më fal dritë të gjej të gjithë copat e humbura né thellësi të shekujve…

Kandili yt nuk ndizet, sepse nuk shuhet asnjëherë…

Drita jote paska qenë gjithmonë pranë syve tanë, por sytë i paskemi patur të mbyllur...

Tani që hapa sytë veten e gjej né burgun e hapur…

E kuptoj se jam gjallë, por nuk jetoj;

kam, por jam i varfër;

nuk jam lyps, por vazhdoj të kërkoj…

Gjurmët që ke lënë né trevat shqiptare era i shpërndau né të gjashtë anët e botës.

Kështu e gjithë bota u bë gjurmë e jotja…

Me fjalët e mia kurrë nuk pata fuqi të zbukuroj emrin tënd, por me emrin tënd zbukurova fjalët e mia…

Të gjithë kur duan t'i shmangen rrezikut shtëpive të tyre u vënë dryna, por për ty çdo shtëpi e Kosovës, Bujanocit, Preshevës, Metvegjës e Tetovës u bë më e sigurt se të gjithë dyert e drynat.

Nga vjen? – pyeti një nënë tetovare

Ti i the: Jam biri yt nënë.

Kështu nuk ruajte fshehtësinë e emrit tënd, po the të vërtetën.

Ti ishe Shpendi i të gjithë nënave.

Ti përforcove filozofinë e flijimit për Lirinë,kësaj filozofie të vjetër sa dhe njerëzimi se:

Liria bëhet vetëm me gjakun e djemve të nënave, qoftë edhe me gjakun e djemve të vetëm të nënave, ashtu siç ishe ti, Skerdilajd Llagami- Shpendi.

Të gjithë jemi shqiptarë, por sot na ka marrë malli për ty.

Sot né këtë 100 Vjetor me Krahët e Shpendit nisëm t'i bashkojmë copat me trungun nënë, por zemra e mallëngjyer e Atit të Shpendit gjithmonë kishte arritur atje përpara nesh.

Nuk kemi lënë vend, fshat, luginë, pyll, mal e shteg pa shkelur, kudo ku ke luftuar o Shpend. Nuk kemi lënë qytet e fshat të Shqipërisë, Kosovës, Bujanocit, Preshevës e Maqedonisë për të dhuruar librin "Krahët e Shpendit" sa të thjeshtë aq monumental shkruar me lot prindi e krenari atdhetari. Si gjithmonë Ati i Shpendit kish qenë atje para nesh.

Dallgët po e përplasin gjithë jetën me gjithë fisnikërinë e hedhur mbi supe, sepse don të puthë gjurmët e tua .

Ai nuk ecën,por fluturon si të jetë vetë Shpendi…

Nga buron gjithë kjo fuqi?

E gjithë ekzistenca e tij është mallëngjyer për ty!

Ti e mban gjallë atë apo ai të mban gjallë ty?...

Paaftësia për të perceptuar quhet perceptim. Çdo perceptim është përpjekje për të arritur një të vërtetë.

Por çfarë të perceptosh kur je me të vërtetën.

Çdo gjë e shohim përmes dritës që lëshon ti ….

O shpend krenar!

Pyetjet janë si etja dhe përgjigjet janë si uji…

Qielli i përgjigjet Tokës dhe Toka gjithmonë u dorëzohet përgjigjeve që vijnë prej qiellit.

O Shpend ti je lajmësi që vjen prej qiellit dhe ruajtësi i trojeve etnike iliro-shqiptare...

Si mund të vdesin zemrat tona né Tokë nga etja duke mos pranuar përgjigjet që shëmbëllehen me shiun e mëshirës , që Zoti zbret prej qielli duke larë tokën e përgjakur?

O Shpendi i gjithë shqiptarëve!

Ti vetëm një gabim bëre, tek u flisje shokëve syri lëshoi më shumë rreze drite se sa duhej. Ajo ra dhe iu shfaq armikut si gjurmë dhe të goditën mizorisht.

O kandil ndriçues!

Sot ajo dritë është e jotja sepse askush nuk mund ta vrasë dritën!

Ajo është drita e Komandant Shpendit, që ndrit në konstelacionet e yjeve. Ndriçon ditë e natë me shkëlqim vezullues.

Ndrit dhe nuk shuhet kurrë, sepse na vjen nga gjithësia!

Kemi gjetur fluturimin e duhur:

"Me heronjtë nuk na ofron vdekja, por jeta e tyre. Ata jetojnë né jetën tonë dhe vdesin me vdekjen tonë!"

Të gjithë përulen para veprës sé pavdekshme të Skerdilajd Llagamit (Komandant Shpendit) .

Ne ca më shumë!...

Udhëtimi i misionarëve të Gjimnazit Maqellarë "Krahët e Shpendit" qe një pelegrinazh që përfundoi Ditën e Bjeshkatarëve të Ballkanit nè majèn e Korabit, atje ku toka iliro-shqiptare prek qiellin dhe me dorë né zemër pyetëm veten:

"Kemi bërë si duhet detyrën ndaj atdheut né këtë 100 Vjetor të Pavarësisë?"

histori

Elez Isufi - fuqi, besë, shpëtim dhe shpresë për kombin



Nga **NAIM PLAKU**

Në analet e historisë sonë kombëtare, nga kohërat më të lashta e gjer tek më të rejat, Dibra ka qenë kurdoherë e pranishme dhe ka pasur peshë të rëndësishme, shpesh dhe përcaktuese, në lëvizjet tona kombëtare për liri dhe pavarësi, duke u dhënë këtyre pasazheve dhe peisazheve pikante ngjyrën e gjakut të kulluar të lirisë. Pozicioni i saj gjeofizik, një luginë e bukur e pjellore plot dritë e gjelbërim në rrjedhën e mesme të Drinit të Zi, me ujëra të kulluar e pyje madhështorë, përtej dallgëve të kripura të detit, kënetave dhe moçaleve, të verdha e të mpira, e mbrojtur nga një kurorë malesh të lartë në perendim e në lindje, tërhoqi lakmitë e pushtuesve duke filluar nga falangat e ushtrive romake e gjer te urditë shoviniste sërbe. Prandaj themi me të drejtë se Dibra ka histori. Kjo histori ka brenda saj ngjarje, perpjekje, luftëra, qëndresë madhore, ka tym të zi e gjak të pastër, besë të rëndë dhe hakmarrje vigane, ka luftëtarë e martirë, dëshmorë e heronj të vërtetë, prijësa të shquar e trima mejdani, ka varre lapidarë dhe këngë frymëzuese…

Ngjarjet që ndodhën në gjysmën e dytë të shek XIX dhe fillimin e shek.XX që shënojnë dhe fundin e sundimit otoman dhe kurorëzohen me shpalljen e Pavarësisë e bëjnë Dibrën epiqendër të përpjekjeve shqiptare për liri e pavarësi. Mjerë kush s'e njeh dhe s'e do! Le të kujtojmë qëndresën vigane kundër reformave të Tanzimatit, kontributin dibran në Lidhjen e Prizrenit, përpjekjet për gjuhën dhe shkollën shqipe, kryengritjet antiosmane për shpalljen e Pavarësisë, kuvendet, kararet dhe itifaket, besëlidhjet e famshme, prologun e gjithë atyre betejave legjendare, nga dolën heronjtë pishtarë të qëndresës popullore. Kurora e lavdisë dibrane është, padyshim, epopeja e luftrave 9-vjeçare kundër pushtuesve sërbë 1912-1921, përcaktuese në kufinjtë që kemi sot, e dhimbshme gjer në palcë, por madhështore gjer në pavdekësi, të cilën gishta të shkapërderdhur historianësh ose e kanë prekur pak, ose e kanë shkruar keq. Mjerë ata që luajnë me të vërtetën!

Sado të keqinerpretohen apo të keqpërdoren, memoria e shëndoshë e kombit kurrë nuk do të fshijë emrat e mëdhenj të patriotëve tanë. Ata janë si lulet që mbijë e lulëzojnë, sa herë fryjnë erëra të ngrohta behari. Të tillë janë Cen Leka e Salë Markja, Sheh Zerqani e Fejzë Bulqiza, Dan Cami e Iljaz Dibra, Selman Alia e Llan Kaloshi, Selim Rusi e Jusuf Bageri, Sefedin Pustina e Ismail Strazimiri, Baftjar Doda e Mustafë Lita, Hoxhë Voka e Hoxhë Muglica, Elez Isufi e Sufë Xhelili e plot të tjerë.

Elez Isufi hyri si meteor plot dritë e shkëlqim në orbitën e përpjekjeve shqiptare për liri dhe pavarësi, kur ishte djalë i ri 17 vjeç. Familja e tij kishte pak kohë që ishte vendosur në një mjedis interesant. Një shtëpi e thjeshtë majë një kodre mes gjelbërimit dushkor të Lugjepravës, në të djathtë të Drinit, që shpejt do të kthehej në një copëz parajse me bimë e pemë gjithfarësh dhe me një kullë-fortesë majë kodrës. Djali i ri, i pajisur nga natyra me dhunti të jashtëzakonshme, i rrahur që fëmijë nga erërat e luftës dhe barotit, i pjekur në kuvende burrash, i rritur dhe i kalitur në mejdane trimërie, nën kujdesin e një nëne malësore të mençur dhe bujare, të ashpër e kryelartë, por dhe të dashur e fisnike, ziente përbrenda si një vullkan që priste për të shpalosur mrekullitë e shpirtit shpërthyes e liridashës, të një mendjeje të ndritur e të një pasioni të fuqishëm, me sy të mprehtë e vëzhgues, me atë gjoks të gjërë e të rëndë si shkëmbi majë një mali, tërë forcë e energji vepruese për të nisur vepra të mëdha. Kështu e gjejnë atë ngjarjet e Lidhjes së Prizrenit. Vëllai i tij Xhelili, sapo ishte kthyer nga misioni historik në roje të besëlidhjes së madhe të Prizrenit së bashku me Xhafer e Baftjar Dodën, kur vdiq papritur në një moshë të re. Nga kjo kohë Elez Isufi mbajti mbi supe barrën e rëndë të familjes dhe misionin e lavdishëm të mbrojtjes së atdheut, në një nga periudhat më kritike të historisë sonë. Emri i tij shpejt do të bëhej i njohur, por dhe i frikshëm për armiqtë dhe tradhtarët. Ai do të bëhej udhëheqësi më popullor dhe më i besueshëmi, më i thjeshti dhe më i dashuri, prijësi i lavdishëm i vegjëlisë. Ai ishte simboli i besës dhe i bujarisë, i sakrificës dhe i trimërisë, burri i mençur i Dibrës dhe strategu i luftrave popullore, heroi i betejave legjendare, kreshniku i maleve tona dhe diplomati i pagabueshëm me opinga lëkure e kësulë të rrafshët dibre që u jepte drejtim kthesave më të vështira historike.

Janë mbi 46 vjet të jetës së tij të mbushura me shqetësime të panumërta për mbijetesë kombëtare, vite luftërash e betejash, vite qëndrese, krenarie e lavdie në mbrojtje të trojeve tona, të nderit e të dinjitetit shqiptar. Po të ecësh në gjurmët e këtij gjysëmshekulli të jetës së tij, nuk do të gjejsh asnjë vit të papërgjakur, asnjë muaj pa tym betejash e plagë lufte, asnje ditë të qetë e pa krisma pushke. Të gjitha mbulohen, si për çudi, me një aureolë të ndritshme, me një piskamë tronditëse të thirrjes së fuqishme " A besë-a- besë, o burra, për hatër të këtij vatani"! Dhe ngriheshin 7 e 70, përmbysej nata dhe vraponin malet, konak e oxhak mblidheshin tek pesë krismat e pushkës habertare. Dhe gjithkush pyet me të drejtë:- Ku e kishte, vallë, gjithë këtë fuqi ky njeri, ky djalë, ky bir, ky burrë? Ai e kishte fjalën fjalë e besën besë. Nga syri i tij plot dritë buronte mirënjohja dhe nderimi për njeriun e mirë, dora e tij e bardhë shtronte bujari dhe nga gishti tregues shpërthente flaka hakmarrëse për armiqtë.

Çdo beteje çiftelia i vinte pas. Tregojnë se kanë qenë mbi 20 këngë që trimëria i ka kënduar pushkës dibrane dhe prijësit të saj Elez Isufit. Ne kemi arritur të mbledhim të plota rreth 13 prej tyre, pa llogaritur këngët që i janë kushtuar atij pas vdekjes. Kënga në atë kohë ishte vlerësimi më dinjitoz për dike që e meritonte. Ishte medaljon, urdhër, ishte titull nderi e lavdie, ishte dekoratë, lapidar e monument. Kënga bënte portretin heroit, por edhe te tradhtarit. Ndaj kënga dibrane, si më e fuqishmja në trevat shqiptare, ka bërë vlerësime dinjitoze. Elez Isufin e ka quajtur arushë mali, që s'i tutet as mbretit e as kralit, burrë zotni, që Petre Kralit i rri karshi, trim me shtatë zemra, shqipja e malit që faron asqerët e kralit, ylli i mejdanit, besa e burrit, salltanet ndër krala, etj. duke i dhënë urimin e zemrës:"Gjeç rahmet, o Elez Aga"! Në dy vargje të një kënge popullore jepet qartë qëndrimi që mban populli ndaj dy figurave:

Ahmet beg, nip i Toptanit, (Është fjala për tradhtarin Esat Toptanin).

Elez aga, arusha e malit.

Duke ecur gjurmë pas gjurme të jetës së tij e shohim se si rritet dhe madhohet në sytë e popullit personaliteti i udhëheqësit. E nisi rininë e hershme si bari dhish dhe shpejt e shohim të ngrihet si një zë të fuqishëm kryengritës kundër shtypjes e padrejtësive. Vihet në krye të një çete komitësh si dalëzotës i mallit në fshatrat e Rekës duke vendosur rendin e qetësinë. Gradën si çaush i një poste e shfrytëzoi për të përzënë turqit e Sllovës dhe ky akt do të ishte prologu i gjithë kryengritjeve të mëvonshme antiosmane deri në shpalljen e Pavarësisë. Në vitin 1899 është pjesëmarrës në Kuvendin e Qarnanicës krahas burrave të pjekur për miratimin e vendimeve të Lidhjes së Pejës, për unifikimin e veprimeve luftarake të kërkesave të parashikuara nga besëlidhja e madhe.Turqit e shikojnë si një element shumë të rrezikshëm dhe kërkojnë ta eleminojnë. E arrestojnë dhe e burgosin në Manastir. Në vitin 1902 arratiset nga burgu. Udhëheq një çetë të armatosur, e cila kryen disa aksione të guximshme në Dibër të Poshtme. Në vitin 1908 Elez Isufi me çetën e tij siguron zhvillimet normale të punimeve të Kongresit të Manastirit. Ai tashmë ishte njohur dhe miqësuar me shqiptarët më me peshë të Perandorisë dhe kishte përvetësuar platformën e rilindasve. Në maj 1910 në krye të më se 2000 dibranëve shkon në mbrojtje të Kosovës dhe merr pjesë në luftimet e përgjakshme të Qafë-Prushit. Arrestohet dhe dërgohet në burgun e Manastirit. Më 27 mars 1912 nën kryesinë e tij dhe Selman Alisë shkrepi krisma e parë e çetave kryengritëse dhe formohet Komiteti Nacional i Dibrës. Elez Isufi ishte flamurtari më i flaktë i sulmit të përgjithshëm. Kryeson delegacionin që niset në Prishtinë më 6 gusht dhe takohet në Ferizaj me Hasan Prishtinën, Bajram Currin e Isa Boletinin, të cilët do t'i lidhë, siç dëshmojnë ngjarjet e mëvonshme, miqësia e përjetshme. Caktohet delegat për në Vlorë, por ngjarjet që rrodhën me vërtik, e penguan këtë udhëtim historik. Me Ismail Qemalin ai do të takohej më 14 gusht 1913, pak muaj pas shpalljes së Pavarësisë duke mbyllur kështu njërën prej faqeve të historisë së lavdishme.

Lufta me sërbët është padyshim më tragjikja për Dibrën. Elez Isufin e kemi në krye të kësaj epopeje 9-vjeçare. Në nëntor, 20 ditë para shpalljes së Pavarësisë sërbët hyjnë në Lumë, Shkodra rrethohet nga malazestë. Elez Isufi me një pjesë të dibranëve kthen nga rruga për në Shkodër dhe hidhet në betejën e famshme të Kolosnjanit, kundër armikut rezil që tashmë kishte trokitur te porta e nderit. Fitorja e kësaj beteje qe befasuese. Bisha tërbohet dhe më tepër dhe mësyn e pushton Dibrën e Madhe dhe viset gjer në Dri, pikërisht një ditë para se Plaku i Vlorës të ngrejë flamurin e lirisë. Një natë të bekuar ai me shumë zgjuarsi arrin të çajë rrethimin e kullës dhe të shpëtojë 70 anëtarët e familjes dhe vetë arratiset në mal. Sërbët djegin kullën, por flamurtarit të rezistencës i rritet nami fort, sa që fillon ta dëgjojë dhe Evropa e shurdhër. Në shtator fillon kryengritja e madhe dhe brenda një nate korret një fitore tjetër historike. Në tetor fillon ofensiva sërbe me terror të padëgjuar në masën e popullsisë. Digjen e shkretohen tërë viset shqiptare në dy anët e Drinit të Zi. Shpërngulën mbi 20.000 dibranë. Elez Isufi shkon pak kohë të luftojë në Shkodër kundër malazezve. Në vitin 1914 qeveria e Durrësit e ngarkon të ruajë rendin e qetësinë nga provokacionet sërbe. Në mars 1915 mblidhet një kuvend i madh në Sohodoll dhe vendoset për të luftuar lëvizjen esadiste. Në dhjetor të atij viti ndizet Lufta e Kaushit, një ndër kulmet e fitoreve, ku futet në darën e hakmarrjes popullore një divizion sërb që priste të kalonte në Durrës. Në tetor 1918 Dibra bije sërish nën kthetrat sërbe, tashmë krejt e lodhur dhe e përgjakur.

Në gusht 1920 formohet ajo që njihet si qeveria e Arrasit. Mblidhet kuvendi i madh dhe zgjidhet një komitet lufte me komandant të forcave kryengritëse Elez Isufin. Shpërtheu kryengritja që ndezi mbarë Dibrës flakën e fitores. Në Lanë-Lurë, në një ditë breshëri dhe shiu, ndizet beteja e përgjakshme e vendimtare për fitore. Elez Isufi qe kundër synimeve diktatoriale dhe mbështeti gjithmonë krahun e demokratëve përparimtarë si Hasan Prishtina, Ramiz Daci, Ramiz Dibra,etj. Në dhjetor 1921 i tërheq vemendjen parlamentit për të thirrë Asamblenë Kushtetuese. Në prill 1922 gjykata ushtarake e dënon me vdekje. Udhëheq Lëvizjen e Marsit dhe falanga e tij me malësorë, e kalitur në qindra beteja, pas luftimeve të ashpra, hyn triumfalisht në Tiranë:

Meleq Frashni, mor budallë,
Mos u dil para Reç-e-Dardhë!
Reç-e-Dardhë mos u dil para,
Çe nand vjet luftojnë me krala!

Ahmet Zogu fillon spastrimet me vrasjen e kundërsharëve. Me Plakun e Sllovës fillimisht nuk pati sukses, se ai e mbante pushkën për syri ngulur te kulla e Ndreut, e cila në preludin e Revolucionit të Qershorit mblodhi në gjirin e saj qindra patriotë e malësorë duke u kthyer në qendër organizative për tërë Dibrën. Demokratët e vërtetë e mbështetën këtë revolucion, sepse e shikonin si një mundësi për realizimin e aspiratave të tyre, megjithatë ishin të detyruar ta mbanin syrin dhe veshin zgjuar, sepse diçka e zezë po lëvizte matanë dhe përbindshi i kahershëm sërb duke derdhur arin si ujë në xhepat e lakmitarëve tradhtarë, rigjallëroi shëmtyrat e kombit dhe vuri në lëvizje kthetrat e gjakosura të hasmit të vjetër. Kështu zbritën nga Skërteci në mesin e dhjetorit hordhitë mercenare e tradhtare, rusë të bardhë e sërbë të zinj të Pashiqit, drejt Peshkopisë, ku ishin forcat vullnetare me në krye Elez Isufin. Disa nga paria dibrane, e zverdhur e xheloze, dinake dhe tinzare, e shitur për pesë pare, duke shkelur mbi gjakun e kulluar të lirisë, shtriu dorën e zezë të tradhtisë dhe vrau në pabesi shqiponjën e betejave liridashëse, Sufë Xhelilin dhe kreshnikun e maleve Elez Isufin, ata që kënga do t'u vinte pas vit pas viti e brez pas brezi:

Çou, Elez, thërrasin malet
Besë-a-besë përmbi urdi,
Herë me mbret e herë me kralët
Për vatan e për liri!

Kam shpresë se historia do të trokasë shpejt në mendjet e turbulluara, do të zhvishet nga gjethet e thara dhe do të zbulojë fytyrën e bukur të së vërtetës e do t'iu thotë me zë të qartë: - Ja ku jam e kush jam!

Janë disa burra të cilët nuk e kanë ndjekur lavdinë, por ajo u ka shkuar pas. Dhe nuk kanë nevojë fare as për grada, as për lavdi e as për monumente. Elez Isufi dekorohet nga perandori i Austro-Hungarisë me urdhërin "Franc Jozef Orden" për luftë kundër sërbëve. Për meritat e tij si udhëheqës gradat më të larta ia vuri në gjoks populli i tij: Komandant, gjeneral, burrë burrash, shqipe mali, i pari i të parëve, kreshniku i Dibrës, bajraku i mejdanit, diplomat, Plaku i urtë i Sllovës, njeriu që i ka fry hizri në gojë, etj.

Për Elez Isufin u shkrua shumë në shtypin e kohës duke i veshur cilësitë më të larta. Janë shkruar e vazhdojnë të shkruhen biografi, monografi, vepra letrare, këngë, poezi, drama, romane, kujtime, etj. Ai është përfshirë gati

(Vijon në faqen 17)

Dy botime të reja nga Naim Berisha

Naim Berisha
E DREJTA, E PADREJTA DHE KADIU
Fabula
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-85-1
Çmimi: 300 lekë

Fabula me tema të mprehta shoqërore

Nga **BARDHYL XHAMA**
Mësues i Merituar, Shkrimtar

Shkrimtari Naim Berisha kësaj here paraqitet para lexuesve me vëllimin poetik të titulluar "E drejta, e padrejta dhe kadiu", ku janë përfshirë 29 fabula, dy prej të cilave poema.

Libri është botuar nga "M&B" - Botime dhe Studio Grafike, tashmë e mirënjohur për botimet e saj cilësore.

Autori, i afirmuar tashmë si poet dhe prozator me një mori botimesh, si romane, novela, përmbledhje me tregime, fabula e poezi lirike, edhe me këtë libër tregon ecje përpara në rrugën krijuese, duke u radhitur në fabulistët tanë më të njohur.

Aftësia e autorit qëndron në faktin se ka ditur që në fabulat e këtij vëllimi të trajtojë tema të mprehta shoqërore, të kapë detaje të jetës dhe të bëmave të njerëzve, duke fshikulluar me mjeshtëri artistike veset e të metat e tyre, përmes një gjuhe e fjalori të zgjedhur, herë-herë me shprehje popullore, me ironinë e njohur dhe sarkazmën e tij dibrane, nga ka dhe prejardhjen.

Personazhet e fabulave janë njerëz, si borxhliu, i ngrati, kadiu, kopili e servili, i keqi dhe i miri, këngëtari, vëllai etj. Janë dhe fjalë kuptimore, si e drejta dhe e padrejta, vesi dhe mëkati, drita dhe errësira etj. Por mbizotërojnë kafshët e shpendët, shtëpiake e të egra, madje këto gjenden në shumicën e fabulave, si mushka, pela, dhia, cjapi, macja, gjeli,trumcaku, dallëndyshja, korbi, dhelpra, gomari, kukuvajka, kaprolli, ariu, ujku, çakalli, kanguri, zebra, e të tjera e të tjera.

Në shumicën e fabula përballet e mira me të keqen, vesi me virtytin. Kjo është arritur me natyrshmëri. Kështu, për shembull, fabula "Kukuvajka dhe këngëtari" mbyllet me vargjet: "Unë me këngë mbjell dashuri/ Ti me vaj vdekje ndjell". Ndërsa fabula "Miza dhe ushqimi" përfundon me vargjet: "Asht i neveritshëm/ Deformimi i mendimit tim/ Njësoj si miza në ushqim".

Disa nga fabulat shquhen për shkurtësi, me pak vargje e shume mendim, çka është karakteristikë e krijimtarisë së Naimit. Të tilla mund të përmendim: "E thëna", "Mëkati", "Lulet e së keqes", secila ma nga katër vargje. Por dhe fabulat me më shumë vargje, deri edhe dy poemat, lexohen me kënaqësi, ngaqë autori ka ditur të zgjedhë personazhet, të selitë fjalët e shprehjet në mënyrë të tillë, që të japin kënaqësi estetike kur i lexon dhe të bëjnë të mendosh e ta bësh tëndin mesazhin që përcillet në to.

Shkurt, përmbledhja me fabula "E drejta, e padrejta dhe kadiu" e Naim Berishës do të pritet mirë nga lexuesit, sepse në këtë libër do të gjejnë mesazhe edukuese, probleme jetësore të kohës që jetojmë, deri në tërheqje të vëmendjes për veset që e zbehin bashkëjetesën e një shoqërie demokratike të civilizuar.

Naim Berisha ka hyrë me dinjitet në historinë e letrave shqipe

Nga **HALIL RAMA***

Në harkun kohor të dy dekadave të fundit, Naim Berisha ka hyrë me dinjitet në historinë e letrave shqipe si poet dhe prozator. Dëshmia më e qartë për këtë janë botimi i 20 librave me poezi e prozë në 20 vite. Dhe pas kësaj krijimtarie tejet produktive e cilësore, të gjerë e të larmishme, të mirëpritura nga lexuesi dhe kritika letrare, ai paraqitet më së fundi me vëllimin e tij të ri me poezi dhe poema "Pengu i nëndheshëm".

Ky libër, i ndarë në gjashtë kapituj, ka një ndërtim interesant e disi të veçantë, duke ndërthurur dy linja që ecin paralel me njëratjetrën: atë të traditës dhe atë të dashurisë njerëzore. Nga faqja në faqe, nga kapitulli në kapitull, në 99 poezitë dhe poemat e librit, ata zbulohen më të plotë e më bindës.

Duke lexuar këtë libër, ndodhesh në një botë krejt të veçantë, ku ndeshesh me krijimin e situatave të reja. Në të dalin në pah perceptimet e autorit për mënyrën e të dashuruarit, duke pasur si pikë referimi autorë të njohur të kohërave moderne.

Poezia e këtij libri lë përshtypjen se është shkruar me shpirt; është një poezi spontane, e kulluar me një kujdes fin. E shprehur kjo, më së miri qoftë dhe vetëm tek vargu: "Dashuria është i vetmi fat, që njohim e dot s'e shmangim…!"

Naimi është lakonik, ai shkruan shkurt, por poezia e tij ka domethënie, ajo flet gjatë. Vargu i saj është i ngjyrosur bukur, është kuptimplot. Poezia e këtij libri sidomos, s'është e përmbytur nga abstrakti, nga pakuptimshmëria, siç shohim jo rrallë nëpër poezitë e sotme. Pra, s'janë hermetike, por të hapura dhe që të bëjnë për vete që në kontaktin e parë. Kësisoj, kemi të bëjmë me një hop jo vetëm sasior, por edhe cilësor të Naim Berishës. Dëshmi e këtij hopi janë edhe vetë titujt tepër domethënës të kapitujve të këtij libri si: "Flladi i bjeshkës", "Ngjyrat e një jete", "Drurët e ullirit" (Një poemë filozofike kjo, sidomos në ciklin "Në fillim dogjëm ullinjtë"); "Me ca miq më pak" dhe "Metaforë".

Karakterin e brezit të tij, si frymën më të re që Zoti mbi këtë truall të lashtë fali (poema "Brezi im", kushtuar brezit të viteve '90-të, që çliroi atdheun nga kthetrat e diktaturës më të egër në botë) Naim Berisha e shtjellon në gjithë shtratin e tij poetik, në mënyrë perfekte. Këtu dallohen përpjekjet e autorit për të gjetur me saktësi zanafillën e dhembjes dhe cakun e ndarjes me sistemin monstër. Mendimi filozofik i Naim Berishës kuptohet fare qartë qoftë dhe në vargjet: "Lebetitej dhjetori i atij viti/Nga dridhjet, lëkundjet e tërmetit/Bëheshin er e iknin/Bëheshin borë e shkriheshin/ Njerëzit…". Në këtë poemë ai percepton gjer në thellësi dhimbjen njerëzore, të cilën në mënyrë sinjifikative e shpreh në vargjet:



Naim Berisha
PENGU I NËNDHESHËM
Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-84-4
Çmimi: 400 lekë

"Në një qoshkë të vetmuar
Nofullat së përtypuri
Me kreshpëroheshin në kohë të shkuar
Shtati im i gjori
Mështeknë degëtharë
Qe përmbytur i gjithi në drojë e në mall
Në vorbull ngjarjesh të pazakonta
Vërtitesha si një top llastiku
Në konture siluetash të nesërme skicohesha
Përmes një lidhje gjaku
Nyje gordiane e trishtme
Dilja dhe shihesha, qartësisht
Në pasqyrat e pakënaqësisë së përgjithshme
Tani, së paku, jam i lirë të bëj si të dua…"

"Ngjyrat e një jete", kjo temë, ndër më të spikaturat, trajtohen me detaje poetike shumë të gjetura dhe shprehëse, në poezitë me titujt respektivë: E gjelbra; E verdha, E kuqja; E bardha dhe E kaltra…

Ndërsa në kapitullin "Me ca miq më pak" dallohet fare qartë fryma polemizuese që përshkon thuajse të gjitha poezitë. Mjafton për këtë t'iu referohesh poezive "Të pacipë", "Do vras heshtjen", "Varri i gjallë", "Ngujimi i jetës" apo qoftë dhe vetëm vargjeve" E unë stërnip i Kastriotit/ S'i duroj fyerjet e "kurvës së motit".

Në këtë libër me nivel estetik poeti sjell zërin, tonin e tij frymëzues me ndjeshmërinë dhe gjetjen e figurave të spikatura letrare si tek poezitë: "Ëndrra e fundit e Gjorg Berishës", "Tregim i zanës për Halil Agën", "Si kalë i kuq, e kam një huq", "Kishte pjellë mushka ", "Sa zgjat pendimi" etj.

Në poezitë e Naim Berishës, e veçanërisht tek ato të titulluara "Pengu i nëndheshëm", "Halli", "Njerëzit që më kanë vdekur"," Ngujimi i dritës"," Koha dhe perënditë" ndihet transfuzioni i gjakut. Vargjet e këtyre poezive kanë brenda peshën e mendimit të tij filozofik., më e spikatur kjo tek "Halli": (Ç'më zuri një hall/ S'e desha veten gjallë/ Në ç'hall rashë/Me hasmin të hash/Me hasmin të pish/Me gjakun në këmishë/ Dreqi, i biri i dreqit/ …në lojë/ Ta vras, thashë, me bukë në gojë". Këto vargje dëshmojnë percepsione të poetit në momente të trishta. Gjetjet apo përgjithësimet poetike këtu vijnë natyrshëm, sepse ai ka arritur të derdhë shqetësimin e vetë të ligjshëm për udhëkryqin ku ndodhet shoqëria jonë. Kësisoj ai është një zë origjinal, që inkurajon vetveten dhe të tjerët.

Gati në gjithë vëllimin trajtohen motive të larmishme, ku mbizotërojnë ato të atdhedashurisë së ndezur, veçse në variacione shumëngjyrëshe. Këto vjersha janë si një buqetë me lule të freskëta erëmira, të rritura në kopshtin e pasur të poezisë lirike, të cilat të kënaqin me aromën autoktone shqiptare.

Poetët më të mirë të botës, gjithmonë e kanë gjetur frymëzimin në mbështetjen te poezia popullore dhe e traditës, në gurrën e baladave dhe legjendave, mbi bazën e të cilave kanë shkruar vepra me vlera universale. Kështu bën edhe Naimi Berisha. Me lakonicizmin e tij ai duket sikur thotë se poezia është mbretëresha e artit, ndaj ta themi të vërtetën, shkurt dhe bukur. Në këtë libër të ri, autori dëshmon së s'është një letërnxirës, përkundrazi, si një poet i vërtetë, ai e drejtpeshon fjalën, e njeh gjakimin e saj, e ndjen muzikën e padëgjuar të mendimit poetik si dhe e dallon ngjyrën e pashfaqur të ndjenjës. Këtë e tregon mirëfilli të shkruarit qartë, shkurt, lehtë dhe me kuptim të thellë.

Duke lexuar dorëshkrimin e Naim Berishës "Pengu i nëndheshëm", pata ndjesinë se dhe unë jam duke vrapuar mbi një "peng të nëndheshëm" përmes resh ende të turbullta, që rreken paprajshëm të më verbojnë shikimin e hapësirës sonë autoktone. Dhe bindem se çdo poezi e tij është si një pikë uji e gjithë deteve dhe oqeaneve të kësaj bote, përmbi të cilët Naimi ka fluturuar ose më saktë, si një pikë vese mbi lulet e kësaj toke të lashtë e të përgjakur. Mos më zini besë mua, po merreni librin, shfletojeni me kujdes dhe atëherë do të më jepni të drejtë. Do të shihni se vjershat e Naimit janë si vetëtimat në qiell, prej të cilave kap ç'të kapësh. Po brenda shkreptimave të poezive të tij është flaka, metafizika e tij, drita e mendjes dhe freskia e zemrës dhe shpirtit të tij poetik. Ku ka më bukur se të lexosh vjersha që vërtet janë art, vjersha si copëza që vijnë prej flakërimeve qiellore.

Në vitet ''80-të Naimit s'iu botua libri se vjershat e tij quheshin hermetike, të errëta, etj.

Që nga libri i tij i parë i suksesshëm, "Ngado sytë e vajzës" ('93), e deri më sot, poezia e tij, nga libri në libër, ka ardhë gjithmonë e më e mirë ...

Librat e tij, si në prozë dhe në poezi janë vlerësuar gjithkohshëm nga penat më të arta të letërsisë shqipe, si nga shkrimtarë e poetë të letërsisë për të rritur, ashtu dhe nga ata të asaj për fëmijë, si: Drittëro Agolli, Teodor Laço, Bardhyl Xhama, Odise Grillo, Bedri Dedja, Fatos Arapi, Xhevahir Spahiu, Ramadan Mysliu, Nasho Jorgaqi, Mehmet Kraja, si dhe nga kritikë e studiues të artit dhe letërsisë: Behar Gjoka, Miho Gjini, Hajri Mandri, Fatmir Terziu e shumë të tjerë.

Pas kualifikimeve pasuniversitare në Londër për letërsi angleze, kritikë letrare dhe muzikë, poezia e Naimit na duket më e pjekur, më e përmallshme për atdheun dhe vendlindjen ...

Vitin e ardhshëm Naimi ka njëzet vjetorin e botimit të librit të parë dhe në këto njëzet vite ai numëron njëzet libra artistikë. E veçantë për këtë shkrimtar është se të gjithë librat i ka botuar në kohë të demokracisë dhe nuk ka asnjë libër socrealist.

Gjithsesi, në tërësinë e këtij libri ndeshim këndvështrime të freskëta e origjinale, në të cilat shoqëria e realiteti i sotëm jepen në unitet e vazhdimësi. Kjo pohohet artistikisht përmes tablove e detajeve të zgjedhura me kujdes, për të pasqyruar sa më realisht këtë shoqëri në evoluim e progres të pandërprerë…

** Shkrimtar – Redaktor i Kulturës në "Rilindja Demokratike"*

kritikë

"Gjenerali me shajak",

një libër që tregon se si duhet shkruar për figurat e shquara

Nga **Prof. Dr. IBRAHIM MILUSHI**
Universiteti Politeknik i Tiranes

Sa herë që boton libra Xhafer Martini unë i marr dhe i lexoj me kënaqësi, mbasi e di se ai, duke qenë shkrimtar i talentuar dhe me përvojë të gjatë, dhe, mbi të gjitha, duke qenë kërkues ndaj vetes, i jep lexuesit gjithmonë vepra të arrira. Këtë ndjenjë provova edhe kur pashë në librari librin e tij më të fundit "Gjenerali me shajak", kushtuar figurës së legjendës dibrane, atdhetarit te shquar Elez Isufi. Dhe nuk dola aspak i zhgënjyer, madje, me sinqeritet them se autori i tejkaloi shumë herë parashikimet e mia për një libër të mirë. Ky është nje libër i spikatur që të kujton monografitë e mrekullueshme të Cvajgut dhe të autorëve të tjerë të mëdhenj për figura të shquara botërore. Edhe ne kemi figura të shquara, natyrisht, të atyre përmasave që mund të ishin, por puna është jo vetëm t'i qëmtosh e t'i zbulosh, por edhe të dish t'i paraqesësh me vërtetësi dhe bukuri stili dhe me begati mendimesh. Sado e shquar të jetë një figurë, sado të ketë merita, po nuk dite ta shkruash, po nuk pate mjeshtërinë për ta dhënë, shumë-shumë mund të marrësh një informacion për të, por nuk përfiton kënaqësi të gjithanshme. Libri "Gjenerali me shajak" të shkakton vërtetë kënaqësi. Po e nise për ta lexuar, nuk e heq nga dora derisa ta mbarosh. Këtë mund ta provojë secili nga lexuesit dhe do të më japë të drejtë se nuk po ekzagjeroj asgjë. Xhafer Martini, duke qenë shkrimtar i vërtetë, ka ditur që talentin letrar, ato mundësi që ka letërsia, t'i vërë në shërbim të historisë, konkretisht, në shërbim të paraqitjes së figurës së Elez Isufit. Por të vësh letërsinë në shërbim të historisë, nuk është gjë e lehtë, kjo kërkon mjeshtëri, kërkon ruajte të masës, gërshetim stilesh, shfrytëzim të mjeteve të tjera shprehëse, si kompozicioni, planet rotrespektive, dialogët etj., etj. Po nuk qe mjeshtër, mund të rrëshqasësh në letrarizma bajate, që, në vend që të ta bëjnë figurën të dashur, ta ftohin atë dhe e bëjnë të pabesueshme. I theksova të gjitha këto se, pa kuptuar një gjë të tillë, nuk e kupton edhe monografinë e Xhafer Martinit për Elez Isufin, se ajo nuk është një monografi e tipit "të dalë ku të dalë" ose "kap e shkruaj", por ajo është hartuar me kujdes, me zgjuarsi dhe aftësi, duke shfrytëzuar në maksimum potencialet krijuese. Prandaj ajo është ndryshe nga monografitë e tjera për figura madhore, është ndryshe se është konceptuar ndryshe, është shkruar ndryshe, është dhënë ndryshe.

Autorin nuk e kanë interesuar thjesht ngjarjet si të tilla, ngjarjet në vetvete, por domethënia e tyre historike, roli që ka luajtur Elez Isufi në zhvillimin e tyre, dhe, para së gjithash, figura e Elez Isufit, jo thjesht si luftëtar dhe udhëheqës i shquar i kryengritjeve popullore kundër pushtuesve serbo-jugosllavë, por edhe si njeri, si baba, si kryefamiljar, me të mirat dhe të metat. Autori ka ngulmuar dhe ia ka arritur të tregojë rrugën e formimit të protagonistit. Me shumë mjeshtëri ai ka ditur të japë se Elez Isufi në fëmijëri ishte një djalë çapkan, sherrxhi, që nuk linte dy gurë bashkë, si thotë populli. Askush nuk e mendonte një të ardhme të ndritur për të, askush nuk e mendonte se ai do të arrinte te bëhej nje figure e tille. Përkundrazi, parashikonin një fat të hidhur për të, që do ta gjente atë që kërkon me sherret dhe prapësitë që bënte. Rruga e formimit të Elez Isufit nuk ka qenë e lehtë, nuk ka qenë shesh me lule, por plot me ferra dhe driza, plot të përpjeta dhe të tatëpjeta, me shumë pengesa dhe vështirësi. Ky procedim artistik dhe historik ka bërë që figurën e Elez Isufit ta shikojmë në rritje të vazhdueshme, duke fituar vetëdijen kombëtare jo menjëherë, por ngapak - ngapak, ngadalë, nën ndikimin e rrjedhave të jetës dhe të shumë faktorëve të tjerë. Ndërkohë qe u bë personalitet, Elez Isufi ndikoi vetë mbi ngjarje dhe mbi njerëzit. Dialektika e këtyre marrëdhënieve është dhënë shumë bukur nga autori, çka tregon për formimin e tij të gjithanshëm, jo vetëm letrar e historik, por edhe filozofik.

Xhafer Martini shumë vite më parë (1993) pat botuar monografinë "Elez Isufi". Edhe ajo ishte një vepër e shkruar bukur, korrekte në paraqitjen e fakteve dhe ngjarjeve. Por monografia e tanishme "Gjenerali me shajak" është më cilësore, sepse është shkruar me tjetër qëllim dhe me tjetër pikësynim. Edhe pse ka të njëjtin hero, është një libër i ri, mbasi i ri është këndi i shikimit të ngjarjeve, i ri është interpretimi i tyre, e re është mënyra e të shkruarit, e re është mënyra e të konceptuarit, e re është, mbi të gjitha, mënyra e të menduarit të gjithçkaje të së kaluarës dhe, në këtë kuptim, e re është edhe figura e Elez Isufit. Kjo risi për figurën e Elez Isufit qëndron në plotshmërinë, në individualitetin, në plasticitetin, në frymëmarrjen, në konceptin e ri për heroin dhe heroiken, në mësimet që duhet të nxjerrim nga historia.

Xhafer Martini ka arritur të thyejë të gjitha skemat në paraqitjen e figurave historike. Por thyerja e skemave nuk është e lehtë, sepse, nga dëshira për të thyer një skemë, kalon në një skemë të re, që është po aq e rrezikshme sa e vjetra. Kështu, për shembull, dashuria e madhe për figurën, mund të çonte në një ekzaltim të padëshiruar shprehje e të cilit është idealizimi i figurës, glorifikimi i saj, një apologji që nuk vlen shumë. E kundërta, pra, shikimi me syze të errta, mund të çonte në minimizimin e figurës, në qëmtimin me lupë të ndonjë devijimi historik të figurës kah kahja jo kombëtare, ndonjë veti të ashpër të personalitetit, pa dhënë kuadrin historik, psikologjik, moral, etj. Të dyja këto shfaqje janë të dëmshme dhe skematike. Xhafer Martini ka meritën që ruan në maksimum ekuilibrat, manovron me mjeshtëri përmes të të kundërtave, duke i parë ato në unitet të plotë.

Një njeri pa kulturë të gjithanshme nuk mund ta shkruante një libër të tillë edhe sikur materialin ta kishte të gatshëm dhe të plotë. Materiali duhet interpretuar, çdo ngjarje duhet analizuar me hollësi dhe vëmendje duke pasur vetëm një matës: interesin kombëtar. Parë nga ky kënd, autori nuk ka ngurruar të tregojë se më ndonjë rast në rininë e tij të hershme Elez Isufi nuk ka ecur në hullinë e atdhetarizmit. Në fund të fundit ai ishte njeri dhe gabimet e tij ishin njerëzore. Njeriu është qenie e papërkryer. Elezi ka pas shumë bashkëmendimtarë që kanë vepruar si ai, per pasoje edhe ai vetë ka marrë parasysh këshillat e tyre. Kështu, si shembull, Lëvizjen e Marsit 1922, Revolucionin e Qershorit 1924, autori i shikon në një dritë të re, që buron edhe nga formimi i tij gjatë këtyre njëzet vjetëve, por edhe nga të dhënat e reja që kanë dalë në dritë për këto ngjarje. Për Xhafer Martinin si krijues dhe studiues nuk ka tabu. Por ai nuk kalon në anën e kundërt vetëm në emër të luftës kundër tabuve. Nuk është ekuilibrist e centrist, por autor që e vështron gjithçka me syrin kritik, pa u ndikuar nga askush dhe nga asgjë. Botëkuptimi i këtij autori ka evoluar, sepse, nga natyra ai është njeri që mëson çdo ditë dhe do të mësojë deri në frymëmarrjen e fundit. Por ai si personalitet krijues, si studiues, i ka disa shina nga të cilat nuk shmanget, gjë që do të çonte në tjetërsim.

Meritë e shkrimtarit është edhe kultura e të shkruarit. Në libër gjen shumë episode që ke dëshirë t'i lexosh dy-tri e më shumë herë, si për bukurinë e stilit, ashtu edhe për përfundimet e drejta që nxirren prej tyre. Autori nuk e ka për gjë të bëjë edhe në histori fluturime lirike, zhvendosje në kohë, paralelizma figurativë, portretizime karakteresh, qoftë edhe me pakë radhë. Po të shprehesha me figurë, do të thosha se në këtë libër ka edhe lëndina të lulëzuara, pyje e fusha gjithë freski e bukuri, siç ka edhe male, përrenj të rrëmbyeshëm dhe të zhurmshëm, gremina dhe qafa të rrezikshme. Është një libër i natyrshëm, prandaj edhe ngjan me natyrën.



Xhafer Martini
"GJENERALI ME SHAJAK"
Monografi
Botimet "Dita 2000"
ISBN: 978-99956-92-78-0
Çmimi: 1000 lekë

Kjo mënyrë të të shkruari nuk e ka bërë figurën e Elez Isufit amorfe, të mjegulluar, të pakapshme. Përkundrazi, e ka bërë shumë të plotë, të rrokshme, të dashur, njerëzore. Mënyra se si e ka rrokur ai figurën është vlerë e letërsisë. Të vërtetat që janë thënë për të janë vlera të historisë. Kemi një pajtim dhe përputhje të plotë të vlerave të ndryshme që, kur përafrohen në bazë të ligjësive të secilës prej tyre, shkrihen dhe krijojnë një vlerë më vete.

Kush ka lexuar ose do ta lexojë romanin e fundit të Xhafer Martinit "Kur vdiste kanuni", do ta ketë shikuar ose do ta shikojë se figura e Kucbashit të Madh është fort e ngjashme me Elez Isufin, siç është e ngjashme edhe me patriotë të tjerë të asaj periudhe. Por, në të njëjtën kohë, lexuesi heton edhe ndryshimet midis tyre për arsye se protagonisti ndryshon me personazhin letrar. Tek "Gjenerali me shajak", kemi një shkrirje organike të tyre.

Mund të shkruaja edhe më shumë për një libër me plot vlera siç është "Gjenerali me shajak", por sado që unë të shkruajë, nuk mund të jepet dot ajo bukuri dhe kënaqësi estetike që përftohet kur librin e lexon vetë. Këtë frazë mos e merrni si shprehje standarde për shkrime të kësaj natyre. Do të ishte më keq po ta merrnit si reklamë. Unë kam zbuluar vetëm një pjesë të vlerave të librit.

Elez Isufi - fuqi, besë, shpëtim dhe shpresë për kombin

(Vijon nga faqja 15)

në të gjitha botimet historike të peridhës që jetoi, diku më pak e diku më shumë, sepse dhe më të padëshiruarit i ngecet penda para veprës së tij dhe s'mund të bëjë kapërcime revansh. Shumë historianë e kanë quajtur strateg luftërash, kryetrim, Roja e Kufirit Shqiptar. Të huaj e vendas janë ndalur shpesh te figura e Elez Isufit. Roze Lang, shkrimtare amerikane e quan Trim i Dibrës dhe britaniku Barnes patriot të madh. Vrasja e albanalogut kroat Milan Shuflaj që u thirr urgjentisht nga sërbët pas vizitës në shtëpinë e Elez Isufit ishte e sajuar nga ana e tyre për të eleminuar një personalitet me rëndësi që do të shkruante të vërtetën për trimin e Dibrës. Nermin Vlora i quan Elez Isufin dhe Isuf Xhelilin trima madhështorë që u vlon ndër deje gjak shqiptar. Filozofi Isuf Luzaj e quan njeri të hekurt që i tansformonte njerëzit e thjeshtë në heronj. Fan Noli flet me simpati për gegën e mençur, trim e të pashoq. Skëndër Luarasi në librin që i kushtohet Isa Boletinit tregon për dy netët e këndshme që kaloi në kullën e Plakut të Sllovës, kur po udhëtonte drejt Vlorës. Por shkrimet më të mira që e ngrejnë lart figurën e tij si patriot, -thotë në kujtimet e tij Ismail Strazimiri, - janë burimet e shumta arkivore sërbe që flasin me mllef të pashoq për heroin tonë.

Një monografi dinjitoze për gjeneralin me shajak ka shkruar Xhafer Martini. Haki Sharofi ka lënë në dorëshkrim kujtimet e tij me vlerë. Haki Stërmilli e ka personazh kryesor në dramat e tij historike, Rexhep Krasniqi e quan shtyllë të sigurtë të vijës kufitare verilindore, Ibrahim Farka i thotë trim legjendar, Abdulla Çanga kujdestar plot pasion për shkollën dhe arsimin shqip, që bën epokë dhe sjell pavekësinë shprehet për të historian Gafurr Zoto, ndërsa një ndër personalitetet më premtuese e më të talentuara, prifti shkodran Dom Lazër Shantoja, i pushkatuar më 1946 nga diktatura, e ka personazhin kryesor të dramës së tij historike "Kuvendi i dëshmorëve". Ai e vizitoi në Sllovë dhe shkruan me shumë simpati për personin që çdo send tjetër para tij humb interesin. Në këto 5 rrokje secili shqiptar shef njeriun me famë legjendare, që ari i sërbisë nuk mundi me e thye kurrë. Elez Isufi! Fuqi, shpresë, kërcënim!- shkruan ai, i cili, siç thotë Irfan Tërshana, u thirr nga Perandori si njohës i shkëlqyer i gjermanishtes, të përkthente fjalët e malësorit të Dibrës, që e kishte ofruar për dekorim.

***

I solla këto jo se ata janë pak të njohura, por më shumë si një kujtesë historike në këtë 100-vjetor të krenarisë kombëtare, ku secila figurë duhet të gjejë vendin e vet. Trimi, ku ka vënë këmbën, ka ngritur dhe muranën. Është një vend këtu në Tiranë që quhet "Qoshja e Elezit". A thua nuk e meriton një përmendore? Fatmirësisht pasardhësit e kësaj dere të ndritur nuk e kanë humbur shkëlqimin. Unë u ndala te lufta e Dibrës dhe posaçërisht tek njera prej figurave të saj, për të cilin, fatkeqësisht, historia e ka mbyllur njerin sy. Por, nga kjo dritare shfaqen e gëlojnë qindra e qindra ngjarje dhe figura të ndritura të Dibrës, që, padyshim, duhen vënë sipas meritës në pjedestalin e lavdisë kombëtare dhe kurrë sipas shijeve dhe interesave personale.

Ibrahim Kadriu nominohet "Romancieri shqiptar i vitit"

Nga **Dr. MAHMUD HYSA**

Qendra PEN e Shqipërisë, me 15 dhjetor 2012, në sallën e Ministrisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit në Tiranë, për herë të parë në aktivitetin e saj, ndau shtatë çmime vjetore për arritjet letrare kulmore brenda vitit në vijim dhe atë : për veprat më të shënuara nga poezia, romani, tregimi, përkthimet, monografitë shkencore, për arritjet shkencore për 100 vjetorit e Pavarësisë dhe çmimin inkurajues për krijuesit më të rinj. Duhet të themi se PEN Qendra e Shqipërisë këto çmime i ndan në koordinim me praktikën e "PEN Internacional" ku ajo është anëtare dhe, sipas fjalëve të presidentes Entela Safeti Kasi, pritet që pas dy viteve PEN Qendra e Shqipërisë të jetë kryesuese e këtij asosacioni mjaft prestigjioz në fushën e letërsisë evropiane.

Mbledhjen e udhëhoqi me mjaft elokuencë presidentja e PEN Qendrës së Shqipërisë, Enetela S. Kasi, dhe në mënyrë autoritare kryetari i Bordit prof. dr. Sadik Bejko. Në sallën e MKRS, në Tiranë, në prezencën e mysafirëve të shumtë dhe të auditorit të interesuar për fjalën artistike dhe shkencore u ndanë shtatë çmime për krijuesit letrarë dhe shkencorë për gjithë trojet shqiptare, duke përfshirë edhe PEN Qendrat e Kosovës dhe të Maqedonisë.

Laureatët për shtatë çmimet për arritjet kulmore në fushë të arteve letrare dhe të arritjeve shkencore iu ndanë: Neritan Cekës, Çmimi jubilar për 100 vjetorin e Pavarësisë, Xhevat Lloshit, Çmimi për monografinë shkencore "Përkthimi i Vangjel Meksit 1819-1827 dhe redaktimi i Grigor Gjirokastritit", Rudolf Markut, Çmimi për vëllimin poetik "Një ballkanas në Londër", Ndue Gjukës, Çmimi për vëllimin me tregime "Tepër e thjeshtë", Ibrahim Kadriut, Çmimi Romancieri shqiptar i vitit, Resul Shabanit, Çmimi për përkthimet nga maqedonishtja në shqip dhe nga shqipja në maqedonisht, dhe Elida Locit, Çmimi inkurajues për vëllimin e saj të parë poetik "Tingujt e mëngjesit".

Në këtë solemnitet, u fol vetëm për romanin e fundit Pjella e dreqit të Ibrahim Kadriut, romancierit tonë të shquar dhe të afirmuar në tërë letërsinë bashkëkohore shqiptare, nga njohësit e veprës letrare të këtij krijuesi, Prof. Dr. Sadik Bejko dhe Prof. Dr. Mahmud Hysa. Ligjëruesi i parë për këtë roman ndër të tjera tha: "Në strukturën e romanit, në pajtim me poetikat e postmodernes, janë ndërlidhur ndërmjet blloqeve të tekstit unik romanor, mikrostukturat tekstuale që hapin dritare dhe kthjellojnë më tej atë që duhet thënë e nënkuptuar mbi personazhin kryesot të romanit...", ndërsa i dyti këtë roman e vlerësoi: "Si të parin roman që mëton të transponojë artistikisht të vërtetën objektive të përditshmërisë sonë kontrastive të politikës dhe të politikanëve të periudhës së pasluftës së fundit... Përmes këtij romani Kadriu arrin të zbulojë, po artistikisht, banalitetin, trivialitetin dhe groteskën e politikës së tyre; oportunizmin, karrierizmin dhe korrupcionin; idealet e thyera, malikavelizmin e demoduar dhe kulltukofagët (shprehje e Nolit) e sotëm... Është roman i personazhit që temën kryesore e zhvillon dhe e zbërthen përmes karakterit dhe veprimeve të personazheve si Din Gurziu, Roberti dhe Uran Sina... Për shumësinë e temave mund të quhet roman polifonik...Citatësia dhe intertekstualiteti, si dy fenomene të romanit postmodern, integrohen edhe në romanin Pjella e dreqit... Për vlerat shumëdimensionale që ka artitur autori, meriton të quhet roman i vitit...".

Hoxhë Hasan Moglica, një figurë e madhe patriotike që meritonte të rivlerësohej në këtë 100 vjetor

Shënime për librin e Dr. Valbona Ramçit "Hoxhë Hasan Moglica, klerik dhe luftëtar i shquar për lirinë dhe gjuhën shqipe"

Nga **YMER STOJKU**

Dr. Valbona Ramçi u ofroi kohët e fundit lexuesve, në prag të 100 vjetorit të pavarësisë, monografinë kushtuar klerikut dhe luftëtarit të shquar për lirinë dhe gjuhën shqipe, Hoxhë Hasan Moglica.

Në këtë botim me vlera të mëdha historike lexuesi do të njihet me ngjarje e ndodhi të guximshme nga jeta e këtij trimi dhe burri të mençur dibran si dhe me kontributin e çmuar të këtij atdhetari jo vetëm në Okshtun, por në mbarë Dibrën dhe Shqipërinë. Do të njiheni me çetën e tij patriotike, me luftërat dhe betejat kundër serbve në periudhën 1912 - 1915. Do të njiheni me pjesëmarrjet dhe kontributin e tij madhor në kuvendet patriotike që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit, në Kongresin e Dibrës e të Elbasanit.

Kur në Vlorë Ismail Qemali dhe delegatët e kombit shqiptar ngritën flamurin shqiptar dhe shpallën pavarësinë, Hoxhë Hasan Moglica ngriti mbi çatinë e kullës së tij flamurin që kishte ruajtur ndër vite.

Ai priti si mysafir të nderuar dhe shoqëroi Abdyl Bej Frashërin për në Teqenë e Martaneshit dhë më pas në Dibër dhe deri në Prizren.

Hoxhë Moglica u përgatit dhe u diplomua si mësues dhe mori titullin hoxhë në Stamboll për të ardhur në atdhe dhe për të përhapur më pas gjuhën dhe shkollat shqipe. Ai bëri sakrificën madhore që rrallëkush mund ta



bënte duke rrezikuar edhe jetën, ai solli nga Stambolli 5000 abetare duke i futur në thasë sheqeri dhe duke i transportuar nga miqtë e tij tregëtarë dhe patriot. Ai hapi shkollën shqipe në shtëpinë e tij në Moglicë dhe dërgoi më pas tetë djem nga Okshtuni dhe zona e Gollobordës për në Shkollën Normale të Elbasanit, në zbatim të vendimeve të Kongresit të Elbasanit, ndërmjet të cilëve edhe të birin e vetëm, Osmanin.

Hoxhë Hasan Moglica ishte bashkëpunëtor dhe bashkëluftëtar me Abdyl Bej Frashërin, Iljas Pashë Dibrën, Haxhi Vehbi Dibrën, Aqif Pashë Elbasanin, Hoxhë Hazis Lilën, Sheh Hajredin Zerqanin, Hoxhë Vokrrin, Dan dhe Feta Camin, Elez Koçin, Medin Kormakun etj.

Janë të njohura tashmë luftimet kundër serbve tek Ura e Spiles ku krahas çetës së Dan Camit mori pjesë e edhe çeta e Okshtunit e komanduar nga Hoxhë Hasan Moglica.

Hoxhë Moglica është ndër ata luftëtarë që pranoi të futej i gjallë në varr dhe të mos përkulej para pushtuesve serbë që kërkonin që hoxha të deklaronte se tokat e Okshtunit dhe të Gollobordës ishin Serbi. Dhe kundërpërgjigja e Hasanit ishte:" Në këtë tokë ku unë po bi/Ka qenë, asht dhe do të jetë Shqipni.

Libri është i plotësuar edhe me këngë, poezi, poema, faksimilje, dokumenta që e bëjnë librin edhe më të plotë si monografi historike. Autorja Valbona Ramçi jep edhe mesazhe aktuale për ditët e sotme, mesazhe që rrjedhin nga jeta dhe vepra e këtij luftëtari dhe dijetari të shquar.

Në kuadër të 50 vjetorit të pavarësisë Hoxhë Hasan Moglica dekorohet me urdhërin për veprimtari patriotike krahas Ismail Qemalit, Abdyl Frashërit, Isa Boletinit etj.

Dhe për çudi në këtë 100 vjetor nuk u kujtua askush për të nderuar dhe për ta vënë në piedestalin që i takon këtë figurë monumentale. Është nisma personale e autores dhe kontributi i saj shkencor dhe ekonomik, ndërsa shteti, qarku, rrethi, komuna hesht. Një bust madhështor i këtij tribuni të shqiptarizmës do t'i bënte nder Bulqizës, Dibrës dhe mbarë shqiptarisë. Kurrë nuk është vonë për tu koregjuar, për të bërë më të mirën për çështjen kombëtare. Ai bëri atë më madhoren, dha jetën për Shqipërinë, po ne ç'po bëjmë për të?

Botim i ri

Humori popullor, baza e frymëzimit të krijimeve të autorit Nazmi Hoxha

Autori Nazmi Hoxha, pas një pune të gjatë hulumtuese, gjurmuese, krijuese dhe vëzhguese, më në fund ka guxuar të shfaqet para lexuesit me librin e tij të parë me poezi, fabula, anekdota në vargje dhe satira.

Këto krijime me vlerë përgjithësuese dhe me mesazhe jete mund të kishin mbetur edhe në sirtarin e autorit, por falë nxitjes së miqve të tij krijues dhe të fëmijëve të tij panë dritën e botimit.

Unë si redaktor i librit, e njoh autorin prej disa vitesh, e njoh që nga jeta ushtarake, nga zona e Dibrës, vendlindja e tij, nga puna e përbashkët në rradhët e Forcave të Armatosura, në fillim gjatë viteve të pushtetit totalitar dhe më vonë në përpjekjet për t'u integruar në strukturat e NATO-s.

Nazmiu ka qenë nga ata ushtarakë studiues, pedagogë të artit ushtarak, studiues të gjuhës angleze dhe të gjuhëve të tjera, bashkëpunëtor i shtypit, që kurrë nuk u lodh duke punuar dhe duke shkruar, duke kontribuar.

Pas përfundimit të misionit të tij si ushtarak, falë edhe këmbënguljes së fëmijve të tij, ai sot punon dhe jeton në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vendin e tempullit të Demokracisë, në vendin e punës dhe të të drejtave të njeriut.

Ndaj mos u habisni të dashur lexues, kur në rreshtat e këtyre krijimeve do të gjeni shpirtin praktik amerikan, shpirtin e protestës dhe frymën e re demokratike, në kundërshti me frymën në të cilën u rrit dhe punoi në Shqipëri.

Përshtypje të veçantë dhe risi në këtë



Nazmi Hoxha
ALBANIA E AMERIKËS
Poezi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-87-5
Çmimi: 500 lekë

libër të bën lidhja e fuqishme shpirtërore e autorit me vendlidjen, Dibrën, me Vakufin dhe Muhurrin, me traditat dhe zakonet e shkëlqyera të popullit dibran dhe shqiptar, me shqiptarizmën e tij deri në dejet e gjakut. Kjo duket në poezinë kushtuar fshatit të tij, Vakufit, kushtuar Dine Hoxhës, këtij tribuni të mençur popullor dhe të mjaft figurave të tjera të zonës ku u rrit. Për këtë shkak autori, por edhe unë si redaktor, shumë poezi i kemi lënë në gjuhën gegwrishte, me ndonjë shprehje krahinore për të qenë sa më të afërta me njerëzit që i pëlqejnë dhe i përdorin për të satirizuar fenomenet që nuk u pëlqejnë.

Shumë prej krijimeve të tij janë anekdota të shprehura në vargje, ndodhi të ndodhura në popull, janë fabula dhe satira për regjimin totalitar që kaloi Shqipëria gjatë periudhës socialisto-komuniste. Por ka edhe krijime që protestojnë edhe ndaj gabimeve që po bëhen gjatë tranzicionit të gjatë dhe të mundimshëm demokratik , ku lidër me të kaluar komuniste sundojnë dhe nuk ndryshojnë as metodat e drejtimit.

Poezi si "shpirti i protestës", "nomenklatura", " prepotenti", " majtas apo djathtas" etj., janë shprehje e protestës së tij ndaj padrejtësive shoqërore që ende vazhdojnë në Shqipëri.

Në vëllim vihen re shumë poezi me temë amerikano-shqiptare ku vihet re fryma e mirëkuptimit dhe bashkëpunimit midis SHBA dhe Shqipërisë si poezitë "Kodra e Devollit në Amerikë", "Bar kafe Tirana", "Mellisa" "E blerta në Hamilton", "Dita e falenderimeve" etj.,

Me këtë vëllim të parë autori nuk pretendon të arrijë majat apo të futet në rradhët e poetëve dhe fabulistëve me emër, por të japë një kontribut jo të vogël në goditjen e fenomeneve negative të shoqërisë sonë dhe mendoj se ja ka arritur.

SAKIP CAMI
Poet dhe publicist

recensë

I përkushtuari ynë

- Mendime për librin "I përkushtuari…", monografi për mësuesin Ismail Erebara të autorëve Faik Xhani e Hatixhe Erebara

Nga **RAMAZAN S. ILNICA**

Në ditën e parë të këtij nëntori të bekuar të 100-vjetorit doli nga shtypi libri "I përkushtuari", monografi për mësuesin Ismail Erebara nga Dibra. Monografia është shkruar nga dy autorë: Faik Xhani, studiues, publicist dhe poet matjan, ish-nxënës i tij si dhe Hatixhe Erebara, bashkëshortja e mësues Ismailit si dhe autore e dy librave në prozë e poezi. Është kënaqësi të vlerësojmë, që në fillim, se monografia lexohet me një frymë dhe me kënaqësi për vetë nivelin e arrirë si një krijim publicistiko-letrar ashtu dhe për vlerat e padiskutueshme, sepse shpalos me objektivitet jetën e veprën 50-vjeçare të mësuesit të përkushtuar të matematikës, të zotit Ismail Erebara. Libri "I përkushtuari…", veç që është një studim monografik i mirë në aspektin e gjinisë letrare, shpalos me brendinë e saj mesazhe të fuqishme humane e profesionale të një mësuesi që së bashku me plejadën e brezit të traditës së Pasçlirimit, i bëjnë nder historikut të arsimit në Dibër e më gjerë.

Autorët, përmes shkrimeve të tyre dhe kujtimeve të ish-nxënësve e kolegëve, nga fjala në fjalë e nga rreshti në rresht të kësaj monografie kanë ditur me maturi e mjeshtëri të rrëfejnë se si pikoi një jetë të tërë aroma e djersës, e punës, e profesionalizmit dhe përkushtimit të mësuesit Ismail Erebara. Ai punoi vetëm mësues në disa shkolla të mesme dhe në 8-vjeçare të qytetit të Peshkopisë e gjetkë, por ka lënë mbresa të pashlyera dhe ka krijuar një profil të admirueshëm: atë të modelit më të mirë për gjeneratat e mësuesve që ka përgatitur.

Mësuesi ynë, Ismail Erebara, me punën e tij, me përkushtimin e jashtëzakonshëm, me veprën e tij sa shkencore aq edhe humane është thirrur dhe ka epitetin e nderuar "profesor" nga e gjithë Peshkopia, nga e gjithë Dibra, nga ish-nxënësit e tij, nga kolegët dhe nga prindërit që u ka mësuar fëmijët. Jo vetëm në Dibër, por emri i tij ka një jehonë nderimi të gjerë, edhe në rrethet: Matit, Kukësit e Mirditës nga ish-nxënësit e tij pedagogjikas.

Në libër kemi të rrëfyer jetën e punën e një mësuesi e drejtuesi të thjeshtë që bëri emër të madh, të nderuar e të respektuar duke u imponuar si model i Mësuesit me shkronjë të madhe.

Ismail Erebara mbart një përvojë afro 50-vjeçare të punës me nxënësit, mësuesit dhe prindërit. Ai ka punuar si mësues matematike dhe drejtues shkolle e konvikti. Si profesionist është një nga mësuesit më të vjetër të matematikës në Dibër, mandej dhe në republikë. Qe dhe mbetet një nga mësuesit e aftë, mjeshtër i mësimdhënies dhe rrezatues për të gjithë ata që mësoi. Ai ka qenë mësuesi i mësuesve nga viti 1955 e derisa doli në pension. Edhe me figurën e tij ka rrezatuar modelin më të mirë: i pastër, i veshur si më mirë, i hekurosur, i lustruar, i kujdesshëm mbetet pasqyrimi tipik i mësuesit. Në punë: i përkushtuar dhe me një disiplinë të rreptë shkencore dhe metodike, i matur e korrekt, i dashur dhe kurdoherë i gatshëm për të dhënë ndihmën e tij të pakursyer gjatë gjithë veprimtarisë së tij në arsimimin dhe edukimin e brezit të ri.

Në këtë monografi për Ismail Erebarën autorët Faik Xhani e Hatixhe Erebara kanë përvijuar me kujdes jo vetëm thjesht punën si mësues matematike, por e kanë dhënë në thellësi si figurë komplekse: si intelektual me vlera, si mësues e drejtues i zot shkolle e konvikti, si një patriot i vërtetë , si veprimtar shoqëror, si qytetar i civilizuar, mik e shok i rrallë, si bashkëshort e prind shembullor.

Autorët në monografi me shumë vërtetësi kanë treguar se njerëz të mëdhenj, si mësues Ismaili, dinë dhe punojnë për t'ia rritur e ndritur emrin e mirë familjeve të tyre, siçjanë në rastin tonë familjet Erebara në Dibër të Madhe. Dhe mësuesi Ismail Erebara ka meritën që, pa poza dhe pa rrahur kraharorin, e tregoi veten në çdo hap të jetës së tij. Diti dhe zgjodhi me vetëdije rrugën e nderit të një patrioti të devotshëm dhe gjatë gjithë jetës mori vendime të drejta, të cilat e stërmunduan, por ia rritën emrin, prestigjin dhe kredibilitetin si intelektual dhe si qytetar. Në këta zgjedhje e vendime mësuesi Ismail Erebara, anoi nga vendlindja, nga Shqipëria, nga rruga e duhur, nga obligimi dhe përkushtimi atdhetar. Ismail Erebara u ndesh me të vështirën, por shpalosi shpresën, nismën dhe vullnetin e çeliktë për të bërë më të mirën në dobi të interesave të larta të atdheut dhe progresit të shoqërisë shqiptare.

Monografia ka një strukturë të studjuar ku zënë vend jo vetëm kujtimet, dokumentet, rrëfimet e përshkrimet, por dhe tekstet argumentuese e komentet me përshkrime të të tri llojeve: informues, bindës dhe shprehës. Na duken serioze analizat e ngjarjeve e veprimeve të subjektit të monografisë nga ana e autorëve si dhe një metodë tërheqëse në nivelin letrar pa rënë "pre" e superlativave. Autorët kanë bërë një punë të mirë në përzgjedhjen e përshtatshme të citimeve, në çdo nënlinjë të monografisë, duke hapur secilën me një thënie që në fakt përbën thelbin e asaj pjese.

Në pjesën me titull "DIBRA E MADHE, VENDLINDIA E EREBARAJVE" kemi thënien: "Ta duam atdheun, jo se është i madh, por se është vendi ynë…" të Senekës.

Në kujtimet e një ish-nxënësi të këtij mësuesi të mirë nën titullin "Mirënjohje dhe respekt profesor Ismail Erebarës", autorët kanë zgjedhur këtë sentence, që është mjaft sinjifikative të Albert Kamysë: " Pa ju, o mësues, pa këtë dorë të ngrohtë, që ju na keni shtrirë ne fëmijëve të varfër, ndër të cilët isha dhe unë, pa mësimin dhe shembullin tuaj, asgjë nuk do të kisha arritur…"

Në monografi kanë dalë me mjeshtëri tiparet e karakterit si dhe zotësia e mirësia e mësuesit Erebara si: Përkushtimi, përgatitja e lartë shkencore dhe metodike, metodat shkencore aplifikative dhe rezultative, puna e diferencuar që bënte me nxnësit që kishin dobësi etj. Ata i aktivizonte në çdo orë e në çdo etapë, duke iu ndodhur pranë me syrin e tij vigjilent: ndreqte, korrigjonte, jepte këshilla e sugjerime ashtu, si pa u ndjerë, pa dëshpëruar askënd, përkundrazi, duke i dhënë "krahë" për të ecur me shokët më të përparuar. Për ne, si adoleshentë në atë kohë, na dukej disi e çuditshme kjo veprimtari kaq e madhe, por më vonë kuptuam dhe morëm vesh shumë mirë: kjo e kishte emrin fisnikëri që e mbushte plot shpirtin e tij të madh dhe që e gjente kënaqësinë te gëzimi i të dhënit për të tjerët dhe që quhet humanizëm. Megjithëse bënte një volum të madh pune, profesor Ismaili nuk lodhej kurrë: përherë dinamik, por dhe shumë i thjeshtë duke mbetur modest sikur nuk kishte bërë më tepër se çdo mësues tjetër. Një modesti për t'u admiruar në atë mirënjohje që fitonte shumë në shpirtrat tanë.

> ***Ismail Erebara ishte modeli i të mësuesit korrekt. Në libër del mendimi se i gjithë aktiviteti mësimor, qoftë si mësues, qoftë si drejtor, ka pasur në vazhdimësi një bosht të fortë: të qënit korrekt.***

Ismail Erebara ishte modeli i të mësuesit korrekt. Në libër del mendimi se i gjithë aktiviteti mësimor, qoftë si mësues, qoftë si drejtor, ka pasur në vazhdimësi një bosht të fortë: të qënit korrekt. Korrektësia e mësuesit, drejtësia në gjykimet, vlerësimet dhe në tërë punën arsimore është gjëja e parë që adhurohet së shumti nga nxënësit. Ata janë shumë të ndjeshëm te momenti i vlerësimit me notë. Mësues i mirë është ai që vlerëson dhe komenton saktë notën që vë. Edhe diferencimi sado i vogël, te nxënësit, lë shije të keqe dhe zakonisht i "ftoh" me lëndën e matematikës që dihet ka vështirësi të mëdha në përvetësim.

Mbajtja me hatër, vlerësimi me opinion, mosdëgjimi i vëmendshëm , nuk tolerohet në opinionin e shëndoshë të fëmijëve, sepse janë ata që e njohin mirë njëri-tjetrin. Me pak fjalë: Vlerësimi jo i saktë, e zhvlerëson jo pak dhe mësuesin më të mirë. Ndërsa mësues Ismaili fitoi, me atë korrektësinë karakteristike që ishte, drejtësinë për secilin, pa asnjë dallim. Ka pasur dhe pasoja në disa raste, sepse ka kundërshtuar drejtuesit e kohës që kërkonin nota të larta për të tyret. Kjo nuk u ka ecur te mësues Ismaili dhe nuk e kanë cënuar fare figurën e tij të pastër, pavarësisht nga nofkat që i kanë vënë. Për profesorin të gjithë fëmijët ishin të barabartë dhe secili merrte vlerësimin e merituar.

Është i goditur dhe dhe me vend një vlerësim i ish-nxënësit të tij, z. Dëfrim Methasani: "Ismail Erebara ishte drejtuesi korrekt dhe serioz, që nuk shkilte mbi veten dhe nuk e ndërtonte punën e tij mbi gabimet e të tjerëve. Falë kësaj mënyre të punuari, ai fitonte autoritetin e duhur,që e ruan edhe sot, kur vitet kanë bërë punën e tyre dhe tashmë nuk ka asnjë "gradë" apo detyrë, por e sheh nga afër, që ish-nxënësit apo kolegët e tij, e respektojnë si një vlerë, që mbetet në kujtesën e të gjithëve." Dhe më tej kemi një pasazh që është një tregues në vazhdim të cilësisve të tij si drejtues në shkollën 8-vjeçare "Demir Gashi" Peshkopi me 1400 nxënës dhe 44 mësues. Ajo patë bërë emër jo vetëm brënda Dibrës, por edhe në Shqipëri, kur drejtonte Ismail Erebara. Ndonëse nuk qe e lehtë të punoje e të drejtoje në atë mori nxënësish e shumicë mësuesish, Ismail Erebara tërë periudhën që punoi, drejtoi me kompetencë dhe dinjitet.

Një vend të mirë zënë në libër konsideratat e shumë njerëzve për mësuesin Ismail Erebara, si : "Shok i vërtetë dhe këshilltar me shumë vlera, që me shembullin e tij të bënte të mos gabosh kurrë, të ruaje dinjitetin e vlerën e profesionit." "Mësues dhe drejtues i mirë me moral të pastër si qelibari. Kurrë nuk u përfol për afera e veprime të padenja për një edukator."

" Kishte gjykim të thellë dhe vlerësonte mirë e drejt kontributet e gjithë secilit nxënës, apo koleg. Te ai të binte në sy trupi i pastër e i rregullt, veshja elegante dhe mirësjellja. Ismaili ishte tip inteligjent, i shkathët, i dashur me shokët, këmbëngulës dhe me autoritet të padiskutueshëm. Atë që thonte, e bënte patjetër",- shprehet me krenari një nga shokët e ngushtë e më të vjetër, mësuesi i merituar Esat Caka.

Cilido që e ka njohur apo punuar me mësuesin veteran Ismail Erebarën, një përfundim e ka nxjerrë: "Ai ishte mësues me pasion dhe vullnet çeliku, një koleg për t'u admiruar".

Faik Xhani - Hatixhe Erebara
I PERKUSHTUARI
Monografi
Botimet M&B
ISBN: 978-99956-04-89-9
Çmimi: 500 lekë

Mësuesi i nderuar Ismail Erebara ushqeu dashuri të rrallë për profesionin dhe i është përgjigjur në mënyrën më të mençur rolit dhe kontributit që ka një mësues me rastin e takimit të sivjetshëm për 7 Marsin me kolegë e ish- nxënës: "Të jesh mësues është një profesion fisnik dhe, në vitet e gjata të punës rutinë, edhe bëhesh ziliqar për profesionistët e tjerë, të cilët i "korrin" sukseset menjëherë: Kirurgu bëhet i famshëm pas operacioneve të para të suksesshme, inxhinieri e sheh veten të nderuar me veprat që ngrihen para syve të publikut, agronomi i sheh frytet e punës së tij në parcela të bëra det me një farë të re duke fituar admirim e mirënjohje si dhe shumë të tjerë. Por sot, të dashur ish- nxënës e kolegët e mi, ju kumtoj se e kam pasur gabim. Në fund, pas dekada pune si mësues, ne "korrim" plotësisht dhe me shprehjen e pamjen më të ndriçuar frytin e Profesionit tonë si edukatorë: "Nderimin, respektin e thellë dhe vlerësimin e merituar të vepres sonë të jetës, që është dhe mbetet si kurorë plot dritë e bukuri në shpirtrat njerëzorë!..."

Nuk ka gëzim më të madh, kur mësuesit e nderuar kanë dhe fëmijë të mrekullueshëm, që u bëjnë nder e i lartojnë dhe i kënaqin zemrat e tyre. Unë, si lexues jam prekur shumë kur lexova ato pak rreshta që pa dijeninë e mësuesit tonë, pa lejen e tij, bashkautori i monografisë, zoti Faik Xhani, i ka botuar në libër. Ja se si shprehen fëmijët e profesorit:

"I dashur babi,

Kjo ditë që agoi, është dita më e bardhë për ne, fëmijët e tu. Ajo është dita, kur ju mbeteni përjetë i gjallë në një monografi të shkruar. Nuk bëhet fjalë për ne fëmijët tuaj, që lumturisht patëm fatin të kishim dy prindër të mrekullueshëm, se të dashur e të shtrenjtë janë të gjithë prindërit, por ne sikur na përkëdheli më shumë fati, pasi që të dy, ti dhe mami jeni bërë mësues. Jo mësues dosido, por mësues që latë emër në edukimin e brezit të ri… Në veçanti ti, babi, punove jopak për të përgatitur mësues, të cilët janë me qindra anembanë Republikës që ia ndritën dhe ia ndrisin emrin dhe lavdinë arsimit shqiptar…

Pa qenë nevoja të bëjmë apelativa të gjithë ne, kolegë e ish-nxënës, shokë e miq, familjarë të tij e dashamirës të të nderuarit, zoti Ismail Erebara, dua t'i shprehim falenderim të veçantë zotit Faik Xhanit për iniciativën e tij për të shkruar këtë monografi dhe për nivelin e lartë të librit. I urojmë atij sa më shumë suksese në fushën e botimeve!

Edhe letërsia e tij është e tillë. E thjeshtë dhe e çiltër. E mençur dhe fjalëkursyer. E mbushur me dashuri. E mbushur me dhimbje. Duke luajtur në fushën më të rrezikshme për suksesin, siç është jeta e përditshme pa maja, aq komode për të rënë në sy, Faiku tregon se është shkrimtar i kualiteteve të larta. Ai është një shembull nga më domethënësit se nuk mund të zëvendësohet magjia e artit nga manipuluesit e fjalës.

Faik Ballanca, njeri e shkrimtar

Nga VATH KORESHI

Jo rrallë më ndodh që, duke lexuar tregime të Faik Ballancës, më vjen në vesh zëri i tij gjtihmonë i shtruar dhe i mbushur me magjinë e zemrës dhe mendjes së tij aq të mprehtë. Faiku ngjallet sa herë, sepse gjithmonë ne kemi nevojë të na plotësojë me diçka që na mungon. Kur jemi të padrejtë, ai na ofron ndershmërinë e tij, kur na tut jeta, ai na bën më të guximshëm. Ai di të na shtyjë gjithmonë që të bëhemi më shumë njerëz, më shumë shokë dhe më shumë të mençur.

Gjithë artin e tij ky njeri me zemër vezullimtare e vuri në funksion të fisnikërimit të njriut; të tregojë se ç'rrezatim të fuqishëm ka një shpirt që do, që dhemb dhe që nuk e pranon meskinitetin. Ai ishte kundër cinizmit dhe prepotencës së më të fortit ndaj më të dobëtit; ai ishte një i afërt i jashtëzakonshëm i njeriut me halle.

Kur kam lexuar tregimin e tij "Njerka", kam pasur një bashkëshoqërim aq të afërt të fytyrës së tij me atë të Migjenit. Kjo vinte jo thjesht nga një ngjashmëri edhe jo shumë e largët e tipareve të tyre me një si lëngim të përhershëm, por sidomos me një dhimbje fine që nuk e fyen dhe nuk nënçmon njeriun, por e bën atë dhe më njerëzor tek shfaqet në hallet e përditshme. Të mbetet një dhimbje kur vë re se Faiku nuk e ka kapur penën që të mallkojë një njerkë, por që t'i qajë hallin asaj për sakatllëkun që i ka dhënë natyra.

Janë shumë e shumë tregime të Faikut që përshkruajnë njerka të tilla, nëna, motra, burra të heshtur e si të mënjanuar, në përgjithësi njerëz që mezi bien në sy në kopshtet dhe në shtëpitë e tyre përdhese, në rrugicat e ngushta dhe në një jetë pa zhurmë e pa bujë. Në këtë peizazh bojë hiri për një sy të zakonshëm, Faiku zbulon një botë që të trondi me njerëzillëkun e saj, vajza që përmes një dashurie të turbullt e të paqartë krehin flokët para pasqyrave dhe gatiten për të dalë në jetë dramatikisht të zakonshme, por aq të zbukuruara në përfytyrimin e tyre. Sepse Faiku ishte një shkrimtar që donte aq shumë. Ai donte ta mbillte trevën letrare me "Njerka" dhe "Kaleidoskopi", me "Mbama pak pallton çun" dhe "Mbasdite të lagura" në vend të skemave dhe stereotipeve të mërzitshme. Ai ishte një shkrimtar që nuk u tundua asnjëherë nga apelet propagandistike të ditës, nga manierat dhe modat, aq të parapëlqyera nga mesatarët.

Sigurisht një shkrimtar i përmasave të tilla të shtyn të flasësh për shumë e shumë gjëra. Unë kisha për të bërë këtu një zbërthim të disa vlerave artistike të tregimeve të Faikut, po më rrëmben ideja se këto cilësi të shkrimtarit si talent, rrjedhin nga shumë cilësi të shkrimtarit si njeri.

Unë e kam dashur gjithmonë Faikun njeri, i cili e ka lënë veten në qindra faqe të shkruara me një talent të rrallë. Ai është në të gjithë rastet djaloshi shtatpakët që ecën me një çap të shpejtë dhe lëkundje të rregullt të shpatullave, bashkëbiseduesi me një zë pak si nëpër grykë dhe pak si nëpër hundë, i vëmendshëm dhe i durueshëm deri në vetëmohim, vështrimçiltëri me sy të gjelbër dhe me dritë të butë, i paepuri dhe vullnethekuri, karakteri i fortë dhe udhëpalëshuari para çdo padrejtësie.

Edhe letërsia e tij është e tillë. E thjeshtë dhe e çiltër. E mençur dhe fjalëkursyer. E mbushur me dashuri. E mbushur me dhimbje. Duke luajtur në fushën më të rrezikshme për suksesin, siç është jeta e përditshme pa maja, aq komode për të rënë në sy, Faiku tregon se është shkrimtar i kualiteteve të larta. Ai është një shembull nga më domethënësit se nuk mund të zëvendësohet magjia e artit nga manipuluesit e fjalës.

(Nga libri "Mbama pak pallton çun" –Toena, 2003)

FAIK BALLANCA (1945-1977)

Lindi dhe vdiq në Tiranë në një familje intelektuale të ardhur nga Dibra e Madhe. Pasi kreu gjimnazin dhe mbaroi Fakultetin Histori-Filologji (dega e gazetarisë), punoi gazetar e redaktor në gazetën "Zëri i Rinisë"dhe në revistën letrare "Nëntori" të LSHASH-së.

Që nga viti 1962 nisi të botonte tregimet e para dhe të përkthente e të botonte prozë nga gjermanishtja, italishtja e frëngjishtja. Edhe pse e ndërpreu krijimtarinë letrare në moshë të re, F. Ballanca arriti të krijonte individualitetin e veçantë si shkrimtar i vërtetë i mirënjohur, në sajë të kulturës së gjerë, intuitës së hollë artistike dhe skrupulozitetit krijues.

Vepra të botuara:

- Rrëmbimi - tregime (1970)
- Mbasdite të lagura - tregime (1971)
- Katër orë larg shtëpisë - novelë (1972)
- Shtigje me helm – novelë (1972)
- I fundit – novelë (1972)
- Letra anonime - tregime e novelë (1973
- Pritësit e rrufeve – tregime e novelë (1975)
- Tregime të zgjedhura (1976)
- Perëndia e shtëpisë - tregime e novelë (1985)
- Nomeja e largët - roman (1989)
- Kënga e fundit e Marko Boçarit – novelë (2002)
- Mbama pak pallton çun – tregime të zgjedhura (2003)
- Kënga e fundit e Marko Boçarit dhe tregime të tjera – (2008)

Fragment novele nga Faik Ballanca

Kënga e fundit e Marko Boçarit

Ndoqëm po atë taktikë. Natën marshonim, ndërsa ditën flinim guvave dhe pyjeve, pasi kishim vendosur roje të forta përreth. Një mëngjes një nga rojet tha se kishte dëgjuar zhurmë këmbësh. Ai thirri, po zhurmat u larguan me ngut, si diçka që rrëshqet mbi gjethet e kalbura, të mbetura nga vjeshta e vitit të shkuar. Markoja u vrenjt. Armiku mund të na kishte zbuluar dhe atëherë do të ishte tepër e vështirë për t'ia arritur qëllimit. Dërguam një patrullë zbulimi me Zervën, Pilon dhe Thanas Tuzën. Ata u kthyen pas dy orësh dhe nuk zbuluan dot asgjë, veç disa gjurmëve të dyshimta që mund të ishin edhe gjurmët e kafshëve të egra të pyllit. Të gjithë u qetësuam, veç Markos.

Mbrëmja ra mbi pyll si një rrobë e ngrohtë, e leshtë. U bëmë gati për marshim. Markoja na tha se, po të mos na diktonin atë natë, do të kapërcenim rreshtat e fundit të rrethuesve dhe mund t'í godisnim përpara se të largoheshim më tej. Ecnim në të errët dhe mezi shquanim siluetën e shokut që ndodhej përpara. Siç ndodh zakonisht në marshime, na dukej sikur ishim në Sul, nëpër shtëpitë tona, nëpër shkëmbinjtë e njohur. Toka e butë zhytej nën nallçat e shojeve. Doli hëna si një top i hedhur në male. Hijet u stërgjatën. Retë u shkriftuan në qiell si stereja e Mesolongjit kur deti tërhiqet në zbaticë. Bunacë. Befas, andej nga lindja shkrepëtiu. Ajri ishte i ngrohtë dhe vakësia dukej sikur mbetej me drurë e varej me përtaci përdhe. Pritëm të binte shi, po nuk ra. Në lindje përsëriteshin shkrepëtimat, ndërsa mbi ne ndriçonte një hënë e bardhë. Diku u ndalëm. Shoku që kisha përpara bëri me shenjë që të heshtja. Eca pa zhurmë në majë të gishtave. Udha ishte e zënë. Përpara nesh kishte dy-tri çadra dhe një mori ushtarësh që flinin si të vdekur. Ishin shtrirë përdhe pranë e pranë dhe s'kishin asgjë në trup, veç rrobës së leshtë dhe armëve që u shkëlqenin. Hëna u ndriçonte fytyrat dhe shamitë e bardha, të mbështjella si qefinë rreth kokës. Midis drurëve kishte kuna të varura dhe, me sa duket, njëri nga ata që flinin atje foli nëpër gjumë. Kuna u lëkund dhe ne kujtuam se foli dikush nga ne.

"Ç'është ai kapedan i marrë që i ka shtrirë këtu në mes të udhës", thashë me vete.

- Kush foli? – pyeti Markoja nën zë.

Pamë njëri-tjetrin, po nuk e gjetëm dot. Zerva eci përpara. U përkul mbi një kunë. Nxori thikën dhe

vrau dikë. Pastaj vajtën të tjerë. M'u duk sikur e ndjeva erën e gjakut dhe s'di sepse ngrita kokën, po s'pashë as yje e as hënë, sikur qielli të ishte verbuar. Bari i shtypur dridhej nën erën e vakët dehëse. U lëkund një pemë aty pranë dhe ranë gjethet. Befas dikush thirri me një zë të çjerrë, që u pasua nga zëra të tjerë.

- Na vranë toskët! Na therën!

Ishin disa zëra njëherësh, që vinin njëri pas tjetrit. Ata që flinin u zgjuan, u ngritën nga dheu, kërcyen nga kunat dhe zhveshën armët, akoma të trullosur nga gjumi. Pylli shkëlqeu.

Na kishte futur Zerva në atë shteg. Ai kishte qenë pararojë. I kishte gjetur të gjithë të përgjumur dhe nga shamitë e bardha si turbanë, kishte pandehur se ishin turq.

Ne shkuam pas Zervës.

- Na vranë toskët!

U mblodhëm menjëherë rreth Markos dhe për herë të parë e pamë të hutuar. Nakla ia priste krahët. Na udhëhoqi në një anë të pyllit, po përsëri na dolën çadra përpara dhe dikush ulëriti po ato fjalë: "Na vranë toskët!" Pas nesh u dëgjuan zëra të tjerë, që nuk ishin zërat e shokëve tanë:

- O burra, toskë, pini gjak gegë!

- Tradhti!

Ishim të rrethuar. Dikush na nxiste njëri kundër tjetrit. Zërat vinin nga vende të ndryshme. Nisi beteja dhe askush nuk po e merrte vesh se si ndodhi. Ngatërroheshim midis drurëve, na bëhej sikur na godisnin hije, sikur na ngjiteshin kulpra nëpër këmbë. Omer Vrioni e kishte ngritur me kujdes kurthin dhe njerëzit e tij thërrisnin po ato fjalë nga majat e pemëve. Këtë e mësuam më vonë.

Markoja u sul me rrëmbim përpara. Rendëm pas tij dhe u përpoqëm të mos e humbnim sysh në atë zallahi.

- Ku janë pashallarët? – thërriste ai. – Ku janë pashallarët?

Shtatë bejlerë mbetën të vrarë nën këmbët tona. Nën nallçat e shojeve mbinin vurrata e gjaku nuk mpiksej, po rridhte i valë në atë pyll të vakët. Markoja çau një çadër me thikë. E mbërtheu në sytë tanë Ago Vasjarin, e tërhoqi për mjekre dhe kur e ngjokën, ia nguli thikën në fyt, duke i thënë:

- Plaku i Litharicës është ngjallur vurrkollak. Aliu të kërkon hakun.

Agoja u rrëzua në këmbët e tij. Markoja mori frymë e lëshoi krahët. Tamam atëherë një negër, që ishte shtrirë përdhe, e qëlloi dhe e plagosi në ije. Ne hapëm zjarr mbi të dhe e lamë të vdekur, ashtu siç qe i shtrirë. Iu afruam stratarkut, po ai na mbajti larg. E lidhi vetë plagën.

- Bjeruni trompetave! – urdhëroi pas pak. – Bjeruni trompetave që të ushtojë pylli. Unë nuk kthehem më pas. Do ta gjej të gjallë Omer Vrionin në këtë pyll, ashtu siç gjeta Agon.

Trompetat tona zunë të binin dhe tingujt rendën nëpër pyll si ca gurë që përplasen. U mblodhëm të gjithë aty. Përtej drurëve u dukën mirditorët me Lleshin e Zi në krye, vëllain e kapidanit të Oroshit. Zhurma e trompetave u tërhoqi vëmendjen mbi ne.

- Na vranë toskët! – klithi dikush mbi pemë.

Hapën zjarr dhe pylli u ndriçua sikur të kishte shkrepëtirë. Markoja u rrëzua. Në çast plasi një përleshje e përgjakshme dhe në atë gjurulldi se kush mundohej të merrte trupin e tij. U ndeshëm gjoks më gjoks. Më në fun Thanas Tuza e hodhi Markon në kurriz. Ne e vumë në mes dhe u tërhoqëm duke shkelur mbi të vrarë.

Njerëzit e Omer Vrionit thërrisnin mbi kokat tona:

- Na therën toskët!

- Suluni, o gegë, pini gjak toske!

- Suluni, o toskë, pini gjak gege!

Gjuha jonë deformohej nga klithmat e tyre dhe ata përsërisnin po ato fjalë, si kukumjaçkat që njohin vetëm një klithmë. Ishin turq apo çekrezë?

→

botime

→ ***

Herë-herë dëgjonim nga një krismë nga pas, por tani nuk na bënte asgjë përshtypje. Rreshtat e turqve i çamë më lehtë dhe dolëm nga rreziku. Premë dru e shkurre përreth, bëmë një vig të fortë e shtruam një rrobë të leshtë. E ulëm ngadalë Markon. I vendosëm armët, kitarën, trompetën dhe një flamur turk pranë këmbëve. Thanas Tuza mezi e lëshoi. Markoja ishte i verdhë. Herë-herë rënkonte në jerm. Ashtu duke ecur, unë hidhja sytë nga ai dhe hapat e mia më dukeshin si hapat e valles së grave të Sulit, që ishin hedhur me këngë në greminë.

Kostandin Boçari doli në krye të rreshtit dhe përsëriste herë pas here:

- Unë jam i vëllai dhe nuk qaj. Asnjë të mos qajë.

Dielli na gjeti në rrugë. Markoja zuri të lëvizte qepallat. Buzët dhe vetullat i dridheshin dhe mua më dukej sikur thoshte diçka, që nuk e dëgjonte dot askush nga ne.

***

"Armët i kam pranë, po s'luftoj dot. Kitarën e kam pranë, po s'këndoj dot. Po vdes... Këmba ime nuk do të shkelë më kurrë mbi shkrepat e Sulit. Meteorët e përgjakur s'patën vend për këtë lëng të sertë që më rrjedh nga plagët dhe që është jeta ime. Se gjaku i kombit tim është shprishur e rrjedh nëpër Europë, kudo që ngre krye liria. Ne jemi gladiatorë që e shpërthyem arenën.

Karpenisi! Mbi kokën time djeg dielli i huaj i Eladës. I verdhë si limon ky qiell. Mbi buzën time po rreshken kripërat e fundit. S'kam një bulë ujë dhe zemra po më çahet nga malli. Nuk mundem të këndoj. Fytyra e Krizesë dhe e tim biri buzëqeshin përtej pyllit të gjelbër me ullinj. Ku jeni? Era gënjeshtare lot me mua dhe shpërndan mall e këngë të vjetra lufte, si atëherë kur ndodheshim tek Pesë Puset, në Qafë, apo në kështjellën e shën Venerandës.

Ku vemi? Ky vig që lëkundet më kujton djepin e nënës që më merrte gjithmonë në shpinë. Me djepin tim e të Kostandinit ime më u çonte barut luftëtarëve. Nga gjumi më zgjoi një krismë dhe një krismë po më vë në gjumë. Më ngadalë, ju shokë që më mbartni! S'më shpini dot në Seleidë. Eshtrat e mia do t'i presë një tokë tjetër. Po vij, Mesolongj. Është mesditë. Stërkat e dallgëve vrapojnë mbi krahët e baticës dhe rrethojnë tërë brigjet e tua me shkumë të bardhë, që mërmërit se unë po vdes. Vërtet po vdes, po mos mbani zi. Se unë nuk jam më trimi i kombit tim. Në atë arenë të vogël të huajt kanë ngjallur përçarjen e llahtarshme: vëllavrasjen. Vetëm kjo na ka prishur. Unë jam një gladiator që e gjeta rastësisht derën hapur. Dhe u përpoqa që të mbroj këtu lirinë që gëzoja në malet e mia, në sajë të armëve që kam në trup. Gjaku im vritet akoma. Kush e di për sa kohë? Kush e di se kur liria do të trokasë mbi atë dhe të zhuritur pëllëmbë e gjak, siç po troket tani në Eladë. Shpejt. Shumë shpejt.

... Më dhemb diçka. Diçka s'e kreva...

Po mbërrijmë. Hapuni porta, paçka se qepallat e mia po mbyllen dhe shokët nuk i shquaj dot! Më varrosni pranë fortifikatës "Gjergj Kastrioti", që hija e tij të më qetësojë...

Përgatiti: **PANDELI KOÇI**

"Rruga e përgjakur", libri surprizë i Bajram Stojkut

Më datën 8 dhjetor në sallën e Shtëpisë Qendrore të Ushtrisë, dibranët i mblodhi dhe i bëri bashkë, autori më i ri, pensionisti Bajram Stojku.Salla ishte mbushur si rrallë herë tjetër sa njerëzit u detyruan të qëndrojnë në këmbë.Bajram Stojku, një ndër figurat më të spikatura në Dibër, duke punuar në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, tashmë në pension ja tek del para lexuesve me një libër monografik:"Rrugë e përgjakur" kushtuar dëshmorit Alush Stojku. Si gjithmonë në evinemente të tilla dibrane, do të jetë gazetari Defrim Methasani, ai që do të drejojë këtë promovim libri, këtë aktivitet të bukur, këtë dasëm pa nuse siç u shpreh dhe vetë Defrimi. Në fillim për të pranishmit një valle e bukur nga të rinjtë e të rejat e ansamblit "Shqiponja" të cilët të veshur bukur me kostume kombëtare, nën ritmin e valleve popullore i dhanë një tjetër larmi aktivitetit.Mbi vlerat e librit foli i pari Elmaz Lala i cili e vlerësoi librin jo thjeshtë si një monografi personi, si një monografi fisi por dhe më shumë.Në faqet e këtij libri janë të gjithë bashkë, të gjithë dibranët, të gjitha fiset e qytetit të Peshkopisë-tha në fjalën e tij Elmaz Lala. Në diskutimin e tij gazetari veteran Velo Cfarku u ndal dhe në ato vite ku kishte punuar me autorin e librit, shtjelloi dhe kujtimet e bukura që ende ruante vetë. Edhe Shuaip Methasani shprehu në diskutimin e tij vlerat e mëdha të fisit Stojku , një fis ky i vjetër, por dhe me një shpërndarje të madhe ane mbanë vendit.Beqir Shehu e nisi diskutimin e tij duke thënë: " Gjithmonë Bajram Stojku ka qenë njeri i surprizave.Ky libër që ne sapo muarëm në duar është një surprizë për ne.Të tjera surpriza do të presim nga Bajrami. Këngëtari i talentuar dibranë Qerim Sula këndoi këngën kushtuar Alush Stojkut, me tekst të Naim Plakut e muzikë të Përparim Tomçinit. Në fund përshëndeti vetë autori i librit Bajram Stojku.-Sot më fallen emocionet, sot ndjehem dyfish më i ri, sot ndjehem dyfish më i lumtur dhe këto të gjitha i kam nga ju pjesëmarrës në këtë sallë, i kam nga ju miq e shokë që keni ardhur nga ana e anës për të më respektuar mua, i kam nga fisi im i madh Stojku që kanë ardhur jo vetëm nga Peshkopia ime por dhe nga Kosova, Shkupi e Fieri, kudo ku ndodhen rrënjët e fisit Stojku.Ndaj unë ju jam mirënjohës të gjithëve që sot në këtë moshë që kam më sollët kaq shumë emocione dhe mbresa të bukura që nuk do shlyhen lehta nga kujtesa ime.Në fund përsëri fëmijët e mbyllin me një valle. Të pranishmit dalin nga salla me nga një libër në duar dhuratë nga vetë autori, por për Bajram Stojkun kjo mbeti dita ma e rëndësishme në jetën e tij.



Shaqir Skarra

Alush Stojku derdhi gjak të pastër shqiptari për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut

Nga **NAIM PLAKU**

Aty ku fillon bulevardi i qytetit të Peshkopisë, është një rrugë që të ngjet për në Kamen. Një rrugë që pak a shumë i ruan edhe sot konturet e saj të vjetra, të atyre rrugicave të ngushta që kishte dikur qyteti i vjetër i Peshkopisë. Ajo mban emrin e një patrioti të shquar, i cili lindi këtu, në njerën prej këtyre shtëpive të gurta, në njerën prej këtyre vatrave të ngrohta e bujare. Këtu, ja këndej ai bëri dhe historinë e tij, këtu dhe u vra duke luftuar për liri, për të drejta qytetare, për nder e dinjitet kombëtar, duke e mbyllur jetën e tij, ashtu siç do të dëshironte çdo njeri, me nder e lavdi.

Kjo rrugë e thjeshtë mban emrin e Alush Stojkut. Kaq. Prapa këtij emri, mbi gurët e kësaj rruge, në themelet e këtyre mureve, kumbon një histori e tërë njerëzore. Për të flasin kalldrëmet e gurta, shpaloset qëndresa heroike, gurgullojnë bëmat e mëdha të kohës, vjen jehona e fuqishme e këngës...

- Hej, a ka më? Kaq e shkurtër paska qenë kjo rrugë?!

Vërtet është rrugë e shkurtër, por që të ndërtohej kjo rrugë, u desh një jetë. Jo, jo një jetë, por dekada të tëra, shekuj të tërë. Dhe gurët akoma mbajnë pika gjaku, dhe qielli mban erë baroti, dhe çatitë e shtëpive kanë brenda prushin e betejave. Ja, këtu lindi, u rrit e u burrërua Alush Stojku. Dhe këtu e mbylli jetën e tij. Gurët, vërtet, fshehin histori, nën kalldrëm, vërtet, fle heroizmi e trimëria, dheu, vërtet, mban ngjyrë gjaku dhe qielli ndizet me flakët e bukura të lirisë, por para tyre qëndron tyli i përgjumur i kohës, velloja e harresës. Lum kush i gris e futet brenda kështjellës së të vërtetës së madhe! Lum kush zbulon fytyrën e ndritur e të bukur të lirisë! Lum kush i këndon këngët e saj!

Këtë është munduar ta bëjë dhe Bajram Stojku me këtë botimin modest që i paraqet lexuesit: të ndezë një dritë për ta parë më mirë këtë rrugë, të gërmojë pakëz në dheun e përgjakur, të kullojë, me sa mundet, ujërat e atyre rrëkezave që zbresin në ditë shirash e bubullimash, të miklojë ninullat e nënave, t'u ndezë flakët e mallit brezave e të frymëzojë rininë e këtyre trojeve me dritën e të vërtetës duke u thënë me plot modesti:

- Shikoni, edhe këtu ka burrëri! Dëgjoni, ecni kësaj rruge, por mos shkelni mbi pikat e gjakut! Mbahuni fort në parmakët e këtij çardaku që akoma vazhdon të tundet e të lëkundet nga rrebeshet e historisë! Vështroni si ngrihen përmendoret mbi shpatullat e trimërisë!

Ai thotë se nuk e ka pasur të vështirë ta shkruajë këtë histori, sepse në prehërin e saj ka lindur dhe me atë është rritur. Me të është mëkuar e mësuar. Ajo e ka ndjekur edhe i është ringjalluar sa herëm në ditë të mira e të liga. Ku ka prekur e ka vënë këmbën i ka buçitur zëri i betejave. Ai thotë se për këto ngjarje i është dashur vetëm një laps dhe një fletore sa për t'i mbajtur shënim...Dhe, kur thotë kështu, mbyll sytë dhe humbet në kujtime. i dalin përpara gjithë ata vende, gjithë ato ngjarje, gjithë ata njerëz të dashur, gjithë ato fytyra të praruara, përkëdheljet fëminore, buzëqeshjet, lëvizjet, fjalët, zëri, bisedat, përpëlitjet, të qarat, oshtimat, krismat, bubullimat, shkreptimat, gjithçka. i del përpara kreshnikja e Stojkut, nënë Hamidja me atë mantelin e zi mbi ballë, me atë çehren e saj krenare, me ato duar të rreshkura në brumin e magjes dhe në flakët e betejave, me zërin e saj burrëror e perkedhelës dhe me ato fjalët kallkan me të cilat e niste zakonisht tregimin: "Këto punë, mor bir, kanë vu kore e s'duhen trazue fort..."

- Po korja do hequr me kujdes, moj nënë, që ta mbushë odën aroma e këndshme e bukës së mirë...

Bajrami, vërtet, i di këto ngjarje, se disa prej tyre edhe i ka jetuar, por i duket se e ka lehtë për t'i shkruar, sepse është shkrirë e bërë njësh me ta, i duket se është vetë ai personazhi i bëmave të mëdha, sidomos në këto vitet e pleqërisë, që, nganjëherë, nostalgjia edhe të tradhton, por edhe të frymëzon e të rinon. Megjithatë, këto bëma, që s'janë kaq të lashta, duket se gjëmojnë sa herë që vjen e shkon në rrugën "Alush Stojku". Duket sikur, edhe kur fishkëllen oxhaku në ditë dimri, edhe kur fryn zefiri në ditë vere, edhe kur zbresin rrëketë Përroit të Banjës në ditë vjeshte, edhe kur fryn veriu i Skërtecit apo kur mbushet vendi me gjeth e lule në pranverë, sjellin me vete historitë e viteve të shkuara. Këto e kanë shtyrë t'i rendisë ashtu siç ishin e siç ndodhën.

Por ka dhe diçka tjetër. Diçka që kumbon fort. Bajrami duket se grish dikë, se kërkon diçka, thotë, se bën një thirrje, një lutje:

O të rinj! Ndillni kujtimet që ruani, shpalosni ata sido që të jenë, shkruan në akull apo në gur, siç po bëj unë tani! Hidhni një sy rrugës nga keni ecur e ç'keni bërë! Shikojeni mirë vendin ku keni vënë këmbët dhe mbahuni fort pas të kaluarës e mos harroni lavdinë e të parëve!

Në vazhdën e përpjekjeve për të ndriçuar sadopak figurat historike, për t'u njohur me jetën dhe veprimtarinë e tyre patriotike, sidomos në përvjetorin e lavdishëm të 100-vjetorit të Pavarësisë, ky kontribut që po sjell Bajram Stojku me këtë botim interesant që i kushtohet një figure patriotike po kaq interesante, si e Alush Stojkut, është një vlerë e madhe shoqërore. E kush tjetër më mirë se i biri do të shkruante për të?! Bajrami, me modestinë që trashëgon, thotë se shumë miq, shokë e dashamirës i kishin sugjeruar të shkruante diçka sa s'ishte vonë. Koha ecën revan dhe, kur s'e arrin dot, bëhesh pishman. Ndaj mori guximin ta bënte këtë, t'i shkruante këto kujtime, siç i pa dhe i dëgjoi, duke kryer një detyrim moral ndaj prindërve dhe një shenjë mirënjohjen e respekti për miqtë e shokët e tij të shumtë, për tërë farefisin dhe shoqërinë në përgjthësi. Pra, ishte një punë që duhej mbaruar.

Koha ecën, jeta ndryshon, njerëzit lindin e vdesin në një truall të caktuar, në një perudhë të caktuar ku secili shkruan jetën e tij të re, secili bën historinë e tij. Të tjerë vijnë e ngulen në atë truall, në ato troje dhe disa nuk e dinë e as denjojnë të mësojnë se nën hijen e cilit lis kanë vënë kokën e po prehen, në prehërin e cilës lëndinë po pushojnë, mbajnë vesh nga vijnë këta tinguj magjeps e nga buron kjo valë frymëzimi që i shtyn përditë drejt përjetimeve të reja, të ndryshme, të këndshme apo të pakëndshme, me njerëz të tjerë, në rrethana të tjera. Edhe ata bëjnë historinë e tyre dhe kështu vendosen e zhvendosen brezat tamam si shtresat e tokës që me kalimin e shekujve, për t'i nxjerrë në sipërfaqe, duhet kazma e arkeologut.

Për Alush Stojkun mendoj se nuk duheshin as syze për të gërmuar në arkiva, as dalta për të gdhendur portretet e harruara, as kazëm për të zbuluar rrënojat e kullave. Ai ishte fare pranë. Ishte dhe është kudo në kujtesën e brezave, e sjell çdo pranverë aroma e luleve të malit dhe çdo dimër bora e Korabit. Për të, domosdo, që duhej të ishte shkruar më parë, se i përket atij brezi që "bënë historinë". Me këtë ne kuptojmë se të gjithë ata që luftuan për atdheun, për kombin, për lirinë dhe pavarësinë e vendit; që vunë një gur në themelet e kësaj kështjelle ose për ta lartësuar atë, që derdhën gjakun për ta mbrojtur nga armiqtë dhe djersën për ta lulëzuar atë, duhen vënë në piedestalet e nderit që meritojnë.

Alush Stojku ishte një nga ata që vuri në themelet e kësaj kështjelle një gur të rëndë dhe derdhi një grusht gjak të pastër shqiptari për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut. *(Marrë nga parathënia e librit)*

Shqipëria dhe letërsia shqiptare parë me sytë e fqinjëve jugorë,
Dino Kubatis, Kosta Valetas e Panajota Hristopulu-Zalloni

Tre poetët e shquar grekë që promovojnë letërsinë shqipe në Greqi

Nga **MENTOR HOXHA**
Master Shkencor për "Studime letrare"

Në vitet e fundit letërsia shqipe, në saj tre poetëve të shquar grekë: Dino Kubatis, Kostas Valetas, Panajota Zalloni dhe përkthyesit të talentuar shqiptar Iljaz Bobaj po gjen një pasqyrim të gjerë në mediat më të spikatura letrare greke. Revista letrare "Qeleno" "Kristovullos" dhe gazeta "Rruga e Trevës", me botuese e drejtore poeten e shquar greke Panajota Zalloni si dhe revista "Stohasmos", "Emos" dhe "Eolika Gramata" me botues e drejtor shkrimtarin e njohur Kostas Valetas, zv. president i "Lidhjes Ndërkombëtare të Kritikëve të Letërsisë" dhe zv/president i "Bashkimit të Shkrimtarëve Europianë",po publikojnë për çdo numër cikle me poezi e tregime nga autorët më cilësorë shqiptarë, të përkthyer nga Iljaz Bobaj. Para disa viteve letërsia shqiptare në Greqi përfaqësohej vetëm nga Ismail Kadare, ndërsa sot, falë kontributit të tyre, lexuesi grek është njohur edhe me poetë të tjerë nga Kosova e Shqipëria si Ali Podrimja, Reshat Sahitaj, Agim Vinca, Agim Gjakova, Dritëro Agolli, Sazan Goliku, Visar Zhiti, Spiro Xhavara, Mujo Buçpapaj, Iljaz Bobaj, Moikom Zeqo, Ilirjan Zhupa, Kalosh Çeliku, Mentor Hoxha, Shkëlqim Hajnaj, Novruz Shehu, Spiro Xhavara, Dashnor Selimi, Muharrem Kurti etj. Më 2011 u botua në greqish po nga këta botues vëllimi poetik "Harta e Grisur" e poetit të madh kosovar Ali Podrimja, përkthyer nga Iljaz Bobaj, parathënia nga Dino Kubatis (kryetar i shoqatës "Kafeneja e ideve") dhe botimi nga revista letrare "E Olika Grammata''.Më 20 mars 2011, këtij libri i'u bë në Athinë një promovim madhështor ku morën pjesë mbi 200 shkrimtarë, intelektualë, gazetarë e studentë. Midis tyre, Podrimja, përkthyesi, Bobaj, redaktori e botuesi Valetas, hartuesi i parathënies Kubatis, shkrimtarja e madhe greke Panajota Zalloni, ambasadori i Shqipërisë në Athinë Dashnor Dervishi, kryetari i Lidhjes së Shkrimtarëve të Kosovës dhe zv.president i "Bashkimit të Shkrimtarëve Evropianë'', Reshat Sahitaj, etj. U vlerësuan kumtesat nga Kosta Valetas, Dino Kubatis e Panajota Zalloni. Harta e grisur", është libri i parë i një autori kosovar që i prezantohet lexuesit grek. Për redaktorin e librit në greqisht, Kostas Valetas "Harta e grisur", "është Shqipëria e copëzuar, është një komb i madh të cilin imperializmi dhe forca e kanë ndarë dhe copëtuar, por që së shpejti drejtësia do ta vërë në vend. Kosova e ka paguar shtrenjtë me gjak pavarësinë e saj, ashtu siç e kanë paguar edhe grekët. Në Greqi është ndryshuar mendimi për Kosovën si shtet, -thotë Valetas. Vdekja e papritur e Podrimjes, i pikëlloi pa masë këta poetë të shquar grekë. Dhimbjen e shprehen me disa poezi dhe esse-ve brilante kushtuar gjeniut të madh nga Kosova. Dino Kubatis, në gazetën "Nacional" të datës 7 tetor 2012 ndër të tjera shkruan: "Ali Podrimja, me kokën e vet mbështetur mbi një një gur, në një pyll të Monpeliesë së Francës, u nda nga jeta më 18 qershor 2012, thjesht, qetë, pa asnjë britmë! Britma e dëshpërimit për atdheun, për të birin, për Njerinë, mbetën të skicuara në letër. Pasi t'i lexojmë, do të frymëzohemi përherë, për një botë më të mirë dhe ndjenja pavarësie". Po ky autor publikoi edhe vjershën "Aliut dhe Reshatit", ndërsa në esse-në "Ali Podrimja, Prometheu i letërsisë bashkëkohore të njeriut", botuar më 23 gusht në "Kosova Sot" ndër të tjera shkruan: "Ali Podrimja, është "poeti i përbotshëm'', i cili jeton, përpunon e rikthen në letër, nëpërmjet një fjale hirplote e njëherësh të fuqishme e bashkëkohore, vet njeriun e sotëm, me ndjenjat e problemet, me pasojat e veprimeve dhe të shqetësimeve të tij. Si një Robinson Kruzo i ri, Podrimja gjurmon, përmbyt dhe reformon, nëpërmjet, pyetjeve, dyshimeve, diskutimeve, dëshirave, pathosit, vërtetësive.... Shkrimi i tij shtrihet në thellësi, pamjet e tij shpërfaqin prush, fjalët e tij vishen me nënkuptime alegorikë. Është fatlum ai, i cili mund të zhbirojë fjalën e tij, është i lumtur ai që mund të nxjerrë kuptimin e tij dhe të lëvrojë brenda këtyre mendimeve, sepse përfiton ndjeshmërinë dhe stoicizmin e poetit, frymëzimet e shtysat, predispozicionin filozofik e shtrirjen e njohjes përkrah ndjenjës. Shkrimi i Ali Podrimjes, mrekullon, sepse e lë fjalën të bjerë si pikë e rëndë shiu, e, ndërsa është duke rënë, shndërrohet në një rrjedhë të furrishme uji të pastër, e cila akumulohet, që të mund të vërë në lëvizje mendimin dhe ndjenjat e lexuesit, -të atij lexuesi, i cili është ndërgjegjësuar, se poeti shpërfaq pikërisht atë, nëpërmjet vargjeve të tij, ato të vet njeriut, i cili "lëngon'' prej dyshimeve, frikës, emocioneve, entusiazmit e gjithshkaje tjetër, që quhet "shprehje njerëzore''. Poeti shpërfaqet, pas kërkimeve të vargjeve dhe deponimeve të veta, se vuan edhe ai, por paralelisht edhe kërkon, del në ballë dhe lufton, percepton, ofron zgjidhje, është optimist dhe guxon. Vargu i poetit është i prerë, i ngjeshur, i arrirë në mesazhe dhe ide, i përmbytur me ndjenja.... pikërisht ky është Ali Podrimja, një zë njerëzor, i cili del nga brendësia e shpirtit, një zë që shpreh të tjerët dhe atë vetë dhe mbështetet mbi një copë letre të bardhë, për të mbetur regjistruesi i kohës dhe i kompozimit tonë psikologjik, arkiv i pashuar në përjetësi, shpëtim për lexuesin, denjësi e poetit të ndjeshëm" .(Gazeta "Kosova Sot", 23 gusht).

Krahas eseve mbreslënëse, Shoqata Kulturore e Salaminës "Kafeneja e Ideve" e drejtuar nga Kubatis, organizoi më 7 tetor 2012 në Greqi, një dedikim kushtuar Podrimjes, në kuadër të 28-të të Simpoziumit Ndërkombëtar të Poezisë e të Letërsisë, ku ai mbajti referatin kryesor. Në artikullin "Si e shkrova parathënjen e librit në greqisht të A.Podrimjes ''Harta e grisur'', me nën tituj "Podrimja poeti i dhimbjes së përbotshme" dhe "Shkolla Poetike Podrimja" botuar më 7 tetor 2012 në gazetën "Nacional", Kubatis bën një ekspoze të shkëlqyer të veprës së autorit duke na dhënë një pasqyrë më të plotë për legjendën e poezisë kosovare. Ndër të tjera ai shkruan: "Në shërbim të Ushtrisë së

Dino Kubatis dhe Mentor Hoxha

Lirisë, si poet dhe si burrë-atdhetar, është ai, i cili do të paqyrojë të gjithë tragjizmin e luftës dhe të vetëflijimit për vendin e vet, vetëm me dy vargje: Kosovë, unë biri yt / e njoh gjakun tënd që vlon". Shkrimtari i shquar grek, Kostas Valetas ishte njohur me poetin kosovar, Ali Podrimjen para 35 vjetësh në një Kongres Poetik në Itali dhe e kishte vlerësuar shumë veprën poetike të tij, ndërkohë po ai vendosi i pari gurin për ta njohur në Greqi, gjë të cilën e solli botimi i librit të tij: "Harta e grisur" në gjuhën greke. Botuesi i "Eolika Grammata" më foli për poetin kosovar, duke më shfaqur edhe adhurimin e tij të madh për veprën e tij dhe më kërkoi, nëse ishte e mundur, të shkruaj edhe dy fjalë për të dhe ime shoqe të përkthente disa poezi të tij (shih botimin "Eolika Grammata" Nr. 239, shtator-tetor 2009, f. 58-59). Më 2010, ramë në ujdi së bashku me Iljaz Bobajn dhe Kosta Valetën, për të përkthyer librin e tij e tij të fundit "Harta e grisur" në gjuhën greke. Përkthimin do ta bënte shkrimtari i veçantë Iljaz Bobaj. Për botimin e këtij libri në gjuhën greke, të cilin e botoi dhe e komentoi "Eolika Grammata", Ali Podrimja më kërkoi të shkruaja parathënien (2) gjë e cila më nderonte veçanërisht e më krijoi një detyrim të plotë dhe me ndihmën e sime shoqeje e të mbesës sime Ira Llangozi të studioja gjithë punën poetike të poetit. Botimi shënoi sukses, por nuk mund të themi se bardi i poezisë së re të Kosovës e më gjerë, të Shqipërisë, u bë veçanërisht i njohur në Greqi. Jehona e poezisë së tij është mbarëbotërore dhe shtypi francez, për vdekjen e tij thekson: "Iku një poet i madh i shekullit"! Në vitin 2005, gazeta italiane "Poezia" në studimin e saj, e vendos atë ndërmjet 400 "poetëve të zgjedhur botëror të shekullit të njëzetë". Ali Podrimja, jo vetëm shkroi, por edhe krijoi poezi. Krijoi Shkollën e tij Poetike Mbarëkombëtare të shqetësimit bashkëkohor përmes devijimit të fjalëve, të cilat ndihmojnë për të shprehur çdo lloj ndjenje të poetit nëpërmjet metaforës dhe simbolikës. ...Poeti symbolist i shekullit të kaluar dhe i fillimit të shekullit tonë "vulos" me mënyrën e re të të shprehurit të tij, jo vetëm kohën e vet, por edhe poezinë në kohën e vet dhe më gjerë, e cila, brenda shekujve lëviz nën trysninë politike dhe kërkon të shprehet me simbolizma dhe figura metaforike, me kuptime alegorike dhe ekujlibre të ndjeshëm, brenda një psikizmi, i cili frymon ndjenja atdhetare, ndjesi njerëzore dhe ripërtëritje vargut". (Gazeta "Nacional", 7 tetor 2012). Kubatis ka botuar më 1996 në Athinë edhe librin "Taksidhevodas Alvania" ("Duke udhëtuar nëpër Shqipëri"), mbase dhe i nxitur nga një histori dashurie të nisur në fillim të viteve '90-të midis tij dhe një vajze intelektuale nga Tepelena, të quajtur Lili Nuraj, e cila punonte si mësuese matematike, histori e përfunduar në martesë. Nga kjo lidhje shkrimtari i madh grek u nxit ta vizitonte shpesh herë Shqipërinë duke njohur më shumë historinë e saj të lashtë, bukuritë gjeografike dhe shpirtin e mikpritjen shqiptare. Njohu kulturën dhe artin e këtij vendi, të cilat i përshkruan shumë bukur në këtë libër. Ai flet me simpati flet për shqiptarët që janë të detyruar të punojnë në Greqi por dhe bien viktimë të shtypit apo të raprezaljeve policore duke i etiketuar si hajdut etj. Por thotë autori, hajdutët e vërtetë janë me kollaro dhe janë në mes të Athinës. Nuk lë vend interesant në Shqipëri pa vizituar dhe fal njohjeve të bashkëshortes takon pjesëm më të madhe të intelektualëve vendas si Ilirjan Zhupa, Dritëro Agolli, Moikom Zeqo, Spartak Braho, Gjon Shllaku, Mujo Buçpapaj, Shkëlqim Hajnaj, Novruz Shehu etj. Në ç'do hap ai fotografon vende dhe njerëz duke shoqëruar kështu librin e tij me pamje interesante. I impresionuar Shqipëria ai shkruan edhe poezinë Shqipëri , përkthyer nnë shqip nga Mimoza Dino. Dino Kubatis, Kostas Valetas e Panajota Zalloni kanë qenë mysafirë nderi në disa manifestime letrare të zhvilluara në Shqipëri, Kosovë e Maqedoni. Në edicionin e 47-të të Mitingut të Poezisë 2012 Kubatis u shpall fitues me poezinë "Nuk isha aty..., unë nuk isha në Kosovë...", çmim që e impresionoi shumë. "U nderova shumë, por edhe u gëzova për faktin që emocionova njerëzit me një poezi për Kosovën. Është një poezi që është nxjerrë direkt nga shpirti im, nga zemra ime. Këtë e kam shkruar disa kohë pasi isha në Kosovë për herë të parë, ku njoha vendin, pashë plagët e luftës e dhembjet që ka përjetuar ky popull", shton ai gjatë një darke të shtuar për poetët pjesëmarrës në manifestimin tradicional, -njoftonte"Koha Ditore". Nisur nga ky kontribut i madh në shërbim të çështjes shqiptare, Dino Kubatis, Kostas Valetas dhe Panajota Zalloni, e kanë bërë më të njohur Shqipërinë në shtetin helen, prandaj duhen vlerësuar e përgëzuar maksimalisht nga Qeveria dhe populli shqiptar.

Dino Kubatis, Kostas Valetas, Ali Podrimja, Iliaz Bobaj, në promovimin e librit "Harta e Grisur

(Vijon numrin e ardhshëm)

homazh

NJERIU YNË I MIRË BAFTJAR SHAHINI...

Ai iku më 17 nëntor 1989 për të mbetur i paharruar midis nesh. Moto e jetës së tij ishte "Jam shumë i gëzuar kur i shoh njerëzit të qeshur" -vënë kjo edhe si epitaf në banesën e fundit të tij.

E gjeta midis fletëve të zverdhura të koleksionit të gazetës "Ushtima e maleve". Më dhembi shumë ikja e parakohshme e shokut dhe mikut tim, shok e mik i të gjithëve, njeriu që qeshte me shpirt, njeriu me zemër të madhe. Nuk mund ta lija midis fletëve të zverdhura, e mora dhe po e përcjell tash pas 23 vjetësh për ti dhënë pak shpirt.

I përjetshëm qoftë kujtimi i Baftja Shahinit.

* * *

Njerëzit e mirë, edhe kur nuk janë më, jetojnë. Dhe kjo ndodh se me punën e tyre, në jetën e tyre të shkurtër, kanë arritur të vendosin diçka të paluajtshme në truallin e jetës sonë.

Babait të tij, Xhaferrit, në ato vite të stuhishme të Luftës i takoi të vinte jetën në themelet e Shqipërisë së re.

Baftjar Shahini, i biri, ra në krye të detyrës më 17 nëntor 1989.

Kam shumë mbresa për këtë shok punëtor e të sakrificës, njeri të aksionit e të punës sulmuese, njeri ku intelektuali dhe punëtori, qenë shkrirë në një.

Vite më parë, si tani dhjetë vjetë të shkuara kur punonim për psikologjinë shoqërore për punën e pronën, Baftjari kishte dëshirë të ndalej tek psikologjia e punës e minatorit të Bulqizës. Ishin shumë jetësore mendimet e tij, të pjekura e të menduara mirë. Buronin nga thellësitë e minierës së kromit ku kishte punuar dy vjet radhazi si kantidat partie, nga zemrat e shokëve të tij minatorë e vagonistë, nga mendimi e psikologjia e njerëzve që ai i kish njohur mirë. Shokë të shumtë kishte mes minatorëve të Bulqizës Baftjar Shahini, mes punëtorëve kudo në rreth.

Një ditë erdhi nga Zogjet dhe na futi në diskutim: si ta tërheqim rininë në veprimtari, në punë e aksion? E kish merak shumë punën me brezin e ri. Me dorën e tij shkroi nga faqja e parë deri në të fundit studimin voluminoz " Mbi vendin dhe rolin e rinisë në etapën e sotme në rrethin e Dibrës dhe problemet që dalin". Është një studim ku gjen forcën e hulumtuesit shkencor, njohësin e psikologjisë së brezit të ri, forcën përgjithësuese të intelektualit të kulturuar. Ky studim që mban firmën e sektorit të edukimit e që e ka në dorë çdo byro partie, është pjesë e kontributit të Baftjar Shahinit për studimin e problemeve shoqërore, një shembull metodik se si duhet punuar në këtë fushë të gjerë të studimeve tona.

Në ndërmarrjen e ndërtimit ku punonte kohët e fundit, gjithnjë e kam takuar midis specialistëve ndërtues në Peshkopi, Bulqizë, Sllovë, Kala të Dodës. I donte dhe kishte dëshirë të shkruante për ta, për përvojën e tyre, dashurinë për profesionin. Dhe shkroi. Duke menduar e punuar për ta, ra në krye të detyrës.

Dhembjet kapërcehen me forcë. Kështu vepronte edhe Baftjar Shahini. Humori i tij, ngrohtësia shoqërore, optimizmi që krijonte, na qëndrojnë kurdoherë para syve.

Midis fotografive të shumta që kam për Baftjarin, shkëputa njerën prej tyre, atë të 26 qershorit të këtij viti, kur shkuam bashkë në Kala të Dodës për të bërë reportazhin për punëtorët e ndërtimit.

ABDURAHIM ASHIKU

"Ushtima e maleve", 30 nëntor 1989

Fitim Dani, arkitekti i mësimdhënies dhe i drejtimit arsmor në Dibër

Nga **MEVLUD BUCI**

Kur shteron pusi i dihet vlera ujit-thoshte filozofi i rilindjes kombëtare Sami Frashëri. Sigurisht që Fitim Dani, bir i Dovolanit, mësues, drejtor, kryeinspektor dhe organizator i veprimtarive arsimore në Dibër nuk jeton më, por ai rron dhe rrezaton në zemrat e mendje të brezave të nxënësve, në kujtimet e shokëve, në bëmat konkrete për reformimin pedagogjik të mësimdhënies e të drejtimit arsimor. Sinqerisht kur nisa të shkruaj këto pak radhë për Fitim Danin m'u duk vetja sikur jam përpara një provimi në dekanat, sikur jam përpara një galerie të thellë e plot me minerale të çmuara. Jeta dhe vepra e Fitim Danit është sa e thjeshtë aq edhe e vuajtur, sa e bukur aq edhe e vështirë, sa e ndritur aq edhe e madhërishme dhe gjurmëlënëse. Ndonëse po shkruaj sadopak për ato që kam përjetuar si mësues e drejtues shkolle, ku pata fatin që Fitim Danin ta kem edhe drejtues e kam të lehtë, por edhe tepër të vështirë që rrezatimi i mësimdhënies dhe drejtimi suksesshëm i Fitim Danit të mbyllen në caqet e një shkrimi, për të dhe vepra e tij sikurse dhe të para drejtuesve të shquar Selim Alliu, Shermsi Manjani, Beqir Shehu, Ramiz Lela, Elmaz Lala, Xhevahir Hoxha, Gëzim Kalia e plot të tjerë mund të shkruhet në vijimësi.

Fitim Dani u lind në Dovolan më 15 shtator 1943 në një familje të shquar për bujari e kulturë popullore, të pasionuar pas virtyteve të vëllazërimit e të arsimit. U rrit dhe u edukua me fisnikërinë e kullës së Danit, me respektin për prindërit, fisin edhe bashkëfshatarët e tij. Ishte fëmijë inteligjent, vullnet fortë, i urtë e i dashur. Fitim Dani në çdo post arsimor punoi e drejtoi me kompetencë e shpirt reformues. Në udhët e vështira të arsimit në Dibër, Fitim Dani ndoqi përvojën e të pa harruarve Selim Alliu, Adem Perhati, Ivzi Shehu e plot të tjerëve. Ndërsa shkruajmë për Fitimin, mendja na vete tek shokët e tij, inspektorët er arsimit në Dibër që nuk jetojnë si Zabit Trupja, Allaman Xharri, Haki Duka.-Fitim Dani ishte njeriu i reformimit, i shoqërisë së sinqertë, mjeshtër në mësimdhënie dhe arkitekt i drejtimit arsimor-thotë pedagogu i matematikës Sabri Pira. Për Fitimin flasin provat e punës shkencore, drejtuese e reformuese, flasin brezat e nxënësve, kolegët e shkollave përkrah të cilëve ai punoi e drejtoi..E ruaj në kujtesë që para 35 vitesh një veprimtari masive me drejtorët e trevës së Dibrës të cilët erdhën në Lunarë. Mbi 100 drejtorë shkollash me në krye Fitim Danin ish kryeinspektor dhe drejtorin e kabinetit pedagogjik të Dibrës Vangjel Petri. Fitimi vëzhgoi, vlerësoi dhe nderoi punën gjurmuese, organizative të shkollave. Tregoi vërtet pjekurinë , taktin dhe ndihmesën e organizatorit reformues. Fitim Dani ka një kronikë të ndritur të formimit si kuadër i palodhur. Më 1957-1961 mbaroi shkollën e mesme pedagogjike në Peshkopi. Fillimisht shërbeu mësues në vendlindje, në Dovolan. Në vitet 1961-1963 përfundoi studimet e larta në fakultetin e shkencave në Tiranë me rezultate të shkëlqyera. Në vitet 1967-1972 shërbeu si mësues në shkollën "Irfan Hajrullaj" në qytetin e Peshkopisë. Njeri i përkushtuar si mësues novator, si veprimtar në shkollë e jashtë saj.

Figura e Fitim Danit u rrit si mësues, krijues, novator, bashkëpunues me komunitetin, i taktit me nxënësit, i thjeshtë e veprues, i palodhur me talentet e reja. Fitim Dani, kuadër që punoi e drejtoi u dallua gjithmonë. Faktet tregojnë se ai vlerësoi punën ideologjike, drejtuese e mësimdhënëse. Këtë e dëshmoi shëmbëllimi si drejtor shkolle në Zalldardhë në vitet 1972-1974 ku i dha shtytje folklorit dhe kulturës së kësaj zone të njohur. Fitim Dani u shqua në periudhat më të vështira të reformimit arsimor. Në vitet 1974-1980 punoi me shpirt krijues si inspektor arsimi në seksionin e arsimit të Dibrës. Më pas në vitet 1980-1985 mësues shembullorë në shkollën 8 vjeçare Melan. Nga viti 1985-1991 drejtor i shkollës së mesme të përgjithshme "8 nëntori Peshkopi".Në vitet 1995-1998 shërbeu si zv.drejtor i shkollës "Demir Gashi:" në qytetin e Peshkopisë. Nga viti 1998 deri në vitin 2005 Fitim Dani shërbeu si drejtor i shkollës "Irfan Hajrullai" deri sa dhe zemra e tij pushoi së rrahuri përfundimisht. Dibra, Dovolani, qyteti i Peshkopisë, zonat më të thella të Dibrës, shkollat ku dha mësim e drejtoi e kujtojnë me respekt e nderim Fitim Danin. Bashkëshortja, Hanifja, fëmijët, kolegët, brezat e nxënësve nderojnë e kujtojnë të pa harruarin Fitim Dani. E themi me zemër në dorë se Fitim Dani ishte dhe mbeti arkitekti i mësimdhënies dhe i drejtimit arsimor në Dibër.

GJOKË DOÇI - BIRI I LURËS, TRIMI I MALLAKSTRËS...

...Në Symizë, në qoftë se nuk gaboj adresë, djali e ndalon makinën duke ma bërë me dorë drejt një lapidari. E kishte mbajtur mend herën e kaluar kur u mërzita pse nuk i bëra një fotografi. Zbrita dhe bëra disa shkrepje mbi atë vend ku ra biri i Lurës Gjokë Doçi, në atë vend ku banorët e fshatit e kishin lënë barin të paprekur që nga koha e rënies. Pllaka e lapidarit ishte me të gjitha shenjat e shkronjat e ditës kur dekada më parë ishte vënë. Ishte një nder që populli i bënte një heroi të Luftës Antifashiste, një vlerë e kulturës së popullit të thjeshtë... (Fragment nga reportazhi "Kronika nga një ushëtim me kokën pas - prill 2010)

E shkëputa këtë fragment nga kronikat e jetës sime për ta bashkuar me një fragment tjetër për jetën e Gjokë Doçit, kronikën e Nin Rajtës për Heroin, njeriun që e donëte dhe e nderonte si luras që ishin të dy (Nini tash e ka gjet Gjokën në parajsë), si trim që e rradhiti veten midis më trimave të Luftës së Madhe Antifashiste Shqiptare. Po e përcjell për lexuesin me rastin e 20 nëntorit, 69 vjetorit të rënies historike të tij. Po e përcjell shoqëruar me një fotografi të lapidarit të tij në Symyzë dhe me një fotografi të Gjokë Doçit në Fushë Lurë, në trojet e tij stërgjyshore...

NË BALLË TË SULMIT

Është e drejtë të thuash, se ndaj jetës së heronjve tanë, që ranë për atdhe, (me gjithë përpjekjet sado këmbëngulëse për të njohur ata); mbeteshin gjithnjë borxhlinj, jo vetëm për shtrirjen e veprimtarisë revolucionare në kohë, por, kryesorja, dhënia sa më e plotë e tyre ku të spikasë karakteri i tyre i fortë i formuar me cilësitë dhe virtytet më të mira të popullit tonë. E tillë është edhe jeta e Heroit të Popullit Gjokë Doçi, malësorit jetim nga Lura që nuk mbeti jetim pasi nënë i doli PKSH (sot PPSH).

Si shumë njerëz të asaj kohe të shtresave të varfra që përfaqësuan revolucionin socialist për hir të së vërtetës të ardhmes, edhe Gjoka fillimet e veta revolucionare i ka në rininë

e parë. Këtu një rol të rëndësishëm luajtën shokët e tij si Vasil Shanto, Nazmi Rushiti (Heronj të Popullit); si dhe Shkodra me atë mjedis ku zinte revolta e masës së thjeshtë kundër shtypjes dhe shfrytëzimit, kundër të huajit që kishte pushtuar vendin.

Në Shkodër, malësorin nga Lura e sollën për t'u përgatitur si klerik i ardhshëm. Ai, jo vetëm që braktisi rrugën e zgjedhur nga njerëzit e fesë me qëllime të ulëta demagogjike, por në kontakt në kontakt me literaturën komuniste e lartëson veten dhe, në mënyrë krejt të ndërgjegjshme, përcakton në jetën e tij pozicionin që do të zerë në anën e revolucionit popullor.

Djaloshi me fytyrë tërheqëse e sy të zgjuar, gjatë kohës së shkollës së mesme në Shkodër do të bjerë në sy për veprimtarinë e tij të pasur revolucionare. Në këtë kohë do të shkojë disa herë në Lurë, në vendlindjen e tij të dashur, ku dhe atje frymëzon malësorët.

Qëndrimi i Gjokës në Shkodër bëhet i pamundur, sepse bie në sy të armikut. Partia e transferon në Elbasan. Këtu nisi përsëri punën si marangoz, herë si mekanik, herë në punishten e pijeve freskuese dhe, krahas këtyre punëve, udhëheq njësitin gueril të qytetit. Aksionet kundër fashizmit pasojnë njëri tjetrin. Edhe në Elbasan ai gjen ndër shokët urrejtjen urrejtjen e madhe kundër fashizmit. Bashkë me Siri Kodrën (dëshmor) e shokë të tjerë udhëheq demonstratën e bukës.

Në vitin 1942 merr pjesë në çetën partizane të Dumresë. Fillimi i vitit të ardhshëm do të jetë një gëzim i veçantë për Heroin. Partia do ta pranojë në radhët e saj. Tani Gjoka nuk do të ishte më jetim. Për atë mendonte një nënë e madhe që do ta shoqëronte gjatë udhëve të jetës. Dhe këtë kujdes, që heroi kishte ndjerë edhe përpara Gjoka do t'ia shpërblente në përleshje dhëmb për dhëmb me fashistët.

Aksioni i shtatorit 1943, siç tregojnë shokët e tij të luftës, qe një fitore e thellë mbi fashistët. Gjoka udhëhoqi 25 partizanë të cilët u futën në qytet dhe goditën armikun. Nga ana e gjermanëve mbetën të vrarë mbi 80 forca.

Për trimërinë dhe aftësinë e tij, me krijimin e Brigadës së Parë Sulmuesi Gjoka u caktua si kuadër deri në komandant të batalionit të 4-t.

... 20 Nëntor 1943. Në një përpjekje të rreptë për jetë a vdekje në mbrojtje të brigadës që kalonte lumin Vjosa, bie Gjoka, për të mbetur përjetësisht i gjallë në zemrën e popullit. Se populli ka një vend të veçantë për ata që jetën ia kushtojnë atdheut.

Jeta e Gjokës!...me mjerim, por jo e shkurtër, e gjatë pa mbarim. E tillë është jeta e Heronjve. Ata në rrugën që nisi Partia ishin të parët dhe mbetën ngaherë të rinj, krenarë për brezat.

Ka vite që Lura çmallet me birin e saj të derdhur në bronc. Njerëz të moshave të ndryshme përkulen me nderim para bustit të tij në qendër të Lurës. Heroi me vështrim të tretur nga Nezhda sikur i grish për vigjilencë...

NIN RAJTA

"Ushtima e maleve", 24 nëntor 1984

Rreth ekspozitës vetjake të piktorit dibran, Huzri Hoxha

"Udhë drejt vetes"

Me datë 16 dhjetor 2012, u hap në ambientet e Muzeut Historik Kombëtar ekspozita vetjake "Udhë drejt vetes" e piktorit të njohur nga Dibra, Huzri Hoxha. Kjo ekspozitë u çel në kuadrin e 100-Vjetorit të Pavarësisë dhe të Shtetit Shqiptar. Në këtë ekspozitë u përfshinë 53 piktura të gjinive të ndryshme: kompozime, portrete, peizazhe dhe piktura postmoderne. Ekspozita u organizua nga shoqata "Çidhna & Kastriotët" në bashkëpunim me Muzeun Historik Kombëtar. Ajo qëndroi e hapur deri më 22 dhjetor 2012 dhe u vizitua nga një numër i madh njerëzish të kategorive dhe shtresave të ndryshme shoqërore: artistë, shkrimtarë, intelektualë, politikanë dhe nxënës shkollash. Në emër të shoqatës "Çidhna dhe Kastriotët", përshëndeti kryetari i saj, Ali Hoxha, i cili përgëzoi autorin për artin e tij të mrekullueshëm, ndërkohë vlerësime me superlativa u bënë edhe nga piktorët dhe pedagogët me përvojë të Akademisë së Arteve të Bukura të kryeqytetit shqiptar. Edhe vizitorët e shumtë vlerësuan autorin për gjetjet artistike dhe mesazhet estetike dhe filozofike të pikturave të tij.

I lindur në Fushë-Çidhën të Dibrës dhe i frymëzuar nga historia e lavdishme e trevës dibrane, Huzri Hoxha, një pjesë të konsiderueshme të peisazheve dhe portreteve të tij, ua kushton pikërisht bukurive dhe prijësve popullorë të trevës ku lindi dhe kaloi pjesën më të madhe të rinisë së tij. Bukuritë e trevës dibrane janë pasqyruar në peizazhet "Pemishte në Ostush", "Dimër në Fushë-Alije", "Përroi i Gramës" etj, por ndërkohë ka gdhendur me mjeshtëri në art, edhe portretet e disa prej protagonistëve kryesorë të historisë së trevës dibrane, si Elez Isufi, Selman Alia dhe Riza Lusha, kulla e të cilit u bë selia e shtabit të udhëheqësve të kryengritjes së përgjithshme antiserbe që shpërtheu më 15 gusht 19120 në Çidhën. Krahas këtyre portreteve historikë, mjaft mbresëlënëse dhe kuptimplote është edhe tabloja "Fill pas kryengritjes", ku ushtari i UÇK-së në prag të nisjes për në luftë merr në prehër vogëlushin e tij për ta përqafuar për herë të fundit, ndërkohë tabloja "Ferra e Pashës", evokon një nga vendet-takimet më të lavdishme të Dibrës, ku burrat e Çidhnës dhe të mbarë Dibrës shpesh herë kanë lidhur besën për të luftuar kundër armiqve të shumtë që si bisha të egra janë turrur mbi tokën dibrane, por njëkohësisht , kjo tokë e lashtë u bë edhe varri për shumicën më të madhe të këtyre ushtrive armike. Një pjesë të madhe të tablove të kësaj ekspozite, e zënë edhe imazhet postmoderniste, përbrenda të cilave përthyhet bota shpirtërore e krijuesit me të gjitha shqetësimet e kohës, të cilat shfaqen përmes metaforave dhe abstraticitetit të ngjizur në strukturën mediative të mendimit krijues . Te tablot "Gratë me shkarpa", "Memorium", "Ikja e babait", sublimohet e kaluara hidhërake e ngulitur në celuloidin e dhimbjes së përbotshme të kohëve të përbindshme që kaluam. Krahas suksesit në artet figurative, Huzri Hoxha, është i njohur për publikun dibran dhe atë shqiptar edhe për kontributin e tij të madh në fushën e politikës dhe atë të biznesit.

Ai u lind më 1961 në fshatin Blliçe të Dibrës. Shkollën e mesme e ka mbaruar në Kastriot, ndërsa më 1985, mbaron studimet e larta në fakultetin ekonomik. Gjatë periudhës 1987-1990 ka mbaruar disa specializime në Shkenca Politike. Në vitin 1992 u zgjodh deputet në parlamentin e parë pluralist. Nga viti 1993-1998 ka punuar si punonjës në në Ministrinë e Jashtme. Më 1998 ai emërohet drejtor i Përgjithshëm i kompanisë "Progips", përfaqësues ekskluziv i kompanisë gjermane "Knauf Corp". Aktualisht është student i vitit të tretë në Akademinë e Arteve në Tiranë.

Korresp. "Rruga e Arbërit"